



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bankën e Shqipërisë

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË”

Tiranë, Dhjetor 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-6
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-5
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-6
II.	HYRJA	6-9
1	Objektivat dhe qëllimi	6
2	Identifikimi i çështjes	6-7
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
4	Përgjegjësitë e audituesve	7
5	Kriteret e vlerësimit	8
6	Standardet e auditimit	8
7	Metodat e auditimit	8-9
8	Dokumentimi i auditimit	9
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	9-61
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	9
2	Rezultatet e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	9-61
2.1	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	9-12
2.2	Mbi fondin themeltar të Bankës së Shqipërisë dhe rezultatin financiar të veprimtarisë së saj për vitin 2023.	12-18
2.7	Mbi mbajtjen dhe administrimin e rezervës valutore të Republikës së Shqipërisë.	18-20
2.3	Mbi marrëdhëniet ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe shtetit shqiptar.	20-27
2.4	Mbi zbatimin e marrëveshjes me ministrinë Financave për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë si agjent fiskal për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, lidhur me: - tregtimin e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria; - pagesën e vlerës, të interesit dhe shpenzimeve të tjera për letra me vlerë; - kryerjen e veprimeve me para lidhur me llogaritë e Shtetit në Bankën e Shqipërisë.	27-59
2.5	Mbi regjistrimin dhe evidentimin e borxhit të jashtëm publik të Republikës së Shqipërisë.	59
2.6	Mbi kreditë ose huatë e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë, si dhe ristrukturimi i letrave me vlerë të Qeverisë.	59-62
IV	REKOMANDIME	63-65

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i objektit të auditimit

Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë. Ky status sanksionohet në nenin 161 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton objektivat, detyrat, marrëdhëniet me sistemin bankar dhe me shtetin, organizimin dhe drejtimin, pronësinë mbi kapitalin, pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e fitimit.

Banka e Shqipërisë ka si objektiv kryesor arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Ajo është autonome dhe e pavarur nga çdo pushtet tjetër në realizimin e objektivit kryesor dhe objektivave e detyrave të tjera.

Banka e Shqipërisë është bankë me kapital tërësisht shtetëror dhe përgjigjet përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ajo drejtohet nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili kryesohet nga Guvernatori, që vepron edhe si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i saj. Vizioni i Bankës së Shqipërisë është forcimi i mirëqeverisjes, përmes forcimit të pavarësisë, rritjes së llogaridhënies e transparencës, me qëllim rritjen e besimit të publikut tek institucioni.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij

Rëndësia e auditimit të përputhshmërisë të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2023, lidhet me rëndësinë e vet këtij institucioni në sistemin ekonomik dhe financiar të vendit. Ky institucion ka përgjegjësinë kryesore për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare, me synim ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe mbajtjen e inflacionit nën kontroll. Banka e Shqipërisë menaxhon rezervat valutore të vendit të cilat janë burime të rëndësishme për të ruajtur besueshmërinë e ekonomisë në tregjet ndërkombëtare. Gjithashtu Banka është autoriteti i vetëm që emeton para, si instrumenti kryesor për menaxhimin e inflacionit dhe stabilitetit ekonomik. Nëpërmjet auditimit vlerësohet nëse ky institucion e ka kryer veprimtarinë e tij për vitin 2023 në përputhje ose jo me kuadrin rregullator dhe ligjor në fuqi, duke dhënë rekomandime me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe përmirësimin në të ardhmen.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi nivelin e përputhshmërisë të veprimtarisë së Agjencisë me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023- 31.12.2023.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi fondin themeltar të Bankës së Shqipërisë dhe rezultatin financiar të veprimtarisë së saj për vitin 2023.

- Mbi mbajtjen dhe administrimin e rezervës valutore të Republikës së Shqipërisë.

- Mbi marrëdhëniet ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe shtetit shqiptar.

- Mbi zbatimin e marrëveshjes me ministrinë Financave për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë si agjent fiskal për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, lidhur me: tregtimin e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria; pagesën e vlerës, të interesit dhe shpenzimeve të tjera për letra me vlerë; kryerjen e veprimeve me para lidhur me llogaritë e Shtetit në Bankën e Shqipërisë.

Mbi regjistrimin dhe evidentimin e borxhit të jashtëm publik të Republikës së Shqipërisë.

Mbi kreditë ose huatë e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë, si dhe ristrukturimi i letrave me vlerë të Qeverisë.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut.

Në këtë auditim janë përzgjedhur metoda, metodologji apo teknika auditimi dhe shtrirje të procedurave të auditimit, për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. Intervistimi – duke kombinuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse.
- b. Raporte dhe informacione – shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit.
- c. Verifikimi në sistemin elektronik – me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.
- d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi dhe sipas drejtimeve në veçanti.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet disa problematika në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 6 gjetje dhe ka dhënë 6 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore

1. Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2023 veçanërisht për mjetet monetare në valutë (si monedha EUR e cila paraqitet me teprica të konsiderueshme likuiditeti sidomos pas marrjes së Eurobondit në muajin Qershor 2023) nuk është shfrytëzuar mundësia e investimit të tyre në depozitë nga ana e MFE për të përfituar të ardhura nga interesi, në të njëjtën kohë kur mbajtja e këtyre valutave shoqërohet me kosto mbajtje. Gjithashtu, konstatohet se përgjatë periudhës objekt auditimi kanë ekzistuar hapësirat dhe mundësitë për të investuar më shumë si në vlerë ashtu edhe në kohëzgjatje, me qëllim përfitimin maksimal nga kjo mënyrë menaxhimi e likuiditetit.

2. Për vitin 2023, llogaria “Rezerva e rivlerësimit të valutave” rezultoi me gjendje negative në 56,737,912,520.53 lekë. Ministria e Financave ka kthyer përgjigje mbi njoftimin për vlerën negative të llogarisë “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave” dhe mbi kompensimin e titujve shtetëror të emtuar nga Ministria e Financave, jo në përputhje me afatin e përcaktuar në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” dhe në Marrëveshjen “Mbi transferimin e fitimit neto të BSH pranë MF, dhe mbulimin e humbjeve të BSH datë 20.01.2015”, të ndryshuar me Marrëveshjen me nr. prot., 24012, datë 29.12.2023.

3. Nga verifikimi i rezervave, rezultoi se për vitin e mbyllur më 31.12.2023 zëri “Rezerva si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve” paraqitet në shumën 5,450 milionë lekë. Kjo rezervë është krijuar bazuar në Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të BSH nr. 19 dhe nr. 20, datë 15.03.2018, si rezultat i rishpërndarjes dhe shpërndarjes së rezervës së tranzicionit. Në lidhje me këtë rezervë Banka e Shqipërisë nuk disponon një manual apo udhëzim, specifik, që të përcaktojë mënyrën implementimit të këtyre standardeve, menaxhimit të tranzicionit drejt IRFS-ve si dhe krijimin dhe përdorimin e rezervës së krijuar për këtë qëllim.

4. Për ankandin nr. 212, datë 06.04.2023, Agjencia e Sigurimit të Depozitave ka paraqitur 3 kërkesa konkurruese. Në kërkesën e parë ka kërkuar të marrë pjesë në ankand me shumën konkurruese 500 milion lekë dhe yield 4.1%, në kërkesën e dytë ka kërkuar të marrë pjesë me shumën konkurruese 500 milion lekë dhe nivel yield 4.2% ndërsa në kërkesën e tretë ka kërkuar të marrë pjesë me shumën konkurruese 750 milion lekë dhe nivel yieldi po 4.2%. Nga komisioni i ankandit janë pranuar të tre kërkesat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Pranimi i dy kërkesave të mësipërme me të njëjtin nivel yield-i të kërkuar nga i njëjti subjekt është në jo në përputhje me pikën 3, neni 8, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 31, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të thesarit në formë regjistri”, i ndryshuar.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

1. Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrë masa për krijimin e hapësirave me qëllim nxitjen e mundësive mbi investimin e likuiditeteve në monedhë vendase dhe valuta të huaja në vlerë dhe në kohëzgjatje, jo vetëm përmes investimeve në depozitë, por edhe përmes instrumenteve të tjerë për menaxhimin e likuiditetit.
2. Banka e Shqipërisë të marrë masa për të bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, në drejtim të koordinimit të veprimeve, për emetimin brenda afatit ligjor të përcaktuar, të letrave me vlerë, me qëllim shmangien e riskut për mos mbulimin në kohë të rezervave negative.
3. Banka e Shqipërisë të marrë masa për të hartuar një manual/udhëzim të detajuar, ku të përcaktojnë procedurat për menaxhimin dhe përdorimin e rezervës “Rezerva si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve, hapat për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar si dhe rregulla për monitorimin dhe raportimin e përdorimit të kësaj rezerve.
4. Komisionet e ankandeve të marrin masa për mos pranimin nga i njëjti subjekt të më shumë se 5 kërkesave konkurruese për ankandet e bonove të thesarit dhe më shumë se 3 kërkesave konkurruese për ankandet e obligacioneve si dhe të analizojë këto kërkesa dhe të pranojnë ato kërkesa të cilat kanë të paktën 0.01% ndryshimin në nivelin e yield-it.

I.1. Konkluzion dhe Opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat kjo strukturë realizon misionin e vet. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i pakualifikuar mbi auditimin e përputhshmërisë¹

Në opinionin tonë, bazuar, në punën e kryer gjatë auditimit të përputhshmërisë, në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatojmë se Banka e Shqipërisë ka vepruar në përputhshmëri me kuadrin ligjor, dhe rregullator në fuqi, në të gjitha aspektet materiale të rëndësishme, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin” dhe justifikojnë dhënien e opinionit të pakualifikuar.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë

Nga evidencat e marra dhe të shqyrtuara për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, për vitin 2023, kanë rezultuar problematikat si në vijim:

- Nuk është mbuluar rezerva negative e rivlerësimit të valutave nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë brenda afatit të parashikuar në nenin 64 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 3 të Marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të BSH pranë MF, dhe mbulimin e humbjeve të BSH datë 20.01.2015”, të ndryshuar me Marrëveshjen me nr. prot., 24012, datë 29.12.2023.

- Nga verifikimi i rezervave, rezultoi se për vitin e mbyllur më 31.12.2023 zëri “Rezerva si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve” paraqitet në shumën 5,450 milionë lekë. Kjo rezervë është krijuar bazuar në Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të BSH nr. 19 dhe nr. 20, datë 15.03.2018, si rezultat i rishpërndarjes dhe shpërndarjes së rezervës së tranzicionit. Në

¹ Opinioni i pamodifikuar/i pakualifikuar mbi auditimin e përputhshmërisë: *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë jo materiale dhe jo të përhapura.*

lidhje me këtë rezervë Banka e Shqipërisë nuk disponon ndonjë dokument, manual apo udhëzim, që të përcaktojë mënyrën implementimit të këtyre standardeve, menaxhimit të tranzicionit drejt IRFS-ve si dhe krijimin dhe përdorimin e rezervës së krijuar për këtë qëllim.

- Në kuadër të bashkëpunimit për menaxhimin e likuiditetit konstatohet se nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në bashkërendim me Bankën e Shqipërisë nuk janë shfrytëzuar plotësisht dhe në mënyrë shteruese hapësirat, si në vlerë ashtu edhe në kohëzgjatje, për investimet në depozitë në monedhë vendase dhe valutë të huaj, me qëllim përfitimin maksimal nga kjo mënyrë menaxhimi e likuiditetit.
- Për ankandin nr. 212, datë 06.04.2023, komisioni i ankandit ka pranuar dy kërkesa konkurruese, me të njëjtin nivel yield-i të kërkuar nga i njëjti subjekt, jo në përputhje me pikën 3, neni 8, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 31, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të thesarit në formë regjistri”, i ndryshuar.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 655/1 prot., datë 21.05.2024, i ndryshuar, i miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 20.05.2024 deri në datë 04.10.2024, në Bankën e Shqipërisë, (këtu e në vijim BSH), u krye auditimi mbi përputhshmërinë e aktivitetit për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. H.S, Përgjegjëse Grupi,
2. E.H, Audituese,
3. Xh.N, Audituese,
4. K.N, Audituese.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Objekivi i auditimit është arritja e një konkluzioni dhe dhënia e opinionit nëse aktiviteti i zhvilluar nga Banka e Shqipërisë është në përputhje me dispozitat ligjore, nënligjore dhe rregullatorë përkatës, në lidhje me aktivitetin operativ, zhvillimin e ankandëve të titujve të borxhit të qeverisë, veprimtarinë si agjent fiskal i qeverisë, si dhe saktësinë e llogaritjes së rezultatit financiar dhe kalimit të tij në Buxhetin e Shtetit.

Qëllimi i auditimit është vlerësimi objektiv nëse aktivitetet e raportimit, rakordimit, konfirmimit dhe ankandet, janë në çdo aspekt material në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti, si dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e vazhdueshëm.

Mbi bazën e akt-konstatimeve, diskutimeve me zyrtarët e subjektit të audituar, vërejtjeve dhe sugjerimeve në takimin përmbyllës në terren, si dhe observacioneve të sjella hartohet Projektraporti i auditimit i cili shërben si baze për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Identifikimi i çështjes

Sipas përcaktimit të ISSAI 100, auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjisllacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë nëse veprimtaria e Banka e Shqipërisë në lidhje raportimin financiar, rakordimin, konfirmimin dhe zhvillimi i ankandëve për tregtimin e letrave me vlerë është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe

është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e riskut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese për përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi:

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Bankës së Shqipërisë është e lidhur me aktivitetin e veprimtarinë si agjent fiskal i qeverisë dhe zhvillimin e ankandeve të titujve të borxhit të qeverisë. Statusi i Bankës sanksionohet në nenin 161 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 8269/1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i cili përcakton objektivat, detyrat, marrëdhëniet me sistemin bankar dhe me shtetin, organizimin dhe drejtimin, pronësinë mbi kapitalin, pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e fitimit. Drejtimi i Bankës së Shqipërisë është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

Përgjegjësitë e audituesve

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

Përveç standardeve të ISSAI, ne aplikuar edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne: Identifikuam dhe përpunuam riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikuam, realizuam procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbulluam evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë.

Krijua një konkluzion final nëse çështjet rutinë të raportimit të të dhënave janë kryer në mënyrën e duhur dhe u bazuam në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çonin në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht.

Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit. Ne komunikuar me drejtuesin ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë, përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që identifikuar gjatë auditimit tonë.

Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Shqipëri”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 90, datë 02.12.2015 “Për miratimin e Statusit të Bankës së Shqipërisë”;
- Marrëveshja kuadër datë 20.01.2015 midis Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë “Për ofrimin e shërbimeve financiare nga Banka e Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;
- Marrëveshja për organizimin e ankandeve të titujve të shtetit shqiptar, shlyerjen e veprimeve dhe mbajtjen e regjistrit të këtyre titujve, e ndryshuar;
- Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 30 datë 26.12.2013 për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë e bonove të thesarit në formë regjistrimi, i ndryshuar.
- Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 31, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të Obligacioneve në formë regjistrimi”, i ndryshuar.

Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 “Parimet bazë të auditimit financiar”, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

- ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”
- ISSAI 130 “Kodin Etik”
- ISSAI 2315 “Risku”
- ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”
- ISSAI 2500 “Dokumentimi”

Metodat e auditimit

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. Intervistimi – duke kombinuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse.
- b. Raporte dhe informacione – shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit.
- c. Verifikimi në sistemin elektronik – me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.
- d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional të audituesve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë. Ky status sanksionohet në nenin 161 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i cili përcakton objektivat, detyrat, marrëdhëniet me sistemin bankar dhe me shtetin, organizimin dhe drejtimin, pronësinë mbi kapitalin, pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e fitimit.

Banka e Shqipërisë ka si objektiv kryesor arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Ajo është autonome dhe e pavarur nga çdo pushtet tjetër në realizimin e objektivit kryesor dhe objektivave e detyrave të tjera.

Banka e Shqipërisë është bankë me kapital tërësisht shtetëror dhe përgjigjet përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ajo drejtohet nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili kryesohet nga Guvernatori, që vepron edhe si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i saj. Vizioni i Bankës së Shqipërisë është forcimi i mirëqeverisjes, përmes forcimit të pavarësisë, rritjes së llogaridhënies e transparencës, me qëllim rritjen e besimit të publikut tek institucioni.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve:

2.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 25/10 prot., datë 17.07.2023 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimi e Përputhshmërisë”, protokolluar në Bankën e Shqipërisë me nr. 74/4 prot., datë 17.07.2023, ka kërkuar zbatimin e 10 masave organizative.

Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 74/5 prot., datë 01.08.2023, ka paraqitur “Qëndrimin e Bankës së Shqipërisë mbi Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet për “Auditimin e përputhshmërisë” të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **brenda afatit 20 ditë**, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Banka e Shqipërisë nuk ka dërguar në KLSH informacion mbi zbatimin e rekomandimeve, jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 30 pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ku citohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raportin Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve është konstatuar se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve rezulton si më poshtë:

- Nga 10 masa organizative të lëna, janë pranuar 4 masa ose 40% e tyre dhe nuk janë pranuar 6 masa ose 60%. Në lidhje me zbatueshmërinë rezulton se: 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe 1 rekomandime është në proces zbatimi.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të përmblodhur ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve.

Tabela nr. 1.1: Përmblodhje e pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH.

Lloji i rekomandimit	Nr. rekomandime	Pa pranuar	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Proces	Pa zbatuar
Masa Organizative	10	6	4	-	3	1	-
Total	10	6	4	-	3	1	-

Burimi: Grupi i auditimit, KLSH.

Më hollësisht, auditimi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar paraqitet si vijon:

1.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masa për rishikimin e marrëveshjes kuadër nr. 251, datë 16.01.2015, të lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me qëllimin parashikimin procedurave/etapave që duhet të ndiqen në rrethana kur BSH rezulton me humbje financiare dhe kapital negativ, si dhe (ii) përcaktimin e afateve përkatëse të plotësimit të detyrimit për dërgimin e konfirmimeve mujore me qëllim optimizimin e procesit.

Qëndrimi i Bankës së Shqipërisë: Marrëveshja u rishikua në Dhjetor 2023 dhe marrëveshja është në zbatim.

Nga auditimi rezulton se në dhjetor të vitit 2023, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financës kanë miratuar marrëveshjen “Për disa ndryshime në marrëveshjen mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë, datë 20.01.2015”, e cila në Bankën e Shqipërisë është protokolluar me nr. 5529, datë 29.12.2023, ndërsa në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është protokolluar me nr. 24012, datë 29.12.2023. Në këtë marrëveshje është përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen në rastet kur rezultojnë efekte neto negative nga rivlerësimi i bilancit valutor të Bankës.

Në lidhje me afatet për dërgimin e konfirmimeve mujore për llogaritë e depozitës së qeveritë në valutë dhe lekë, marrëveshja nuk ka pësuar ndryshime.

Rekomandimi rezulton i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

6.1. Rekomandimi: Nga Banka e Shqipërisë të merren masa për përfundimin e procesit të inventarizimit para miratimit të Pasqyrave Financiare të Bankës së Shqipërisë, si dhe për rishikimin e Rregullores me qëllim dokumentimin e procesit të asgjësimit të aktiveve.

Qëndrimi i Bankës së Shqipërisë: Pranohet pjesërisht. Inventarizimi fizik i AQT-ve për vitin 2021 dhe 2022 ka përfunduar në përputhje me datat e përcaktuara në urdhrin e inventarizimit. Ligji nr. 25/2018 ka hequr paralelen detyruese midis procesit të inventarizimit fizik me pasqyrat financiare. Pasqyrat financiare të Bankës janë certifikuar nga auditorë të jashtëm të pavarur, të shoqëruar nga një opinion i pakualifikuar duke siguruar që ato reflektojnë në mënyrë të drejtë pozicionin e Bankës. Procesi i inventarizimit vëzhgohet si nga auditorët e brendshëm ashtu edhe nga të jashtëm, duke siguruar evidentimin dhe adresimin në kohë të problematikave, shoqëruar kjo edhe me korrigjimet përkatëse në librat e bankës dhe më tej në pasqyrat financiare. Në lidhje me regjistrimin e procesit të asgjësimit me foto/video, Banka e Shqipërisë pranon rekomandimin, pa iu referuar ndryshimeve rregullatore dhe do ta

konsiderojë rregullimin e sugjeruar duke e përfshirë këtë kërkesë në urdhrin e administratorit për ngritjen e komisionit të asgjësimit.

Nga auditimi rezulton se për vitin 2024, me e-mail nga Departamenti i Administrimit i është kërkuar grupit të nxjerrjes jashtë përdorimit të disa vlerave materiale dhe asgjësimit të tyre (ngritur me Urdhrin nr. 1311, datë 20.03.2024), që të dokumentojë procesin e asgjësimit me foto/video.

Rekomandimi rezulton i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

7.1. Rekomandimi: Nga ana e BSH të merren masa për rritjen e kontrollit në ekzekutimin e kontratës për rikonstruksionin e godinës së ish-hotel Dajtit dhe rishqyrtimi i të gjitha afateve pezulluese të miratuara duke aplikuar edhe penalitetet përkatëse për çdo vonesë në vijimësi deri në përfundimin e objektit të investimit duke shmangur shtyrjet e mëtejshme të përfundimit të punimeve, me qëllim funksionimin normal të aktivitetit të BSH në këtë godinë.

Qëndrimi i Bankës së Shqipërisë: Banka e Shqipërisë ka ndjekur me seriozitet dhe përparësi ndjekjen e kontratës së Rikonstruksionit të Godinës së ish- Hotel Dajtit.

Nga auditimi rezulton se, pas miratimit të afateve pezulluese, afati i zbatimit të kontratës është transferuar në datën 19.03.2022. Referuar Certifikatës “Marrje e përkohshme në dorëzim të punimeve”, me objekt “Rikonstruksion i godinës ish-hotel Dajti, të Bankës së Shqipërisë, në Tiranë”, data e përfundimit të punimeve rezulton të jetë 21.08.2023. Banka e Shqipërisë referuar nenit 7, pika 1 të kontratës nr. 4545, datë 05.09.2017 dhe nenit 1, pika 7 të kontratës nr. 2509, datë 07.04.2023, ka vendosur penalit në vlerën 826,542.72 Euro, për 520 ditë vonesë punimesh.

Rekomandimi rezulton i zbatuar pjesërisht.

8.1. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit i Bankës së Shqipërisë të marrë masa në të ardhmen që, në miratimin e dokumenteve të tenderit, vendosjen e kriterëve kualifikuese të shmangë vendosjen e kriterëve që i përkasin një marke apo prodhuesi specifik, me qëllim përfshirjen e sa më shumë kandidatëve në procedura për të arritur përdorimin sa më efektiv të buxhetit të bankës. Gjithashtu, në të gjitha procedurat e prokurimeve në vijim të kualifikojë operatorët ekonomik në përputhje të plotë me kriteret kualifikuese duke mos bërë interpretime të vërtetimeve të lëshuara nga Gjykata apo pranuar vetëdeklarime nga subjektet pjesëmarrës në prokurim.

Qëndrimi i Bankës së Shqipërisë: Rekomandimi i zbatuar.

Referuar qëndrimit të Bankës së Shqipërisë ky rekomandimi është zbatuar pasi procedurat e prokurimit janë zhvilluar në përputhje të plotë me aktet rregullatorë në fuqi. Por referuar afatit të zbatimit të rekomandimit “në vijimësi” dhe programit të auditimit, statusi i këtij rekomandimi do të vlerësohet në auditimet e ardhshme të KLSH-së.

Rekomandimi rezulton në proces zbatimi.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2093/3, datë 27.11.2024 “Mbi qëndrimin e Bankës së Shqipërisë për Projektraportin e auditimit”, protokolluar në KLSH me nr. 655/9, datë 27.11.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit: Lidhur me rekomandimet e auditimit të mëparshëm siç paraqitet në projekt raport, nga të cilat janë pranuar 2 (dy) rekomandime dhe 2 (dy) të tjera janë pranuar pjesërisht, theksojmë së për të gjitha rekomandimet e pranuar, edhe pjesërisht, Banka i ka realizuar këto rekomandime në momentin e dërgimit të përgjigjes përfundimtare të dërguar në raportin e vitit 2023. Theksojmë se statusi “në proces”, është lënë nga grupi Auditimit për verifikim në auditimet e ardhshme. 3 rekomandimet e tjera janë zbatuar plotësisht nga Banka e Shqipërisë. Grupit të auditimit i janë dhënë evidencat e zbatueshmërisë së tyre. Mendojmë që tabela e zbatueshmërisë duhet të paraqitet si më poshtë.

Tabela nr. 1.1: Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH për BSH

Lloji i rekomandimit	Nr. rekomandime	Pa pranuar	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Proces	Pa zbatuar
Masa Organizative	10	6	4	3	-	1	-
Total	10	6	4	3	-	1	-

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pas shqyrtimit të observacionin, grupi i auditimit i qëndron rekomandimeve të dërguara në Bankën e Shqipërisë me shkresën nr. 25/10, datë 17.07.2023. Gjithashtu sqaron se statusi i zbatimit të rekomandimeve është vendosur nga grupi i auditimit pas shqyrtimit të evidencat dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Banka e Shqipërisë.

2.2 Mbi fondin themeltar të Bankës së Shqipërisë dhe rezultatin financiar të veprimtarisë së saj për vitin 2023.

Në zbatim të pikës “2” dhe “7” të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Marrëveshja Kuadër midis Bankës së Shqipërisë (nr. 5529, prot., datë 29.12.2023) dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (nr. 24012, prot., datë 29.12.2023).
- Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 18, datë 20.03.2024 “Për miratimin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023”;
- Llogaritjet e kryera përgjatë vitit për shtesat dhe rimarrjet e provigjioneve përgjatë periudhës objekt auditimi;
- Pasqyrat financiare të publikuara të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023;
- Korrespondenca shkresore e Bankës së Shqipërisë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për emetimin e titujve të borxhit për mbulimin e rezervës negative të rivlerësimit;
- Bilanci vërtetues i datës 31.12.2023, etj.

Kreu II “Fondi themeltar dhe përdorimi i fitimit”, i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 8 përcakton se: “Për çdo vit financiar, fitimi neto i Bankës së Shqipërisë llogaritet pasi të zbriten nga të ardhurat shpenzimet e bëra për vitin financiar në fjalë dhe pas veçimeve për:

- a. borxhe të dyshimta e pa shpresë arkëtimi, masën e zhvlerësimit të mjeteve në bilancin e Bankës së Shqipërisë, si dhe kontributin për fondet e pensionit të personelit;
- b. shpenzimet e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës për qëllime të tjera që konsiderohen si të nevojshme për Bankën e Shqipërisë”.

Sipas përcaktimeve ligjore, fitimit neto i bëhen rregullime në lidhje me: borxhet e dyshimta dhe pa shpresë arkëtimi, zhvlerësimin e mjeteve në bilancin e Bankës së Shqipërisë; kontributin e Bankës për fondin e pensionit të personelit të saj. Gjithashtu, ligji ka krijuar edhe një kategori tjetër shpenzimesh, për të cilat bëhen rregullime të fitimit neto. Ato i lihen kompetencë Këshillit Mbikëqyrës për t’i miratuar dhe që vetë Banka e Shqipërisë i konsideron të nevojshme. Fitimi i Bankës së Shqipërisë trajtohet sipas dy koncepteve:

Koncepti i fitimit bruto: Fitimi bruto llogaritet si diferencë e të ardhurave dhe shpenzimeve të bëra për vitin financiar (klasa 6-7). Ky fitim mund të quhet ndryshe fitimi neto para veçimeve (provigjioneve).

Koncepti i fitimit neto: Ky fitim mund të quhet ndryshe fitimi neto pas veçimeve (provigjioneve) dhe llogaritet duke veçuar nga fitimi bruto provigjione dhe rezerva të tjera si borxhe të dyshimta e pa shpresë arkëtimi, masën e zhvlerësimit të mjeteve në bilancin e Bankës së Shqipërisë, si dhe kontributin e fondit të pensionit të personelit, shpenzimet e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës për qëllime të tjera, që konsiderohen të nevojshme për Bankën e Shqipërisë. Nga fitimi bruto veçohen fonde për të mbuluar shpenzimet e miratuara

nga Këshilli Mbikëqyrës për qëllime të tjera, që konsiderohen të nevojshme për Bankën e Shqipërisë. Të tilla shpenzime mund të jenë:

-fondet rezervë për mjetet të paklasifikuara;

-falja e një kredie për punonjësit e Bankës së Shqipërisë;

-sistemimi i vlerës neto kontabël të aktiveve të qëndrueshme të miratuara për nxjerrje jashtë përdorimit;

-sistemimi i një detyrimi të njohur me vendim gjykate;

-veçime për fonde të karakterit të investimeve etj.

Sa më sipër, Banka e Shqipërisë mundet të bëjë përjashtime të tjera, subjekte të miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës të ndryshme nga ato të listuara në gërmën “a” të këtij neni.

Në nenin 9 të ligjit citohet: “Banka e Shqipërisë krijon një fond të rezervës së përgjithshme. Në fund të çdo viti financiar ky fond shtohet me një shumë prej 25% të fitimit neto të Bankës së Shqipërisë, derisa fondi i rezervës së përgjithshme të arrijë në 500% të fondit të themelimit të Bankës së Shqipërisë”.

Në nenin 10 të ligjit citohet: “Pas kalimit të shumës prej 25% të fitimit neto në fondin e rezervës së përgjithshme sipas nenit 9, mbetja nga fitimi neto për vitin financiar do të përdoret për të kompensuar letrat me vlerë që i janë dhënë Bankës së Shqipërisë në përputhje me nenin 7 të këtij ligji. Fitimi neto për vitin financiar, që mbetet pasi bëhen zbritjet sipas neneve 8, 9 dhe paragrafit të parë të nenit 10 të këtij ligji, kalon në të ardhurat e buxhetit të shtetit brenda katër muajsh pas mbylljes së vitit financiar”.

-Sipas pikës 2 të këtij neni, fitimi neto që rezulton pas gjithë zbritjeve të bëra sipas neneve 8, 9 dhe paragrafit të parë të nenit 10 kalon në të ardhurat e buxhetit të shtetit brenda katër muajsh pas mbylljes së vitit financiar;

Në nenin 11 të ligjit citohet: “Kur mjetet e Bankës së Shqipërisë do të jenë më pak se shuma e detyrimeve të saj dhe e fondit të themelimit, nuk do të bëhet asnjë transferim, shlyerje ose pagesë, sipas neneve 8, 9, e 10 të këtij ligji”. Ky nen tregon detyrimin e Bankës së Shqipërisë për të mos bërë asnjë përdorim të fitimit sipas neneve 8, 9 dhe 10 të ligjit, kur mjetet e saj do të jenë më pak se shuma e detyrimeve të saj dhe fondit të themelimit.

Neni 7 i këtij ligji, ai rregullon mungesën e mjeteve nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë konkretisht citon: Kur në bilancin e Bankës së Shqipërisë vlera e mjeteve të saj bie nën shumën e detyrimeve dhe atë të fondit të themelimit, ministri i Financave, për të mbuluar mungesën e mjeteve, transferon në Bankën e Shqipërisë letra me vlerë shtetërore të tregtueshme, duke zbatuar përqindjet e interesit të tregut.

Në nenin 64 të ligjit citohet: Fitimi ose humbja e Bankës së Shqipërisë, gjatë një viti financiar, të rezultuara nga ndryshimet në vlerësim, të regjistruar në bilancin e Bankës së Shqipërisë, të aktivitetit ose të pasivit, ose të përcaktuar në ar, S.D.R., ose në monedhë të huaj dhe që rrjedhin nga ndonjë ndryshim në vlerë ose kursin e këmbimit të arit, S.D.R.-së, ose të valutave në raport me lekun, do të rregullohet si më poshtë:

a) Shuma totale neto e valutës së fituar ose të humbur do të balancohet me një shumë korresponduese të emëruar "Llogaria e Vlerësimit të Rezervës" në bilancin e Bankës së Shqipërisë.

b) Për sa kohë shuma e regjistruar në llogarinë e vlerësimit të rezervës i korrespondon humbjeve neto në valutë, kjo shumë duhet të mbulohet me letrat me vlerë të borxhit, të cilat mbartin interes sipas interesit të tregut, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë për Bankën e Shqipërisë dhe të mbajtura nga Banka e Shqipërisë në llogarinë e vlerësimit të rezervës së letrave me vlerë jashtë bilancit. Brenda katër muajve pas mbylljes së vitit financiar, shuma kryesore totale e këtyre letrave me vlerë të mbajtura nga Banka e Shqipërisë do të rritet ose zbritet sipas nevojës për të siguruar ekuivalencën midis kësaj shume dhe shumës së regjistruar në llogarinë e vlerësimit të rezervës si humbje neto e valutës në fund të vitit financiar.

c) Si fitimi neto, ashtu dhe humbja neto, të parashikuara në këtë nen nuk duhet të përfshihen në llogaritjen e fitimit neto vjetor të Bankës së Shqipërisë.

Në Marrëveshjen Kuadër midis Bankës së Shqipërisë nr. 5529, datë 29.12.2023 dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave me nr. 24012, datë 29.12.2023 “Për disa ndryshime në marrëveshjen mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjes të BSH, datë 20.01.2015”, janë bërë ndryshimet si në vijim:

Neni 1

Në nenin 3, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “ç” me përmbajtje si vijon: *Detyrime – janë detyrimet e Bankës, pa përfshirë detyrimet ndaj Ministrisë dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.*

Neni 2

1. Në nenin 5, pika 1, te fjalia e parë, shfuqizohet fjala: “e bilancit”.

2. Në nenin 5, pika 4, fjala: “10 (dhjetë)” ndryshohet në: “30 (tridhjetë)”.

Neni 3

Neni 6 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

1. Banka e Shqipërisë, brenda 4 (katër) muajve pas mbylljes së çdo viti financiar dhe pasi janë çertifikuar pasqyrat financiare nga auditori i jashtëm, në rastet kur rezultojnë efekte negative nga rivlerësimi i bilancit valutator të Bankës, informon Ministrinë për vlerën, për të cilën kjo e fundit konfirmon marrjen e informacionit dhe përmbushjen e detyrimeve të mundshme për emetimin e letrave me vlerë me kërkesë të Bankës, sipas pikës 3 të këtij neni.

2. Ky konfirmim regjistrohet në llogaritë jashtë bilancit dhe nuk konsiderohet si pjesë e borxhit publik të Qeverisë.

3. Referuar pikës 1 të këtij neni, në rast se Bankës do t’i lindë nevoja e ushtrimit të kërkesës për emetimin e letrave me vlerë të borxhit, Banka njofton Ministrinë për parashikimet përpara përgatitjes së projekt buxhetit vjetor të shtetit, por jo më vonë se fundi i muajit Gusht i vitit që i paraparin vitit buxhetor kur duhet të lëshohen letrat me vlerë të borxhit, në mënyrë që Ministria të vlerësojë mundësinë e përfshirjes në parashikimet buxhetore për këtë qëllim.

Në udhëzimin “Për njohjen dhe regjistrimin kontabël të provigjioneve në BSH”, miratuar me Vendimin e KM nr. 392, datë 18.02.2013, “Provigjion” është shuma e mbajtur (e ruajtur) e gjykuar si e nevojshme në librat kontabël të BSH, për qëllime të sigurimit të çdo detyrimi ose humbjeje, i cili ose ka mundësi të shkaktohet, ose është e sigurt që do të shkaktohet, por për të cilët koha ose shuma e shlyerjes është e pasigurtë.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse sipas pasqyrave financiare të publikuara

Pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë janë miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 18, datë 20.03.2024 “Për miratimin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023” dhe janë çertifikuar prej audituesit të pavarur me *opinion të pakualifikuar*. Pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2023, krahasuar me një vit më parë për rezultatin financiar dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse paraqiten:

Tabela nr. 1: “Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin 2023 dhe 2022”

	<i>Në milionë lekë</i>	
EMËRTIMI	2023	2022
Të ardhura nga interesat llogaritur me metodën e interesit efektiv	15,716	4,857
Shpenzime për interesa	-2,166	-1,259
Të ardhura nga interesat, neto	13,550	3,598
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	184	150
Shpenzime për tarifa dhe komisione	-47	-45
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet, neto	137	105
Të ardhura/(humbje) nga tregtimi, neto	882	35
Të ardhura nga shitja e aktiveve financiare me vlerën e drejtë	-2,772	-4,165
Humbje/(të ardhura) të tjera, neto	130	24
Fitim/Humbje neto nga ndryshimi në vlerën e drejtë të arit monetar	-128	-98
Humbje neto nga ndryshimet e kurseve të këmbimit	-36,020	-14,473
Totali i të ardhurave	-24,221	-14,974
Rimarrje/(Humbje) nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare neto	-6	-18

Shpenzime për personelin	-1,639	-1,507
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	-360	-356
Shpenzime të tjera të përgjithshme dhe administrative	-826	-795
Rezultati neto për periudhën	-27,052	-17,650
Instrumente borxhi me VDATGJ – ndryshimi neto në vlerën e drejtë	11,526	-13,567
Të ardhura (humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	11,526	-13,567
Totali i fitim/humbjes gjithëpërfshirëse për vitin	-15,526	-31,217

Burimi: Pasqyrat Financiare të BSH për vitin 2023

Nga tabela më sipër rezulton se të ardhurat nga interesat, të cilat llogariten sipas metodës së interesit efektiv, për vitin 2023 rezultojnë në shumën 15,716 milionë lekë, ose krahasuar me një vit më parë 10,859 milionë lekë më shumë. Në mënyrë të detajuar këto të ardhura paraqiten si në vijim:

Tabela nr. 2: “Të ardhurat nga interesat të llogaritura me metodën e interesit efektiv për vitet 2023 dhe 2022”

Në milionë lekë

Të ardhura nga interesat	2023	2022
Investime në tituj borxhi	11,147	3,243
Hua me Bankat	1,416	565
Depozita dhe llogaritë rrjedhëse me Bankat	2,064	268
Llogaritë me FMN-në	1,067	415
Interesa negative për rezervën e detyrueshme	-	46
Interesa negative për tepricën e rezervës së detyrueshme	-	274
Të tjera	22	13
Interesa negative për llogarinë e shlyerjes në AIPS EUR	-	33

Burimi: Pasqyrat Financiare të BSH për vitin 2023

Në kahun e shpenzimeve rezulton se shpenzimet për interesat për vitin 2023 paraqiten në vlerën 2,166 milionë lekë, ose 908 milionë lekë më shumë se viti 2022, në mënyrë analitike zërat e shpenzimeve për interesa, krahasuar më vitin 2022, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 3: “Shpenzimet për interesa të paraqitura në formë analitike për vitet 2022 dhe 2023”

Në milionë lekë

Shpenzimet për interesa	2023	2022
Rezerva e detyrueshme	961	375
Llogaritë e FMN-së	898	321
Llogaritë e Qeverisë Shqiptare	77	10
Depozita të palëve të treta	222	99
Interesa negative nga llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat	8	454

Burimi: Pasqyrat Financiare të BSH për vitin 2023

Të ardhurat nga shitja e aktiveve financiare me vlerë të drejtë, janë humbjet e realizuara nga tregtimi gjatë vitit 2023 të cilat rezultojnë më të ulta krahasimisht me një vit më parë, duke bërë që rezultati neto nga tregtimi të jetë më i lartë sesa viti 2022 për vlerën 1,393 milion lekë, në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 4: “Të ardhurat nga shitja e aktiveve financiare me vlerë të drejtë për vitet 2023 dhe 2022”

Në milionë

lekë

Përshkrimi	Viti 2023	2022
Fitimi neto nga shitja e titujve të borxhit	278	274
Humbja neto nga shitja e titujve të borxhit	(3,050)	(4,439)
Totali	(2,772)	(4,165)

Burimi: Pasqyrat Financiare të BSH për vitin 2023

Zëri “Humbje neto nga ndryshimet e kurseve të këmbimit” rezulton me një diferencë të konsiderueshme krahasuar me vitin 2022, kryesisht për shkak të humbjes neto nga këmbimi, konkretisht:

Tabela nr. 5: “Humbjet neto nga këmbimi për vitin 2023 dhe 2022”

Në milionë lekë

Përshkrimi	2023	2022
Humbja neto nga këmbimi (jo nga aktivet dhe detyrimet e tregtueshme)	(34,237)	(14,566)
Humbja neto për aktivet dhe detyrimet e tregtueshme	(1,783)	93
Totali	(36,020)	(14,473)

Burimi: Pasqyrat Financiare të BSH për vitin 2023

Pasqyra e ndryshimeve në kapital, krahasuar me vitin 2022, paraqitet:

Tabela nr. 5: “Pasqyra e ndryshimeve në kapital për 2023, 2022”*Në milionë lekë*

	Kapitali	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva vlera e drejtë	Rezerva të tjera	Fitim/humbje e mbartur	Totali
31.12.2022	2,500	12,500	25,721	(20,566)	(13,922)	2,188	(3,323)	5,098
Rezultati neto për periudhën							(27,052)	(27,052)
Rezerva për vlerën e drejtë					11,526			11,526
Rezerva për mbulimin e pamjaftueshmërisë								
Transferime në rezerva				(36,147)		(53)	36,200	
Kompesimi i titullit për pamjaftueshmërinë e mjeteve për vitin 2022							(6,257)	(6,257)
31.12.2023	2,500	12,500	25,721	(56,713)	(2,396)	2,135	(432)	(16,685)

Burimi: Pasqyrat Financiare të BSH për vitin 2023

Rezultati neto për periudhën paraqitet në vlerën 27,052 milionë lekë, paraqitet si rezultat i të ardhurave totale nga operacionet bankare, humbjes nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare, shpenzimeve për personelin, shpenzimeve të zhvlerësimit dhe amortizimit dhe shpenzimeve të tjera administrative.

Fitimi për t’u shpërndarë Qeverisë nga Banka e Shqipërisë për vitin 2023, është detajuar si më poshtë:

Tabela nr. 6: “Fitimi për t’u shpërndarë Qeverisë 2023 dhe 2024”*Në milion lekë*

	Shënimi	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Rezultati neto për periudhën		(27,052)	(17,650)
Transferimi në rezerva	22	36,147	14,571
Shpërndarja nga fitimi për vitin		9,095	(3,079)
Shpërndarja nga rezerva të tjera	22	53	53
Totali për tu transferuar për kompesimin e titullit të borxhit për pamjaftueshmërinë e mjeteve (neni 10 i Ligjit)	14	(6,257)	
Totali që do t’i transferohet fitim/humbjeve të mbartura		2,891	(3,026)
Totali që do t’i shpërndahet Qeverisë		-	-

Burimi: Pasqyrat Financiare të BSH për vitin 2023

Fitimi i Bankës së Shqipërisë për vitin 2023 është miratuar me vendimin nr. 14, datë 06.03.2024 të Këshillit Mbikëqyrës. Sipas këtij vendimi Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar:

a. Të ardhurat neto nga aktiviteti i BSH për vitin 2023 në vlerën 9,105,739,775.13 lekë, detajuar si në vijim:

Tabela nr. 6: “Pasqyra e të ardhurave neto”*Në milionë lekë*

EMËRTIMI	2023
Të ardhura nga interesat llogaritur me metodën e interesit efektiv	15,716
Shpenzime për interesa	(2,166)
Të ardhura nga interesat, neto	13,549
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	184
Shpenzime për tarifa dhe komisione	(47)
Të ardhura nga tarifatat dhe komisionet, neto	137
Të ardhura/(humbje) nga tregtimi, neto	881
Humbje/(të ardhura) të tjera, neto	(2,642)
Të ardhura nga operacionet bankare	(1,760)
Shpenzime për personelin	(1,638)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	(359)
Shpenzime të tjera të përgjithshme dhe administrative	(822)
Shpenzime administrative	(2,821)
Të ardhurat neto	9,105

Burimi: Pasqyrat Financiare të BSH për vitin 2023

b. Njohjen dhe regjistrimin e provigjioneve për vitin 2023 në vlerën 11,140,444.82 lekë.

Nga auditimi konstatohet se ndryshimet e provigjioneve për vitin 2023 paraqiten si në vijim:

Tabela nr. 7: “Ndryshimet në llogarinë provigjione gjatë vitit 2023”

Në lekë

Paditës/i paditur/lloji i padisë	Vlera e padisë për provigjionet ligjore dhe kreditë e punonjësve	Vlera e prov. me ndryshime 01.01.2023	Ekzekutime prov.gjithsej 2023	Shtesa prov. 2023	Rimarrje prov gjithsej 2023	Vlera e provigj me ndryshime 31.12.2023
Adriana Lajthia I paditur: BSH Lloji i padisë: Marrëdhënie pune	Rishikim provigjioni, shkresa nr. 5492, prot., datë 29.12.2023	10,000,000		3,991,725		13,991,725
	Shuma			3,991,725		
	Provigjionet dhe humbjet e pritshme nga krediti			Shtesa gjithsej prov.2023	Rimarrje gjithsej prov.2023	
	Letra me vlerë me të ardhura fikse (për shtesa prov, sipas urdhrin nr. 432, datë 25.01.2021)			795,680.19	(611,998.63)	
	Llogari rrjedhëse depozita institucione finan (për shtesa prov. Sipas urdhrin nr. 432, datë 25.01.2021)			6,353,093.63	(38,773.12)	
	Shuma			7,148,719.82	(650,771.75)	
	Shtesa dhe rimarrje prov në total			11,140,444.8	(650,771.75)	

Burimi: Pasqyrat Financiare të BSH për vitin 2023

Sipas Udhëzimit nr. 392, datë 18.02.2013 “Për njohjen dhe regjistrimet kontabël të provigjioneve në Bankën e Shqipërisë”, Banka llogarit dy lloje provigjionesh:

1. Për llogari të dyshimta dhe pa shpresë arkëtimi; dhe
2. Për detyrime të rrjedhura nga proceset gjyqësore.

Nga tabela më sipër rezulton se provigjionet për çështjet gjyqësore për vitin 2023, për vitin 2023, janë riparë në rritje në shumën 3,991,725 lekë, dhe në fund të vitit 2023 vlera paraqitet 13,991,725 lekë, që i takon 1 rasti. Ndërsa për provigjionet në lidhje me humbjet financiare të mundshme gjatë vitit janë shtuar në shumën 7,148,719.82 lekë dhe janë rimarrë në shumën 650,771.75 lekë.

c. Fitimin neto nga aktiviteti i BSH për vitin 2023 në vlerën 9,095,250,102.06 lekë.

Kjo vlerë është rezultat i diferencës së të ardhurave neto nga aktiviteti i BSH, pakësimit nga shpenzimet neto të provigjioneve. Këto të fundit janë diferencë midis provigjioneve për vitin 2023 dhe rimarrjeve nga provigjionet në shumën 650,771.75 lekë.

d. Fitimin për t’u përdorur në vlerën 9,147,801,427.63 lekë.

Kjo vlerë është si rezultat i shumës së:

- fitimit neto të BSH për vitin 2023 në vlerën 9,095,250,102.06 lekë.
- rimarrjes së amortizimit për vitin 2023, nga rivlerësimi i godinave të BSH në vite, në vlerën 52,551,325.57 lekë, në zbatim të pikës 4 të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 19, datë 15.03.2018 “Për rialokimin dhe alokimin e disa prej rezervave të BSH”.

e. Nga fitimi (vlera 9,147,801,427.63 lekë), vlera prej 6,257,367,359.50 lekë do të përdoret për kompensimin e titujve të borxhit të emetuara nga Ministria e Financave për mbulimin e mungesës së mjeteve më 31.12.2022.

f. Pjesa e mbetur e fitimit prej 2,890,434,068.13 lekë, në zbatim të pikës 6 të vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 02.03.2022 dhe nr. 8, datë 01.03.2023, do të përdoret për kompensimin e humbjeve të mbartura të regjistruara në llogarinë “Humbje e mbartur nga vitet e kaluara”.

g. BSH nuk do të transferojë vlera monetare në buxhetin e shtetit, derisa llogaria “Humbje e mbartur nga vitet e kaluara” të rezultojë në vlerën 0 lekë.

Nga auditimi konstatohet se: shpenzime të tjera të përgjithshme dhe administrative sipas pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, rezultojnë në vlerën 826 milionë lekë, ndërkohë në aneksin e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, miratuar me vendimin nr. 14, datë 06.03.2024, ky zë rezulton 822 milionë lekë, pra 4 milionë lekë më pak, pasi:

Në llogaritjen e fitimit zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin e Bankën e Shqipërisë, ndërsa në Pasqyrat Financiare paraqitet rezultati i Bankës në përputhje me Standardet e Raportimit Financiar. Këto shpenzime sipas SNRF-ve janë zë i veçantë në Pasqyrat Financiare. Konkretisht:

Në zbatim të dispozitave ligjore, fitimi neto i BSH llogaritet pasi nga të ardhurat neto zbriten shpenzimet neto për provigjione. Pjesë përbërëse të ardhurave neto për vitin 2023 (në vlerën 9,106 milion lekë) janë dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme dhe administrative në vlerën 822 milion lekë. Shpenzimet neto për provigjione në vlerën prej 10 milion lekë, përbëhen nga:

-shpenzime për provigjione për çështje gjyqësore në vlerën prej 4 milion lekë.

-shpenzime për humbje të pritshme nga krediti në vlerën prej 6 milion lekë.

Për sa më lart, bazuar në vendimin nr. 14, datë 06.03.2024 “Për miratimin e fitimit të BSH”, fitimi neto për vitin 2023 është 9,095 milion lekë.

Në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:

-Shpenzimet për provigjione në vlerën 4 milion lekë paraqiten në zërin e shpenzimeve të tjera të përgjithshme dhe administrative duke bërë që totali i tyre të jetë 826 milion lekë (822 milion +4 milion).

-Shpenzime për humbje të pritshme nga krediti, në vlerën prej 6 milion lekë klasifikohen në zërin humbje nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare neto, në vlerën 6 milion lekë.

2.7 Mbi mbajtjen dhe administrimin e rezervës valutore të Republikës së Shqipërisë.

Rezervat e bankës krahasuar me një vit më parë paraqiten në mënyrë të detajuar si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 1: “Paraqitja e rezervave për 2023 dhe 2022”

Në milionë lekë

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Fondi i Themelimit	2,500	2,500
Rezerva për bilancin e pagesave	7,209	7,209
Rezerva për mbulimin e pamjaftueshmërisë së mjeteve	6,020	6,020
Rezerva në ar dhe metale të çmuara	7,042	7,042
Rezerva ligjore	12,500	12,500
Rezerva si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve	5,450	5,450

Rezerva për bilancin e pagesave nuk ka pësuar ndryshim që prej vitit 1995 dhe përfaqëson grantet e dhëna nga Komuniteti Europian gjatë viteve 1992-1993.

Rezerva për mbulimin e pamjaftueshmërisë së mjeteve përfaqëson titullin e lëshuar nga Ministria e Financave me vlerë nominale 6,020 milionë lekë, duke qenë se më 31.12.2022, totali i fondit themeltar dhe detyrimeve të bankës tejkalon mjetet e saj në vlerën 3,433 milionë lekë.

Rezerva në ar dhe metale përfaqëson rezervën e krijuar bazuar në ligjin nr. 9862, datë 24.01.2008 “Për transferimin e pronësisë së arit dhe metaleve të çmuara nga Këshilli i Ministrave të BSH”.

Neni 9 i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, i ndryshuar, “Për Bankën e Shqipërisë” citon se: “Banka e Shqipërisë krijon një fond të rezervës së përgjithshme. Në fund të cdo viti financiar ky fond shtohet me një shumë prej 25% të fitimit neto të BSH, derisa fondi i rezervës së përgjithshme të arrij në 500% të fondit të themelimit të BSH”.

Rezultoni se nga ana e BSH, kjo kërkesë është përmbushur që prej 31.12.2011, kur është arritur shuma prej 12,500 milionë lekë.

Rezerva si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve në shumën prej 5,450 milionë lekësh, është krijuar bazuar në Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të BSH nr. 19 dhe nr. 20, datë 15.03.2018, si rezultat i rishpërndarjes dhe shpërndarjes së rezervës së tranzicionit.

Nga auditimi konstatohet se në lidhje me këtë rezervë nuk rezulton që Banka e Shqipërisë të ketë dokument/manual/udhëzim që të përcaktojë mënyrën implementimit të standardeve, menaxhimit të tranzicionit drejt SNRF-ve si dhe krijimin dhe përdorimin e rezervës së krijuar për këtë qëllim.

Rezervat neto të përfunduar përfaqësojnë rezervën e rivlerësimit nga kursi i këmbimit, rezervën e rivlerësimit për vlerën e drejtë të letrave me vlerë dhe rezervën e rivlerësimit për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, në shumën 2,135 milionë lekë, krijuar në zbatim për herë të parë të SNRF-ve. Për vitin 2023, shuma prej 53 milionë lekë është shtuar në rezultatin financiar të këtij viti dhe është transferuar të “Humbjet e mbartura”, për pakësimin e humbjes. Tabela nr. 2: “Paraqitja e rezervave të rivlerësimit, viti 2023 dhe 2022”

Në milionë lekë

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Rezerva e rivlerësimit	(56,713)	(20,566)
Rezerva për vlerën e drejtë (investime në tituj borxhi)	(2,396)	(13,922)
Rezerva e rivlerësimit për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara	2,135	2,188
Totali	(56,974)	(32,300)

Burimi: Pasqyrat Financiare të BSH për vitin 2023

Në zbatim të shkronjave “a” dhe “c” të nenit 64 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, lëvizja në rezervën e rivlerësimit rezulton nga zërat e mëposhtëm, të cilët fillimisht njihen në fitim ose humbje dhe më tej transferohen në rezervën e rivlerësimit.

Tabela nr. 3: “Paraqitja e rënies së vlerës së rezervës së rivlerësimit për vitin 2023 dhe 2022

Në milionë lekë

	2023	2022
Gjendja më 1 janar	(20,566)	(5,995)
Humbja neto nga këmbimi (jo nga aktivet e tregtueshme)	(34,237)	(14,566)
Humbja neto nga këmbimi për aktivet dhe detyrimet e tregtueshme	(1,783)	93
Humbja neto nga ndryshimet në vlerën e drejtë të arit monetary	(128)	(98)
Gjendja më 31 dhjetor	(56,713)	(20,566)

Burimi: Pasqyrat Financiare të BSH për vitin 2023

Rënia e rezervës së rivlerësimit me 36,148 milionë lekë (2022: rënie 14,571 milionë lekë) është rezultat i zhvlerësimit të arit monetar dhe monedhave të huaja EUR, USD, GBP përkundrejt lekut.

Nëse e analizojmë impaktin negativ sipas monedhave (në milionë lekë) rezulton si në vijim:

Tabela nr. 4: “Ndikimi në rezervat e rivlerësimit sipas llojit të monedhave për vitin 2023”

Monedha	Vlera
JPY	(2,233)
USD	(10,981)
EUR	(18,824)
GBP	(924)
SDR	(463)
XAU	(128)
AUD	(680)
CNH	(1,915)
Totali	(36,148)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Nga tabela më sipër rezulton se impaktin më të madh negativ e ka pasur monedhat Euro dhe USD.

Rezerva negative e rivlerësimit:

Lëvizjet në rezervën e rivlerësimit me vlerën e drejtë të titujve të borxhit (letrave me vlerë) paraqiten si në vijim:

Tabela nr. 5: “Lëvizjet në rezervën e rivlerësimit”

Në milionë lekë

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Gjendja më 1 janar	(13,922)	(355)

Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë	11,526	(13,567)
Gjendja më 31 dhjetor	(2,396)	(13,922)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Nga ana e Bankës së Shqipërisë me shkresën nr. 1679, prot., datë 15.04.2024 të Zv. Guvernatorit të Parë është bërë kërkesë për mbulimin e vlerës negative të llogarisë “Rezerva e rivlerësimit të valutave”. Sipas kësaj shkrese bëhet me dije se në përfundim të procesit të auditimit të pasqyrave financiare të BSH për vitin 2023, llogaria “Rezerva e rivlerësimit të valutave” rezultoi me gjendje negative në 56,737,912,520.53 lekë.

Ashtu si është njoftuar me anë të shkresës nr. 893 prot., datë 24.02.2023 “Mbi njoftimin për regjistrimin në bilanc të Letrës me vlerë të qeverisë emetuar për BSH”, në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nevojën për forcim të kapitalit të saj, Banka e Shqipërisë ka regjistruar në bilancin e saj në muajin dhjetor 2022, titullin e borxhit të emetuar nga Ministria e Financave, me maturim 6 muajor në vlerën 6,019,805,285.06 lekë, me datë emetimi 22.12.2022 dhe afat maturimi/rinovimi 22.06.2023 për mbulimin e vlerës negative të “Rezervës së Rivlerësimit të Valutave” në 31.12.2021.

Në datën 26.12.2023, në vijim të kërkesës së BSH për rinovimin e titullit të borxhit të qeverisë, i cili në mbyllje të vitit 2022 u regjistrua në bilancin e Bankës për mbulimin e mungesës së mjeteve, Ministria e Financave me anë të shkresës nr. 23254/1, datë 26.12.2023, njoftoi mbi rinovimin e këtij titulli borxhi duke përfshirë/kapitalizuar edhe interesin e akumuluar.

Në kushtet kur në 31.12.2023, aktivet e Bankës nuk janë më pak se shuma e kapitalit të paguar dhe detyrimeve të saj (detyrimet ndaj palëve të treta, duke përfshirë detyrimet ndaj Qeverisë dhe FMN-së), titulli i borxhit i lartpërmendur është kompensuar për vlerën e plotë nga fitimi financiar 2023 në zbatim të:

-nenit 10, pika 1 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, i cili parashikon se mbetja nga fitimi neto për vitin financiar do të përdoret për kompensimin e titujve të borxhit që i janë dhënë BSH;

-pikës 5 të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 14, datë 06.03.2024. Me shkresën nr. 5069/1 prot., datë 17.05.2024, Ministria e Financave ka kthyer përgjigje mbi njoftimin për vlerën negative të llogarisë “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave” për 31.12.2023 dhe mbi kompensimin e titujve shtetëror të emetuar nga Ministria e Financave, në zbatim të Marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të BSH pranë MF, dhe mbulimin e humbjeve të BSH datë 20.01.2015”, të ndryshuar me Marrëveshjen me nr. prot., 24012, datë 29.12.2023, MF ka konfirmuar për sa përcaktohet në pikën 1 të nenit 6 të marrëveshjes të sipërcituar.

Për sa më sipër konstatohet se nga ana e Ministrisë së Financave nuk është zbatuar afati i përcaktuar pasi sipas nenit 64 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ky veprim duhet të ishte bërë brenda muajit Prill 2024, ndërkohë është bërë në muajin Maj 2024.

2.3 Mbi marrëdhëniet ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe shtetit shqiptar.

Në zbatim të Drejtimit 3 të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë për periudhën 01.01.2023-31.12.2023:

- Marrëveshja Kuadër midis Ministrisë së Financave (MF) dhe Bankës së Shqipërisë (BSH) me nr. 251 Prot., datë 16.01.2015 në BSH dhe nr. 716/1 Prot., datë 20.01.2015 në MF, e ndryshuar;
- Mendime/komente të përgatitura nga Banka e Shqipërisë për akte normative, strategji, projektligje, etj;
- Analiza periodike ekonomike dhe monetare të përgatitura nga BSH;
- Investimet në depozitë të tepricave të likuiditetit përgjatë vitit 2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Mbi mendimet e dhëna nga Banka e Shqipërisë

Referuar Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Kreun IV përcaktohen marrëdhëniet ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe shtetit shqiptar. Përkatësisht neni 24 përcakton bashkëpunimin ndërmjet BSH dhe organeve legjislativë dhe ekzekutive për të përmbushur objektivat e saj. Bankës së Shqipërisë i jepet për mendim çdo akt normativ që i dërgohet për miratim Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, me karakter ekonomik dhe me pasoja në fushën e politikës financiare, monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore. Në këtë kuadër, grupit ka shqyrtuar dokumentacionin mbi mendimet e përgatitura nga BSH si në vijim:

Me shkresën nr. 580/1 prot., datë 20.02.2023, Banka e Shqipërisë ka dërguar komente drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi Dokumentin Politik “Për Krijimin e një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”, të cilat konsistojnë kryesisht në:

- Fokusi i strategjisë duhet të mbetet të zhvillimi gradual i tregut dhe objektivat si krijimi i bursave, i tregjeve të “cover bonds” apo derivativëve gjykohen të paarrtshme në harkun kohor 5 vjeçar.
- Objektiva sasiorë dhe cilësorë të shprehur më thjesht dhe më qartë dhe me mundësi realizimi brenda harkut kohor prej 5 vite;
- Aplikimi i lehtësirave fiskale për nxitjen e investimit;
- Krijimi i organeve si Gjykatë, ose Dhomë e Posaçme në Gjykatën Administrative për zgjidhjen e konflikteve në tregun financiar si dhe të një Ombudsmeni Financiar për të siguruar mbrojtje për ata që angazhohen/përfitojnë shërbime financiare.

Me shkresën nr. 5190/1 prot., datë 12.12.2023, Banka e Shqipërisë ka dërguar mendimin e kërkuar nga Ministria e Financave për projektvendimin “Për realizimin e rritjes së përgjithshme të kapitalit të Republikës së Shqipërisë në IBRD”, ku shprehet se nga ana e BSH nuk shihet e nevojshme për përfshirjen e saj si institucion zbatues i Projektvendimit, pasi marrëdhëniet e BSH me MF për shlyerjen e urdhër-pagesave janë të rregulluara nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër si dhe marrëveshjeve të veçanta pjesë përbërëse e Marrëveshjes Kuadër.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka përgatitur mendimet tremujore lidhur me kalendarin e emetimeve përgjatë vitit 2023, të cilat i ka dërguar drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si në vijim:

- *Për planin e huamarrjes 2023 dhe kalendarin e emetimeve të tremujorit të parë Q1 – 2023*
- Nga ana e Bankës së Shqipërisë lidhur me planin e huamarrjes dhe kalendarin e emetimeve për katër mujin e parë të vitit 2023 janë dërguar mendimet përmes email të datës 12 Dhjetor 2022 në përgjigje të kërkesës nga MFE mbërritur me email e datës 7 Dhjetor 2022, ku theksohet se rritja e frekuencës së parashikuar të emetimeve në tregun primar do të ndikojë në mungesë të veprimeve në treg sekondar duke shkuar mbrapa në përpjekjet për gjallërimin e tregut sekondar. Gjithashtu, nga BSH argumentohet se emetimi një titulli variabël rrit ekspozimin ndaj rrezikut të normave të interesit duke mos i shërbyer objektivit të SMB, pra për realizimin e huamarrjes me koston më të ulët duke menaxhuar rreziqet. Për më tepër, ulja e emetimeve 10 dhe 15 vjeçare, dhe heqja e emetimit 7 vjeçar fikso penalizon individët dhe shkon kundërsht fushatës së marketingut të bërë kundërsht këtij grupi investitorësh, si dhe ndikon negativisht në kohëzgjatjen e stokut të borxhit. Sa i takon normave të interesit, BSH argumenton se financimi i përqendruar në muajin Janar prej 14 miliard lekë, anon nga kahu optimist në kushtet kur bankat janë ende në proces të planeve të investimit dhe një nivel i tillë do vijojë të mbajë në presion normat e interesit. BSH shprehet se emetimi i muajit Shkurt në 6 miliard lekë shihet me rrezik tejet të lartë realizimi.

- Për kalanderin e emetimeve të tremujorit të dytë Q2 – 2023

Referuar kërkesës së MFE përmes email të datës 9 Mars 2023, BSH ka dërguar mendimet mbi draft kalendarin e emetimeve të katër mujorit të dytë të vitit 2023 nëpërmjet email të datës 10 Mars 2023. Lidhur me këtë kalendar, Banka e Shqipërisë thekson se financimi pritet të mbështetet tek emetimet afatmesme dhe afatgjata dhe duke maturuar neto emetimet deri në 1 vit, çka në parim është pozitive, por duke shfaqur disa problematika si:

- rënia e rregullsisë së emetimeve afatshkurtra 3-6 mujore, ku nga 3 ankande 3 mujore që maturohen, do të kryhet vetëm një i tillë dhe nga 3 ankande 6 mujore do të kryhen 2 tillë.
- pritshmëri për ulje relativisht të konsiderueshme të emetimeve 12 mujore duke krijuar volatilitet në madhësi (mesatarisht 11-12 miliardë lekë në tremujorin e parë duke zbritur në 6.5-8 miliard lekë në tremujorin e dytë), si dhe duke shkaktuar problematika në shpërndarjen e likuiditetit në sistemin bankar, pjesëmarrjen e BSH dhe në të njëjtën kohë potencialisht edhe volatilitet në normat yield për shkak të ofertës. Në këtë linjë, BSH ka sugjeruar që problematikat e mundshme që lidhen me gjetjen e likuiditetit për maturimin e emetimit 2 vjeçar të zgjidhen përmes kontratave SĚAP dhe/ose me vijimin e emetimeve afatshkurtra 3 dhe 6 mujore dhe të mos emetohet linjë e re 12 mujore, por likuiditeti prej 5 miliard lekë të rishpërndahet në emetimet e mëpasshme 12 mujore duke ndikuar pozitivisht në këto problematika.
- rihapja çdo muaj e emetimeve nga MFE të linjave 3 dhe 5 vjeçare në shuma të alternuara 2-3 miliard lekë do t'i çonte këto emetime rreth nivelit mbi 30 miliard lekë për horizontin kohor të 1 viti duke përkeqësuar problematikën e tyre në momentin e roll over-it. Ndaj, BSH sugjeron që nëse do të vijohet me idenë e rihapjes mujore, shumat e emetimit duhet të ulen në 1.5-2 miliard lekë dhe të mbahet një shpërndarje uniforme gjatë vitit.
- sa i takon planifikimeve të MFE për emetimin e ri 10 vjeçar në muajin Prill në shumën 3 miliard lekë si dhe për atë 7 vjeçar në muajin Maj me vlerë 3 miliard lekë dhe rihapjen e këtij të fundit në muajin Qershor me 3 miliard lekë, BSH sugjeron që të mbahet strategjia e ndjekur në vitet e fundit, ku emetimet e reja të kryera në tremujorin e parë Q1 duhet të pasohen me rihapje në tremujorin e dytë Q2, duke i çuar në shumat rreth 6 miliard lekë për çdo linjë ku emetimi fillestar të jetë më i lartë se rihapja, përpara se të vijohet me emetim të ri. Ndaj, sugjerohet që linjat 7 dhe 10 vjeçare të rihapen 2 herë gjatë Q2 me shuma rreth 2 miliardë/ankand për të kompensuar emetimin e ulët në Q1. Gjithashtu, në Q3 të rifillohet me strategjinë e mëparshme: 1 ankand për çdo tremujor, një hapje dhe një rihapje me shumë totale 6 – 7 miliardë/linjë.
- BSH sugjeron mundësinë e rishikimit të rihapjes së emetimit të linjës 15 vjeçare në shumën 1-1.5 miliardë lekë pas suksesit të saj në Q1 si një alternativë shtesë për rritje të mëtejshme të financimit.
- Me qëllim uljen e riskut të roll over, BSH sugjeron që MFE duhet të planifikojë në vijimësi ankande buyback të emetimeve benchmark. Gjithashtu, në baza oportuniste të tregut MFE mund të tregohet edhe më agresive në planifikimin e shumave blerëse, siç është rasti i rënies së normave yield. Titujt që nevojitet të kryhet një buyback pjesor janë linja 5 vjeçare që maturohet në muajin Korrik 2023 në shumën 13.75 miliard lekë, 5 vjeçare që maturohet në Janar 2024 në shumën 20.7 miliard lekë dhe 3 vjeçare që maturohet në Shkurt 2024 në shumën 21.5 miliard lekë, sidomos këto dy emetimet e fundit. Nisur nga shkalla relativisht e mirë e realizimit të financimit BSH sugjeron që MFE të planifikojë për çdo 3 mujor rreth 3-4 miliard lekë ankande buyback apo 9-12 miliard lekë me qëllim zbutjen e riskut të roll over në emetimet e mësipërme.

Për kalendarin e emetimeve të tremujorit të tretë Q3 2023

Rezulton se BSH ka dërguar mendimet mbi draft-kalendarin e emetimeve Q3 përmes email të datës 14 Qershor 2023, në përgjigje të kërkesës së MFE përmes email të datës 13 Qershor 2023, ku mendimet për realizimin e financimit jepen në mënyrë të përmbledhur si në vijim.

Duke qenë se kalendari i emetimeve Q3 parashikon një financim neto prej -9.3 miliard lekë duke e zbritur në +24.2 miliard lekë në fund të Q3, duke përfshirë dhe 4 miliard lekë blerje

mbrapsht të emetimeve që maturohen në Janar-Shkurt 2024 dhe për të cilat ankandet e zhvilluara në muajin Qershor rezultuan të pasuksesshme, BSH sugjeron që MFE të tregohet më agresive në ankandet buyback për titujt benchmark që madhësia në momentin e rinovimit të jetë në nivelet 10-13 miliard lekë për secilën linjë, duke propozuar që për secilin emetim të blihen rreth 4 miliard lekë çdo tremujor dhe ankandet të jenë të shpërndara në shumën 1-2 miliard lekë.

Gjithashtu, sugjerohet që maturimet neto të mos jenë në shkallën e parashikuar, por të marrin në konsideratë edhe shtimin e blerjeve mbrapsht të titujve referencë. Kjo mund të kryhet si me rritjen e madhësisë së emetimit fillestar 10 vjeçar në 3 miliard lekë (pra +1 miliard lekë) si dhe në rregullimin e shumave të emetimeve 12 mujore ose 2 vjeçare (+3 miliard lekë) duke siguruar në total 4 miliard lekë shtesë për blerjet mbrapsht.

Duke qenë se emetimi i ri 2 vjeçar në shumën 7 miliard lekë në muajin Korrik është tejet i lartë dhe prish rregullsinë e madhësisë së emetimeve 4-5 miliard lekë, ndryshimet e forta në madhësinë e emetimeve diktojnë dukshëm në volatilitetin e normave yield dhe raportet e mbulimit, ndaj BSH propozon uljen në nivelin 5 miliard lekë dhe shpërndarjen e shumës në rihapjes pasardhëse.

Për më tepër, në kalendar parashikohet që në muajin Gusht 2023 të kryhet ankandi i emetimit të ri 7 vjeçar në shumën 2 miliard lekë dhe një muaj më pas të rihapet në shumën 2.5 miliard lekë. Në këtë kuadër, BSH sugjeron të bëhet rregull që emetimet fillestar të kryhen në një shumë më të lartë sesa rihapjet, pasi përgjithësisht oferta fillestare tërheq gjithmonë vëmendje më të shtuar në treg si emetim i ri si dhe për faktin që shfrytëzohet më gjerë kërkesa jo-konkurruese e individëve, çka nuk është prezente në ankandet e rihapjes.

Për kalendarin e emetimeve të tremujorit të katërt Q4 2023

Sa i takon kalendarit të tremujorit të katërt, BSH ka dërguar mendimet përmes email të datës 12 Shtator 2023 drejt MFE, pas kërkesës së kësaj të fundit me email e datës 8 Shtator 2023, ku BSH është shprehur se edhe pse në pamje të parë financimi gjatë 9 muajorit rezulton në shkallë të lartë rreth 20.3 miliard lekë nga 25 miliard lekë të targetuar në fund të vitit, ekzistojnë dy risqe kryesore:

1. Shkalla e lartë e ankandëve të pazhvilluara deri në fund të tremujorit të tretë Q3 si dhe rezultati disi i dobët në ankandin 5 vjeçar mund të krijojë pasiguri mbi nivelin e realizuar të financimit në Q3 dhe si rrjedhojë kalendarit Q4 të targetojë një shumë më të ulët sesa plani vjetor;
2. Risku i emetimeve benchmark në kushtet kur ankandet e blerjes mbrapsht mbeten të kufizuara mbetet shumë i lartë dhe për më tepër ndikon në mbarëvajtjen e planifikimit të emetimeve të reja benchmark duke kushtëzuar një deformim të skedulit të emetimeve/rihapjeve të saj dhe më pas rihapje periodike me shuma relativisht të moderuara, çka deformon raportet e mbulimit dhe me pasoja në volatilitetin e normave yield. Ndaj, BSH sugjeron që MFE të kryejë një planifikim më të plotë për ankandet buyback duke zbutur këto problematika ose të mbajë një shkallë më të lartë të likuiditetit për të përballuar maturimet duke ruajtur një nivel të lartë uniformiteti në shumat e emetimeve në ankandet benchmark. Ndaj, sugjerohet që mund të ketë potencial për rivlerësimin e kalendarit të ankandëve buyback në Q4 duke kryer të paktën një raund tjetër blerjesh prej 2 miliard lekë secila për çdo emetim.

Përpos risqeve të evidentuara, BSH ka sugjeruar se rihapjet e emetimeve benchmark duhet të marrin në konsideratë që shuma totale e emetimeve për çdo linjë nuk duhet të kalojë më shumë se 25 miliard lekë, siç është dakordësuar në parim dhe me bankat, ashtu dhe faktin që frekuenca më e dendur e emetimeve duhej të shoqërohej me ulje të shumës së emetimit për të mbajtur një shkallë të lartë të raportit të mbulimit. Sugjerohet që shumat e emetimeve në ankandet 5 vjeçare dhe 3 vjeçare duhen ulur sidomos në emetimin 5 vjeçar. Gjithashtu, sugjerohet shpërndarje e emetimit në formën 4-3-3, ose e një natyre të ngjashme me rritje për të përballuar uljen e financimit që vjen nga ulja e emetimeve benchmark apo rritja e ankandëve buyback.

Edhe pse në pari vlerësohet orientimi i emetimit të ri drejt emetimeve me maturitet afatgjatë me qëllim rritjen e kohëzgjatjes mesatare të stokut të borxhit, BSH sugjeron që parashikimi për maturimin e emetimit 12 mujor prej 3.99 miliard lekë në muajin Tetor të rivlerësohet, madje të rritet në 5-6 miliard lekë, duke marrë parasysh nevojat për financim në rritje nga ulja e emetimeve benchmark dhe/ose rritja e emetimeve buyback. Në këtë kuadër, sugjerohet që maturitetet e linjave ekzistuese 12 mujore të jenë të rezervuara duke marrë parasysh faktin që një pjesë e kërkesës në këto ankande është stacionare dhe shuma që nevojitet të ulet, të rregullohet në uljen e emetimeve në ankandet e radhës.

Banka e Shqipërisë ka dhënë opinion edhe për Projektbuxhetin e vitit 2024, bazuar në 3 drejtime kryesore, ku edhe ka sugjeruar sipas drejtimeve:

1. Konteksti makroekonomik dhe politika fiskale.

Banka e Shqipërisë ka theksuar se shkalla e mbledhjes së të ardhurave publike në vend, aktualisht rreth nivelit 28% të PBB-së, mbetet relativisht e ulët në krahasim me atë të vendeve të rajonit, mesatarja e të cilave qëndron rreth nivelit 36% të PBB-së. Në këtë kontekst, BSH ka gjykuar se konsolidimi në kohë i shëndetit të financave publike duhet të bazohet në rritjen progresive të nivelit të grumbullimit të të ardhurave. Kjo përjasje ndihmon qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe ruan hapësirat e nevojshme për shpenzime në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit, e më konkretisht për investime në arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë. Së dyti, rritja e qëndrueshme e të ardhurave publike duhet të kalojë nga një linjë aksioni, e cila duhet të synojë fillimisht reduktimin e informalitetit dhe më tej të shikojë hapësirat për thjeshtimin dhe drejtpeshimin e barrës tatimore, midis kategorive të ndryshme ekonomike dhe shtresave sociale.

2. Mbi rritjen e efektivitetit dhe ruajtjen e fleksibilitetit të financave publike.

Banka e Shqipërisë ka sugjeruar së pari, adoptimin e një plani pune, i cili duhet të synojë rritjen e qëndrueshme të nivelit të të ardhurave publike. Drejtimi primar i punës në këtë drejtim duhet të jetë reduktimi i informalitetit dhe rritja e shkallës së grumbullimit të të ardhurave, brenda kuadrit tatimor ekzistues. Paralelisht, BSH mbështet përpjekjet për adoptimin, në një kohë sa më të arsyeshme, të një strategjie afatmesme të të ardhurave publike. Duke qëndruar në këtë pikë, BSH sugjeron nevojën e rishikimit periodik të eficiencës së përjashtimeve tatimore. Këto lehtësi, të cilat synojnë mbështetjen e kategorive të caktuara shoqërore apo incentivimin e sektorëve prioritarë, kanë një kosto jo të pakët mbi financat publike. Për këtë arsye, zbatimi i tyre duhet të bazohet në analiza më të plota të kostove e përfitimeve që këto përjashtime kanë mbi financat publike dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Së dyti, në drejtim të strukturës së shpenzimeve, BSH sugjeron mundësinë e adoptimit të një objektivit operacional afatgjatë, i cili të garantojë ruajtjen e një balance korrente pozitive, në një nivel të caktuar.

Së treti, BSH thekson se realizimi i treguesve të buxhetit, në veçanti i planit të investimeve, duhet të ketë një shpërndarje më të njëtrajtshme gjatë vitit. Përqendrimi kronik i tyre në gjysmën e dytë të vitit shkakton luhatje të panevojshme në treguesit ekonomikë dhe tregjet financiare, duke ulur dhe eficiencën e shpenzimeve publike.

3. Mbi rritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike.

Banka e Shqipërisë sugjeron rishikimin periodik të kuadrit ligjor që rregullon skemën e pensioneve, atë të sigurimeve shëndetësore dhe skemat e tjera të sigurimeve sociale. Po ashtu, inkurajon intensifikimin e përpjekjeve për zhvillimin e shtyllës së dytë e të tretë të sistemit privat të pensioneve, atë të sigurimit të detyrueshëm dhe vullnetar.

Në interes të rritjes së efektivitetit dhe të reduktimit të rreziqeve potenciale që vijnë nga PPP, Banka e Shqipërisë sugjeron përfshirjen e tavaneve ligjore afatgjata mbi vlerën e përgjithshme të kontraktuar të PPP-ve. Ky rregullim do të ishte një element plotësues i

kontrollit të nivelit të rrezikut potencial që PPP-të mund të kenë mbi shëndetin e financave publike. Gjithashtu, BSH sugjeron përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të njësive që administrojnë vlerësimin, kontraktimin dhe monitorimin e këtyre projekteve, sidomos sa i takon detyrimeve ligjore dhe financiare që ato i ngarkojnë Buxhetit.

Mbi përgatitjen e analizave ekonomike dhe monetare

Bazuar në pikën 3 të nenit 24, Kreu IV i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Banka e Shqipërisë përgatit analiza periodike ekonomike e monetare, publikon rezultatet dhe i paraqet propozime dhe masa Qeverisë së Republikës të Shqipërisë. Nga auditimi rezulton se Banka e Shqipërisë ka përgatitur 4 raporte tremujore të politikës monetare (i cili mbështetet në informacionin e përditësuar deri në datën 21 Qershor 2023), publikuar në faqen zyrtare të BSH, si dhe 1 raport të ndërmjetëm të politikës monetare.

- Raporti i tremujorit të parë përmban të dhëna që datojnë deri në 23 janar 2023, u shqyrtua dhe u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 1 shkurt 2023.
- Raporti i tremujorit të dytë përmban të dhëna që datojnë deri në 20 prill 2023, u shqyrtua dhe u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 3 maj 2023.
- Raporti i tremujorit të tretë përmban të dhëna që datojnë deri në 21 korrik 2023, u shqyrtua dhe u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 2 gusht 2023.
- Raporti i tremujorit të katër përmban të dhëna që datojnë deri në 20 tetor 2023, u shqyrtua dhe u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 1 nëntor 2023.

Raportet tremujore të politikës monetare konsistojnë në përshkrimin dhe analizimin e inflacionit dhe qëndrimit të politikës monetare, mjedisit të jashtëm ekonomik, tregjeve financiare dhe kushteve të kreditimit, rritjes ekonomike, dhe inflacionit, çmimit e kostove në ekonomi. Këto raporte përgatiten nga Departamenti i Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë dhe miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Mbi marrëdhënien me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të menaxhimit të likuiditetit

Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave kanë nënshkruar marrëveshjen nr. 716/1, datë 20.01.2015 mbi instrumentet e ofruar nga Banka e Shqipërisë për menaxhimin e likuiditeteve të Ministrisë së Financave, në të cilën përcaktohen mënyrat dhe instrumentet për menaxhimin e tepricave të likuiditetit përgjatë periudhave. Gjithashtu, BSH është pjesëmarrëse në Komitetin e Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit, i cili ndërmerr analiza ose veprime lidhur me mënyrën më të mirë të menaxhimit të likuiditetit. Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2023 janë kryer 7 vendosje në depozitë e tepricës së likuiditeteve, në vlerë totale 58 miliard lekë si në tabelën nr. 1, ku përcaktohet vlera, data e valutës dhe data e maturimit, të cilat janë diskutuar në mbledhjet e KMBL për t’u depozituar si rezultat i tepricave në likuiditet në monedhën vendase.

Tabela nr. 1: Vendosje në depozitë për qëllime investimi përgjatë vitit 2023

Data e fillimit	Data e maturimit	Vlera	Afati në ditë i investimit
21.02.2023	02.03.2023	8,000,000,000.00	9
18.05.2023	07.06.2023	10,000,000,000.00	20
13.06.2023	12.07.2023	10,000,000,000.00	29
13.07.2023	11.08.2023	10,000,000,000.00	29
14.08.2023	13.09.2023	10,000,000,000.00	30
16.10.2023	13.11.2023	10,000,000,000.00	28
16.11.2023	06.12.2023	10,000,000,000.00	20
Total		58,000,000,000.00	

Burimi: Të dhënat nga Banka e Shqipërisë. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe marrëveshjen për ofrimin e shërbimeve financiare mes Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë, MFE vendos për investimin e mjeteve monetare në formën e depozitës dhe për këtë dërgon shkresë drejt BSH me qëllim investimin e këtyre tepricave. Më pas, BSH kryen investimin e tepricave në depozita.

Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2023 veçanërisht për mjetet monetare në valutë (si monedha EUR e cila paraqitet me teprica të konsiderueshme likuiditeti sidomos pas marrjes së Eurobondit në muajin Qershor 2023) nuk është shfrytëzuar mundësia e investimit të tyre në depozitë nga ana e MFE për të përfituar të ardhura nga interesi, në të njëjtën kohë kur mbajtja e këtyre valutave shoqërohet me kosto mbajtje. Gjithashtu, konstatohet se përgjatë periudhës objekt auditimi kanë ekzistuar hapësirat dhe mundësitë për të investuar më shumë si në vlerë ashtu edhe në kohëzgjatje, me qëllim përfitimin maksimal nga kjo mënyrë menaxhimi e likuiditetit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2093/3, datë 27.11.2024 “Mbi qëndrimin e Bankës së Shqipërisë për Projektraportin e auditimit”, protokolluar në KLSH me nr. 655/9, datë 27.11.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Për gjetjen dhe rekomandimin e pikës 2, Banka e Shqipërisë, si në të gjitha përgjigjet e saj ndër vite, vijon të jetë e opinionit që Banka e Shqipërisë i ka përmbushur me përpikmëri detyrimet e saj. Në zbatim të nenit 64, pika “b” e ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 6, pika 3 e marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë”, në kushtet kur në mbyllje të vitit 2023 dhe auditimit të pasqyrave financiare “Rezerva e rivlerësimit të valutave” rezultoi me gjendje negative në vlerën 56,737,912,520.53 lekë, me anë të shkresës nr. 1679 prot., datë 15.4.2024 dërguar nga Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave është njoftuar për tepricën e llogarisë “Rezerva e rivlerësimit të valutave” si dhe i është kërkuar konfirmimi për angazhimin e përmbushjes së detyrimeve të mundshme për emetimin e letrave me vlerë nga Ministria e Financave për mbulimin e vlerës negative të llogarisë “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave” në vlerën e mësipërme. Me anë të shkresës nr. 5061/1 prot., datë 17.05.2024, Ministria e Financave konfirmoi marrjen e informacionit si dhe përmbushjen e detyrimeve sipas përcaktimeve në marrëveshjen e rishikuar midis palëve .*

Në lidhje me rekomandimin 3.1, Duke filluar nga viti financiar 2015, zbaton pa përjashtime Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), duke përmbushur kërkesat e Ligjit për Bankën e Shqipërisë si dhe ligjit “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Në këtë kuadër, Banka ka miratuar politikat kontabël në përputhje me SNRF (vendim nr. 37, datë 23.03.2016 të Këshillit Mbikëqyrës) si dhe me mbështetjen e FMN, ka përgatitur dhe miratuar më tej, Manuallet e Parimeve Kontabël (urdhër nr. 6030, datë 31.12.2020 të Zëvendës Guvernatorit të Parë). Manuallet e Parimeve Kontabël përbejnë kuadrin rregullator kontabël, të cilat udhëheqin zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në Bankën e Shqipërisë. Manuallet paraqesin parime procedurale të nevojshme të zbatimit të politikave kontabël të cilat janë në përputhje me SNRF, brenda kontekstit të operacioneve/transaksioneve të Bankës. Pjesë e këtyre manualeve, është edhe “Manuali i Parimeve Kontabël: Kapitali dhe Rezervat”, i cili më konkretisht, në seksionin 6.2.4 “Rezerva”, pika 6.2.4.3 paraqet natyrën e zërit “Rezerva si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve”, krijuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, Nr. 19, datë 15.03.2018 “Për rialokimin dhe alokimin e disa prej rezervave të Bankës së Shqipërisë;” Në këtë seksion përshkruhen rregullat e njohjes fillestare, matjes së tyre në vijim si dhe përdorimin e tyre të mundshëm në të ardhmen bazuar në Vendimin Nr. 19 dhe SNRF.

Qëndrimi i audituesve: Për sa observohet, grupi i auditimit sqaron se në asnjë pjesë të konstatimit të bërë nga ana jonë, nuk është bërë me përgjegjësi BSH, por në kuadër të një

bashkëpunimi më efektiv është kërkuar ndërmarrje e veprimeve konkrete, me qëllim të shmangies së ndonjë risku potencial.

Përsa i përket observimit, në lidhje me manualin/udhëzimin, mbi procedurat e menaxhimit dhe përdorimit të rezervës si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve, vijojmë të mbetemi në të njëjtin qëndrim, pasi duhen detaje të tjera të mirë përcaktuara, përtej njohjes së tyre fillestare dhe të mëpasshme.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

2.4 Mbi zbatimin e marrëveshjes me ministrinë Financave për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë si agjent fiskal për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, lidhur me tregtimin e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria dhe pagesën e vlerës, të interesit dhe shpenzimeve të tjera për letra me vlerë.

Në zbatim të pikës 2.4 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Marrëveshja midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, datë 20.01.2015 “Për organizimin e ankandëve të titujve të shtetit shqiptar, shlyerjen e veprimeve dhe mbajtjen e regjistrit të këtyre titujve”, e ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, të bonove të thesarit në formë regjistrimi”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 31, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, të obligacioneve në formë regjistrimi”, i ndryshuar;
- Kalendarët e emetimit të titujve të qeverisë për huamarrjen në tregun e brendshëm;
- Seritë kohore të ankandëve; dosjet mbi zhvillimin e ankandëve.

Titujt e borxhit të Qeverisë Shqiptare përfaqësohen nga titujt afatshkurtër që përbëhen nga bonot e thesarit dhe titujt afatgjatë që përbëhen nga obligacionet. Për vitin 2023, titujt e emetuar nga Banka e Shqipërisë për llogari të Qeverisë Shqiptare sipas llojit dhe afateve të maturimit janë:

- Bono thesari: 3, 6 dhe 12 mujore;
- Obligacione: 2, 3, 5, 7, 10 dhe 15 vjeçar.

Gjatë vitit 2023, në total janë programuar 92 ankande, në shumën totale të borxhit të shpallur 380,500 milion lekë dhe shumë të shpallur me ndryshime strukturore 389,528 milion lekë, nga të cilat 41 ankande për bono thesari me shumë të shpallur 235,500 milion lekë dhe 51 ankande për obligacione me shumë të shpallur 148,000 milion lekë. Konstatohet se 3 ankande të shpallura për obligacione, janë anuluar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Nga 89 ankandet e zhvilluar është pranuar për emetim shuma 380,827 milion lekë, nga të cilat për 38 ankandet e zhvilluara për bono thesari është pranuar për emetim 233,828 milion lekë dhe për 51 ankandet e zhvilluara për obligacione është pranuar për emetim shuma 146,999 milion lekë. Në peshë, 61.4% e borxhit është mbledhur nëpërmjet bonove të thesarit dhe 38.6% është mbledhur nëpërmjet obligacioneve.

Tabela nr. 1: Ankandet e zhvilluara në vitin 2023 lekë

Lloji i instrumentit	Nr. Ankandesh	Shuma e Shpallur	Shuma e shpallur me ndryshime	Shuma e kërkuar	Shuma e pranuar	Pesha
Bono thesari	41*	232,500,000,000*	232,500,000,000	329,520,020,000*	233,827,860,000	61.4%
Obligacione	51	148,000,000,000	157,028,000,000	219,932,700,000	146,999,100,000	38.6%
Totali	92*	380,500,000,000*	389,528,000,000	549,452,720,000*	380,826,960,000	100%

Burimi: Banka e Shqipërisë

* Shënim: Te numri i ankandëve, shuma e shpallur dhe shuma e kërkuar janë përfshirë edhe të dhënat për 3 ankandet e anuluar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Të dhënat për ankandet e zhvilluara për financimin e nevojave për huamarrje me instrumente të brendshëm, të analizuara sipas llojit të instrumentit paraqiten si më poshtë:

- Përgjatë vitit 2023, janë zhvilluar kryesisht ankande për bonot e thesarit me afat maturim 12 mujor, në 26 raste duke pranuar për emetim shumë prej 220,576 milion lekë, e cila përbën 94.3% të totalit të bonove të emetuara ose 55.9% të totalit të instrumenteve të brendshëm të borxhit. Në lidhje me bonot me afat maturimi 3 muaj janë shpallur 8 ankande, me shumë të shpallur 8,500 milion lekë dhe shumë të kërkuar 12,066 milion lekë, nga të cilët 2 ankande me shumë të shpallur 2,000 milion lekë janë anuluar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë ndërsa 6 ankande janë zhvilluar, duke pranuar për emetimin shumë 6,500 milion lekë. Gjithashtu janë shpallur 7 ankande për bono thesari me afat maturimi 6 mujor, me shumë të shpallur 8,000 milion lekë dhe shumë të kërkuar 11,051 milion lekë, nga të cilët 1 ankand me shumë të shpallur 1,000 milion lekë është anuluar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, ndërsa 6 ankande janë zhvilluar, duke pranuar për emetim shumë 6,752 milion lekë.

Tabela nr. 2: Ankandet për bono thesarit, 2023 në lekë

Bono, afat maturim	Nr. i ankandeve	Shuma e Shpallur	Shuma e kërkuar	Shuma e pranuar
3/m	8*	8,500,000,000*	12,066,080,000*	6,499,980,000
6/m	7*	8,000,000,000*	11,051,190,000*	6,752,110,000
12/m	26	216,000,000,000	306,402,750,000	220,575,770,000
Totali	41*	232,500,000,000*	329,520,020,000*	233,827,860,000

Burimi: Banka e Shqipërisë

* Shënim: Te numri i ankandeve, shuma e shpallur dhe shuma e kërkuar janë përfshirë edhe të dhënat për 3 ankandet e anuluar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

- Për sa i përket ankandeve të obligacioneve, gjatë vitit 2023 janë zhvilluar 12 ankande për obligacione me maturim 2 vjeçar duke pranuar për emetim shumë 46,392.7 milion lekë, 11 ankande për obligacione me maturim 3 vjeçar me shumë të pranuar 27,303.1 milion lekë, 12 ankande për obligacione me maturim 5 vjeçar me shumë të pranuar 36,981.6 milion lekë, 8 ankande për obligacione me maturim 7 vjeçar me shumë të pranuar 18,650.8 milion lekë, 4 ankande për obligacione me afat maturimi 10 vjeçar me shumë të pranuar 12,126.7 milion lekë dhe 4 ankande për obligacione me afat maturimi 15 vjeçar me shumë të pranuar për emetim 5,544.2 milion lekë.

Tabela nr. 3: Ankandet e zhvilluara për obligacionet, 2023 në lekë

Obligacion me afat maturim	Nr. Ankandesh	Shuma e shpallur	Shuma e shpallur me ndryshime strukturore	Shuma e kërkuar	Shuma e pranuar
2 vjeçar (fix)	12	47,000,000,000	49,658,900,000	70,900,400,000	46,392,700,000
3 vjeçar (fix)	11	27,000,000,000	28,551,400,000	36,169,300,000	27,303,100,000
5 vjeçar (fix)	12	37,500,000,000	36,674,900,000	50,303,800,000	36,981,600,000
7 vjeçar (fix)	8	18,000,000,000	19,124,900,000	31,133,300,000	18,650,800,000
10 vjeçar (fix)	4	11,500,000,000	12,717,900,000	22,036,000,000	12,126,700,000
15 vjeçar (fix)	4	7,000,000,000	7,300,000,000	9,389,900,000	5,544,200,000
Totali	51	148,000,000,000	157,028,000,000	219,932,700,000	146,999,100,000

Burimi: Banka e Shqipërisë

Programimi nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë i ankandeve që do të zhvillohen nga Banka e Shqipërisë për emetimin titujve të Qeverisë Shqiptare

Ministria e Financës dhe Ekonomisë për çdo tremujor të vitit 2023, ka dorëzuar në Bankën e Shqipërisë kalendarët e ankandeve, duke vendosur në to llojin e titullit qeveritar, shumat e emetimit, pjesën e shumës për emetim të planifikuar për Bankën e Shqipërisë, datat e zhvillimit të ankandeve, datën e emetimit si dhe datën e maturimit të titujve, në përputhje me nenin 3 të Udhëzimit nr. 30, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të bonove të thesarit në formë regjistrimi”, i ndryshuar dhe nenin 3, të Udhëzimit nr. 31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të obligacioneve në formë regjistrimi”, i ndryshuar.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se nuk ka një datë të unifikuar për dërgimin nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në Bankën e Shqipërisë të kalendarit të ankandeve çdo

tremujor, më konkretisht: Në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për organizimin e ankandeve të titujve të shtetit shqiptar, shlyerja e veprimeve dhe mbajtja e regjistrimit të këtyre titujve”, datë 20.01.2015, i ndryshuar, në nenin 9, pika 1 përcaktohet se “...*Kalendari dërgohet në mënyrë elektronike dhe shkresore jo më vonë se dy javë përpara fillimit të tremujorit dhe sa here që kalendari ndryshon, sipas nevojave të Ministrisë*”. Ndërsa në nenin 3 të Udhëzimit nr. 30, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të bonove të thesarit në formë regjistrimi”, i ndryshuar dhe në nenin 3, të Udhëzimit nr. 31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të obligacioneve në formë regjistrimi”, i ndryshuar përcaktohet se “*Ministria e Financave si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në emetimin e titujve shtetërorë, për çdo tremujor, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të tremujorit përkatës, publikon kalendarin e emetimit...*”.

Për vitin 2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar kalendarët e organizimit të ankandeve, si në vijim:

- Me shkresën nr. 22994, datë 15.12.2022, ka dërguar kalendarin e emetimit të titujve të qeverisë për huamarrjen në tregun e brendshëm në tremujorin e parë, brenda afatit kohor.
- Me shkresën nr. 5070, datë 15.03.2023, ka dërguar kalendarin e emetimit të titujve të qeverisë për huamarrjen në tregun e brendshëm në tremujorin e dytë, brenda afatit kohor.
- Me shkresën nr. 11088, datë 16.06.2023, ka dërguar kalendarin e emetimit të titujve të qeverisë për huamarrjen në tregun e brendshëm në tremujorin e tretë, jashtë afatit kohor, jo në përputhje me pikën 1, nenin 9, të Marrëveshjes midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për organizimin e ankandeve të titujve të shtetit shqiptar, shlyerjen e veprimeve dhe mbajtjen e regjistrimit të këtyre titujve”, datë 20.01.2015, e ndryshuar; nenin 3 të Udhëzimit nr. 30, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të bonove të thesarit në formë regjistrimi”, i ndryshuar dhe në nenin 3, të Udhëzimit nr. 31, datë 26.12.2013, të ndryshuar “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të obligacioneve në formë regjistrimi”, i ndryshuar.
- Me shkresën nr. 16338, datë 13.09.2023, ka dërguar kalendarin e emetimit të titujve të qeverisë për huamarrjen në tregun e brendshëm në tremujorin e katërt, brenda afatit kohor.

Për vitin 2023, kalendarët e organizimit të ankandeve nuk kanë pësuar ndryshime.

Mbi planifikimin e zhvillimit të ankandeve

1. Për tremujorin e parë, (Janar-Mars), Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka planifikuar për t’u shpallur gjithsej 121,000 milion lekë, nga të cilat për Bankën e Shqipërisë ka planifikuar 21,602.3 milion lekë ose 17.9% të shumës totale. Shpërndarja e shumave të shpallur për ankande në mënyrë të detajuar paraqitet:

1.a. Bono thesari gjithsej 84,000 milion lekë, nga këto për Banka e Shqipërisë janë planifikuar 21,602.3 milion lekë, ose 25.7% e tyre, të ndara:

- Bono thesari 3-mujore në shumën 3,500 milion lekë, nga të cilat 747.42 milion lekë për Bankën e Shqipërisë;
- Bono thesari 6-mujore në shumën 4,000 milion lekë; nga të cilat 900 milion lekë për Bankën e Shqipërisë;
- Bono thesari 12-mujore në shumën 76,500 milion lekë, nga të cilat 19,954.88 milion lekë për Bankën e Shqipërisë.

1.b. Obligacione gjithsej janë shpallur për t’u emetuar në vlerë 37,000 milion lekë:

- Obligacione 2-vjeçare në shumën 12,000 milion lekë;
- Obligacione 3-vjeçare në shumën 9,000 milion lekë;
- Obligacione 5-vjeçare në shumën 8,500 milion lekë;
- Obligacione 7- vjeçare në shumën 3,000 milion lekë;
- Obligacione 10-vjeçare në shumën 2,500 milion lekë;
- Obligacione 15-vjeçare në shumën 2,000 milion lekë.

2. Për tremujorin e dytë, (Prill-Qershor), Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka planifikuar për të shpallur gjithsej 96,500 milion lekë, nga të cilat për Bankën e Shqipërisë ka planifikuar 23,397.42 milion lekë ose 24.2% e tyre. Shpërndarja e shumave të shpallur për ankande në mënyrë të detajuar paraqitet:

2.a. Bono thesari gjithsej 58,000 milion lekë, nga këto për Banka e Shqipërisë janë planifikuar 23,397.42 milion lekë, ose 40.3% e tyre, të ndara:

- Bono thesari 3-mujore në shumën 2,000 milion lekë, nga të cilat 547.42 milion lekë për Bankën e Shqipërisë;

- Bono thesari 6-mujore në shumën 2,000 milion lekë; nga të cilat 450 milion lekë për Bankën e Shqipërisë;

- Bono thesari 12-mujore në shumën 54,000 milion lekë, nga të cilat 22,400 milion lekë për Bankën e Shqipërisë.

2.b. Obligacione gjithsej janë shpallur për t'u emetuar në vlerë 38,500 milion lekë:

- Obligacione 2-vjeçare në shumën 13,000 milion lekë;

- Obligacione 3-vjeçare në shumën 6,000 milion lekë;

- Obligacione 5-vjeçare në shumën 9,000 milion lekë;

- Obligacione 7-vjeçare në shumën 5,500 milion lekë;

- Obligacione 10-vjeçare në shumën 3,000 milion lekë;

- Obligacione 15-vjeçare në shumën 2,000 milion lekë.

3. Për tremujorin e tretë, (Korrik-Shtator), Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka planifikuar të shpallë gjithsej 83,000 milion lekë, nga të cilat për Bankën e Shqipërisë ka planifikuar 14,447.42 milion lekë ose 17.4% e tyre. Shpërndarja e shumave të shpallur për ankande në mënyrë të detajuar paraqitet:

3.a. Bono thesari gjithsej 44,000 milion lekë, nga këto për Banka e Shqipërisë janë planifikuar 14,447.42 milion lekë, ose 32.8% e tyre, të ndara:

- Bono thesari 3-mujore në shumën 2,000 milion lekë, nga të cilat 247.42 milion lekë për Bankën e Shqipërisë;

- Bono thesari 6-mujore në shumën 1,000 milion lekë; nga të cilat 400 milion lekë për Bankën e Shqipërisë;

- Bono thesari 12-mujore në shumën 41,000 milion lekë, nga të cilat 13,800 milion lekë për Bankën e Shqipërisë.

3.b. Obligacione gjithsej janë shpallur për t'u emetuar në vlerë 39,000 milion lekë:

- Obligacione 2-vjeçare në shumën 12,000 milion lekë;

- Obligacione 3-vjeçare në shumën 6,000 milion lekë;

- Obligacione 5-vjeçare në shumën 11,000 milion lekë;

- Obligacione 7-vjeçare në shumën 5,500 milion lekë;

- Obligacione 10-vjeçare në shumën 3,000 milion lekë;

- Obligacione 15-vjeçare në shumën 1,500 milion lekë.

4. Për tremujorin e katërt, (Tetor-Dhjetor), Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka planifikuar për të shpallur gjithsej 80,000 milion lekë, nga të cilat për Bankën e Shqipërisë ka planifikuar 12,018 milion lekë ose 15% e tyre. Shpërndarja e shumave të shpallur për ankande në mënyrë të detajuar paraqitet:

4.a. Bono thesari gjithsej 46,500 milion lekë, nga këto për Banka e Shqipërisë janë planifikuar 12,018 milion lekë, ose 25.8% e tyre, të ndara:

- Bono thesari 3-mujore në shumën 1,000 milion lekë;

- Bono thesari 6-mujore në shumën 1,000 milion lekë; nga të cilat 450 milion lekë për Bankën e Shqipërisë;

- Bono thesari 12-mujore në shumën 44,500 milion lekë, nga të cilat 12,018 milion lekë për Bankën e Shqipërisë.

4.b. Obligacione gjithsej janë shpallur për t'u emetuar në vlerë 33,500 milion lekë:

- Obligacione 2-vjeçare në shumën 10,000 milion lekë;
- Obligacione 3-vjeçare në shumën 6,000 milion lekë;
- Obligacione 5-vjeçare në shumën 9,000 milion lekë;
- Obligacione 7- vjeçare në shumën 4,000 milion lekë;
- Obligacione 10-vjeçare në shumën 3,000 milion lekë;
- Obligacione 15-vjeçare në shumën 1,500 milion lekë.

Kërkesat konkurruese dhe jo konkurruese

Për vitin 2023, në ankandet e zhvilluara për bono thesari, kërkesat konkurruese kanë zënë pjesën më të madhe në shumën e kërkuara, 65.12% të shumës totale të kërkuar ose në vlerën 214,606 milion lekë. Kërkesat jo konkurruese, përbëjnë 34.88% të shumës totale të kërkuar, në vlerën 114,914 milion lekë, nga të cilat 70,275 milion lekë i përkasin kërkesave jo konkurruese të Bankës së Shqipërisë, ose 61.15% të shumës së kërkesave jo konkurrues.

Pjesëmarrja e kërkesave konkurruese dhe jo konkurruesve në ankandet e bonove të thesarit, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 4: Kërkesat konkurruese dhe jo konkurrues në ankandet e bonove të thesarit, 2023

në milion lekë

B. Th.	Shuma e shpallur	Shuma e kërkuar	Shuma jo konkurruese (Individët)	Shuma jo konkurruese (B.Sh.)	Shuma konkurruese	Shuma e Pranuar
3-mujore	8,500	12,066	420	1,542	10,104	6,500
6-mujore	8,000	11,051	718	2,200	8,133	6,752
12-mujore	216,000	306,403	43,501	66,533	196,369	220,576
Totali	232,500	329,520	44,639	70,275	214,606	233,828

Burimi: Banka e Shqipërisë

Të ndara sipas afate të maturimi, pjesëmarrja e kërkesave konkurruese në shumën e kërkuara, rezultojnë:

Për bono thesari me afat maturimi 3-mujor, kërkesat konkurruese rezultojnë në shumën 10,104 milion lekë, nga të cilat janë pranuar 4,538 milion lekë, duke përbërë 83.7% të shumës së kërkuar dhe 69.8% të shumës së pranuar për këtë bono thesari.

Për bono thesari me afat maturimi 6-mujor, kërkesat konkurruese rezultojnë në shumën 8,133 milion lekë, nga të cilat janë pranuar 3,834 milion lekë, duke përbërë 73.6% të shumës së kërkuar dhe 56.7% të shumës së pranuar për këtë bono thesari.

Për bono thesari me afat maturimi 12- mujor, kërkesat konkurruese rezultojnë në shumën 196,369 milion lekë, nga të cilat janë pranuar 110,542 milion lekë, duke përbërë 50.11% të shumës së kërkuar dhe 52.85% të shumës së pranuar për këtë bono thesari.

Kërkesa e individëve

Për vitin 2023, kërkesat jo konkurruese të individëve rezultojnë në vlerën 44,639 milion lekë, të cilat përbëjnë 38.85% të shumës së kërkesave jo konkurrues dhe 13.5% të shumës totale të kërkuar. Individët mund të marrin pjesë në ankandet e bonove të thesarit nëpërmjet bankave tregtare të licencuara nga autoritetet përkatëse për këtë shërbim ose nëpërmjet sporteve të Bankës së Shqipërisë.

Nëse individët marrin pjesë në ankandet nëpërmjet sporteve të Bankës së Shqipërisë duhet si fillim të kenë të hapur një llogari në të cilin do të derdhen fondet pranë një banke tregtare. Më pas paraqiten pranë sporteve të Bankës së Shqipërisë për hapjen e llogarisë së bonos së thesarit dhe nënshkrimin e kontratës tip me Bankën e Shqipërisë. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, pjesëmarrja e individëve në bonot e thesarit nëpërmjet sporteve, paraqitet si në tabelën e vijim:

Tabela nr. 5: Numri i individëve që kanë marr pjesë në ankande nëpërmjet sporteleve.

Viti	Nr. i individëve që kanë marr pjesë në ankande nëpërmjet sporteleve.
2020	10,657
2021	8,043
2022	2,058
2023	5,104


Burimi: Banka e Shqipërisë

Në vitin 2020, Banka e Shqipërisë njoftoi mbylljen e sporteleve të saj për investimin e individëve në bonot e thesarit, me argumentet: a) konkurrencë e mirë në tregun financiar për këtë produkt, b) ecuri pozitive në drejtim të edukimit financiar të popullatës si dhe c) rritje e numrit të institucioneve që ofrojnë shërbime për këtë lloj kategorie investitori.

Në fund të vitit 2022, dy muaj para mbylljes përfundimtare të tyre, Banka e Shqipërisë njoftoi shtyrjen e mbylljes së këtij shërbimi, me argumentin e transferimit më të shpejtë të politikës monetare në kushtet e reja të një politikë shtrënguese monetare. Bazuar në analizën e të dhënave të pjesëmarrjes së individëve në ankandet e titujve të qeverisë, konstatohet se portofoli i individëve në fund të vitit 2023 është në të njëjtin nivel me fundin e vitit 2021, si dhe numri i individëve që marrin pjesë në ankande nëpërmjet sporteleve ka pësuar ulje të ndjeshme në krahasim me vitin 2020. Në këto kushte, nisur edhe nga faktet që ky shërbim ofrohet edhe nga bankat e nivelit të dytë si dhe fakti që edhe kur ky shërbim ofrohet në sportelet e Bankës së Shqipërisë sërish individët duhet të paraqiten për hapje llogarish në bankat e nivelit të dytë, gjykojmë se shtyrja e mbajtjes hapur të këtyre sporteleve nuk sjell vlerë të shtuar për individët dhe investimet e tyre, gjithashtu ul eficiencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve të BSH.

Ecuria e normave të interesit

Gjatë vitit 2023, ecuria e normat të interesit, (Yield-et të pranuar) për bonot e thesarit paraqitet në grafikët e mëposhtëm.



Normat e bonove të thesarit 3-mujore kanë luhatur pak gjatë vitit, duke qëndruar përgjithësisht në nivele mesatare (rreth 3%), me një stabilizim të lehtë në pjesën e dytë të vitit. Normat e yield-it për bonot e thesarit me afat maturimi 6 mujor kanë pësuar rënie të konsiderueshme, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit, ku në muajin tetor kanë arritur vlerën 1.5%, nga 4.6% që ka qenë në janar. Për bonot e thesarit me afat maturimi 12 muaj, tendenca e yield-it ka qenë më e qëndrueshme, me ulje të vazhdueshme dhe një stabilizim të përkohshëm nga muaji korrik deri në fund të vitit. Yield-i mbeti në një nivel të ulët krahasuar me fillimin e vitit, ku norma ishte 5.45%.

Për vitin 2023, në ankandet e zhvilluara për obligacione, kërkesat konkurruese zënë 94.5% të shumës totale të kërkuar ose në vlerën 207,931 milion lekë, ndërsa kërkesat jo konkurruese, përbëjnë 5.5% të shumës totale të kërkuar, në vlerën 12,001 milion lekë. Pjesëmarrja e kërkesave konkurruese dhe jo konkurruese në ankandet e obligacioneve, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:


Tabela nr. 6: Kërkesat konkurruese dhe jo konkurruese në ankandet e obligacioneve, 2023 në milion lekë





Obligacione	Shuma e shpallur	Shuma konkurruese	Shuma jo konkurruese	Shuma e kërkuar	Shuma e pranuar
2-vjeçare	47,000	68,936	1,964	70,900	46,393
3-vjeçare	27,000	34,079	2,090	36,169	27,303
5-vjeçare	37,500	47,474	2,830	50,304	36,982
7-vjeçare	18,000	28,727	2,406	31,133	18,651
10-vjeçare	11,500	20,546	1,490	22,036	12,127
15-vjeçare	7,000	8,169	1,221	9,390	5,544
Totali	148,000	207,931	12,001	219,932	147,000

Burimi: Banka e Shqipërisë

Edhe gjatë vitit 2023, pjesa më e madhe e financimit me anë të obligacioneve ka qenë e orientuar drejt emetimit të obligacioneve të thesarit me maturim 2-vjeçar, kryesisht e kushtëzuar nga një numër i madh maturimesh të instrumenteve ekzistues me maturim 2-vjeçar.

Ecuria e yield mesatar të ponderuar dhe yield të pranuar për tituj afatgjatë të ka pasur prirje sipas grafikëve në vijim:





-Në lidhje me obligacionet me afat maturimi 2-vjeçar, yield minimal i kërkuar varion në masën 3% - 4.7%, yield maksimal i kërkuar varion në masën 4.2%-6%, yieldi uniform i kërkuar varion në masën 3.8%-5.8%.

-Për obligacionet me afat maturimi 3-vjeçar, yield minimal i kërkuar varion në masën 4.48%-5.45%, ndërkohë që yield maksimal i kërkuar varion në masën 4.55%-6%.

-Për obligacionet me afat maturimi 5-vjeçar, yield minimal i kërkuar varion në masën 4%-6%, ndërkohë që yield maksimal i kërkuar varion në masën 4.82%-8.5%.

- Për obligacionet me afat maturimi 7-vjeçar, yield minimal i kërkuar varion në masën 3%-4.5%, ndërkohë që yield maksimal i kërkuar varion në masën 5.5%-8%.
- Për obligacionet me afat maturimi 10-vjeçar, yield minimal i kërkuar varion në masën 4.5%-5.9%, ndërkohë që yield maksimal i kërkuar varion në masën 6.5%-9%.
- Për obligacionet me afat maturimi 15-vjeçar, yield minimal i kërkuar varion në masën 5.2%-5.8%, ndërkohë që yield maksimal i kërkuar varion në masën 7.5%-8.5%.

Pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë në ankandet e bonove të thesarit.

Edhe pse Banka e Shqipërisë kërkesat e saj i ka gjithnjë jo konkurrese, niveli i pjesëmarrjes së saj, si dhe ndryshimi i kësaj pjesëmarrjeje jep ndikim në nivelin e interesit të ankandeve. Për vitin 2023, në total janë zhvilluar 41 ankande për bono thesarit, në të cilët Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë në 36 ankande. Banka e Shqipërisë në total ka blerë bono thesari në vlerën 70,817.72 milion lekë, nga 233,828 milion lekë të pranuar ose sa 30.3% e shumës totale të pranuar. Në tabelën e mëposhtme paraqitet pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë në ankandet e bonove të thesarit për çdo tremujor të vitit 2023.

Tabela nr. 7: Pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë në ankandet për bonove të thesarit, viti 2023 milion lekë

Tremujori	Lloji i B.TH.	Shuma e shpallur	Pjesëmarrja e BoA sipas kalendarëve	Shuma Jo-konkurrese e BoA	Shuma e Pranuar	Pjesëmarrja BoA
I	3-mujore	3,500	747.42	747.42	747.42	21.35%
	6-mujore	4,000	900	900	900	22.5%
	12-mujore	76,500	19,954.88	19,954.88	19,954.88	26%
	Gjithsej	84,000	21,602.3	21,602.3	21,602.3	25.7%
II	3- mujore	2,000	547.42	547.42	547.42	27%
	6-mujore	2,000	450	450	450	22.5%
	12-mujore	54,000	22,400	22,400	22,400	41.48%
	Gjithsej	58,000	23,397.42	23,397.42	23,397.42	40.34%
III	3-mujore	2,000	247.42	247.42	0	0%
	6-mujore	1,000	400	400	0	0%
	12-mujore	41,000	13,800	13,800	13,800	33.66%
	Gjithsej	44,000	14,447.42	14,447.42	13,800	32.83%
IV	3-mujore	1,000	0	0	0	0
	6-mujore	1,000	450	450	450	45%
	12-mujore	44,500	11,568	11,568	11,568	25.99%
	Gjithsej	46,500	12,018	12,018	12,018	25.85%
Gjithsej 2023		232,500	71,465.14	71,465.14	70,817.72	30.74%

Burimi: Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë gjatë tremujorit të dytë ka rritur pjesëmarrjen e saj në vlerë dhe në përqindje, duke shënuar edhe pjesëmarrjen më të lartë gjatë vitit 2023, më pas gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt ka ulur pjesëmarrje e saj në vlerë, duke shënuar edhe pjesëmarrjen më të ulët, në tremujorin e katërt.

Mbi pagesat e letrave me vlerë

Referuar nenit 15 të Udhëzimit 31, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, i ndryshuar, rezulton se, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, u paguan zotëruesve të obligacioneve vlerën e kuponin në masën dhe datën e përcaktuar në njoftimin për emetimin e tyre. Pra në datën e maturimit Ministria, nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, kryen pagesën e vlerës nominale të obligacionit. Ministria është përgjegjëse për sigurimin e likuiditetit të nevojshëm për shlyerjen e detyrimit që rrjedhin nga emetimi i obligacionit. Gjithashtu referuar nenit 15 të Udhëzimit 30, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të thesarit në formë regjistrimi”, rezulton se Ministria e Financave, nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, kryen pagesën e vlerës nominale të bonove të thesarit. Nga auditimi me zgjedhje i pagesave nuk u konstatuan pa saktësi apo vonesa në pagesa.

Zhvillimi i ankandëve të planifikuar

Nga ankandet e zhvilluar përgjatë vitit 2023, janë përzgjedhur për t'u audituar vlerat përfaqësuese sipas afatit të maturimit të instrumenteve përkatës. Nga auditimi nuk janë konstatuar parregullsi për sa i përket procedurave në lidhje me afatet, shpalljen e njoftimit për zhvillimin e ankandit, përzgjedhjen e fituesve si dhe shpalljen e rezultateve të ankandit. Shpalljet janë realizuar në kohë duke lajmëruar pjesëmarrësit në ankand, ofertat në rastet e kërkesave konkurruese kanë qenë të me zarf të paraqitura nga subjektet përkatës. Procesverbalet e komisionit të ankandit kanë qenë në përputhje me raportin e printuar nga sistemi në lidhje me pjesëmarrësit në ankand. Renditja sipas rezultateve është kryer duke marrë parasysh normën dhe çmimin përkatës më të favorshëm. Shpallja e rezultateve është kryer në përputhje me shumat e përzgjedhura nga Ministria e Financave sipas shkresës përkatëse, duke aplikuar edhe pro-rate në rastet përkatëse.

- *Ankandi nr. 211, obligacion 2-vjeçar me shumë të shpallur 4,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 10.01.2023, ISIN AL000A3CJ33.*

Me shkresën nr. 23994, datë 29.12.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin për zhvillimin e ankandit të obligacioneve 2-vjeçare, me shumë të shpallur 4,000 milion, me kupon indikativ 6% të pagueshëm çdo gjashtëmuor në datat 12 Korrik dhe 12 Janar. Pas realizimit të ankandit, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 5681/1, datë 10.01.2023 ka dërguar informacioni mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 61 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nga të cilat 2 kërkesa nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, janë paraqitur në zarf. Yield-i i paraqitur nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave ka qenë i ndryshëm për 2 kërkesat, konkretisht 1 kërkesë me shumë të kërkuar 600 milion lekë me yield 5.7% dhe 1 kërkesë me shumë të kërkuar 600 milion lekë dhe yield 5.8%. Në lidhje me këtë ankand janë paraqitur 33 kërkesa jo-konkurruese në shumën 858.8 milion lekë dhe 28 kërkesa konkurruese në shumën 5,066.3 milion lekë, duke rezultuar në shumë totale të ofruar 5,922.1 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar 33 kërkesa jo-konkurruese në shumën 798.3 milion lekë dhe 17 kërkesa konkurruese në shumën 3,201.7 milion lekë. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 4.7%, niveli i yield cutoff është 5.8% dhe niveli mesatar konkurrues është 5.58%. Me shkresën nr. 23994/1, datë 10.01.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 4,000 milion lekë dhe niveli i yield-i 5.8%. Në përfundim të ankandit janë pranuar të gjitha kërkesat jo-konkurruese (33), në shumën 798.3 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield uniform 5.8% si dhe janë pranuar 17 kërkesa konkurruese në shumën 3,201.7 milion lekë, të cilat janë pranuar ndërmjet nivelit të yield-it 4.7%-5.8% dhe janë alokuar me yield uniform 5.8%.

- *Ankandi nr. 212, obligacion 2-vjeçar fiks me shumë të shpallur 6,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 06.04.2023, me ISIN AL000A3LFSQ7.*

Me shkresën nr. 5726, datë 28.03.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcjellë njoftimin për zhvillimin e ankandit të obligacioneve 2-vjeçare me shumë të shpallur 6,000 milion lekë, me kupon indikativ 4.5% të pagueshëm çdo gjashtëmuor në datat 11 Tetor dhe 11 Prill. Në vijim, pas realizimit të ankandit me shkresën nr. 1401/1, datë 06.04.2023 është përcjellë nga Banka e Shqipërisë informacioni mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 58 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nga të cilat 3 kërkesa nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, janë paraqitur në zarf.

Nga auditimi i dokumenteve të dosjes së ankandit, ka rezultuar se Agjencia e Sigurimit të Depozitave, në kërkesën e parë ka kërkuar të marrë pjesë në ankand me shumën konkurruese

500 milion lekë dhe yield 4.1%, në kërkesën e dytë ka kërkuar të marrë pjesë me shumën konkurruese 500 milion lekë dhe nivel yield 4.2% ndërsa në kërkesën e tretë ka kërkuar të marrë pjesë me shumën konkurruese 750 milion lekë dhe nivel yieldi po 4.2% (për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme). Nga komisioni i ankandit janë pranuar të tre kërkesat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Referuar ligjit nr. 133/2013 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në Banka, në Republikën e Shqipërisë”, neni 71 pika 2 citon se: “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme administrohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore, të miratuara nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim”, ndërsa në nenin 3 citohet se: “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk ka personalitet juridik. Pra, Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nuk është subjekt më vetë, pasi nuk ka personalitet juridik dhe rrjedhimisht nuk është subjekt i ndryshëm nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Sa më sipër, pranimi i kërkesave të mësipërme me të njëjtin nivel yield-i të kërkuar nga i njëjti subjekt është jo në përputhje me pikën 3, neni 8, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 31, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të thesarit në formë regjistri”, i ndryshuar, ku citohet se: “Një subjekt ka të drejtë të paraqesë në ankand jo më shumë se tre kërkesa konkurruese me një ndryshim yield-i prej të paktën 0.01%”.

Për këtë ankand në total janë paraqitur në total 58 kërkesa, nga të cilat 23 kërkesa jo-konkurruese në shumën 594.3 milion lekë dhe 35 kërkesa konkurruese në shumën 8,663.6 milion lekë, duke rezultuar në një shumë të ofruar në total prej 9,257.9 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurruese në shumën 594.3 milion lekë si dhe janë kualifikuar 18 kërkesa konkurruese në shumën 5,405.7 milion lekë, për plotësimin e shumës së shpallur për emetim. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 3.1%, niveli i yield cutoff është 4.27% dhe niveli mesatar konkurrues është 4.212%. Me shkresën nr. 5726/1, datë 06.04.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcjellë shpalljen e rezultateve të ankandit, ku është pranuar për emetim shumën 6,700 milion lekë, duke devijuar me + 15% nga shuma e shpallur fillestare, ndërsa niveli i yield-it të pranuar është 4.35%. Pas ndryshimit të shumës së shpallur, në përfundim të ankandit janë pranuar të gjitha kërkesat jo-konkurruese (23), në shumën 594.3 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield uniform 4.35% si dhe janë pranuar 24 kërkesa konkurruese në shumën 6,305.7 milion lekë, të cilat janë pranuar ndërmjet nivelit të yield-it 3.1%-4.35% dhe janë alokuar me yield uniform 4.35%.

- *Ankandi nr. 213, obligacion 2-vjeçar me shumë të shpallur 6,000 milion lekë me datë zhvillimi ankandi 24.07.2023, ISIN AL000A3LK94.*

Me shkresën nr. 13020, datë 14.07.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin për zhvillimin e ankandit të obligacioneve 2-vjeçare, me shumë të shpallur 6,000 milion lekë, me kupon indikativ 3.5% të pagueshëm çdo gjashtëmuor në datat 26 Janar dhe 26 Korrik. Në vijim, pas realizimit të ankandit me shkresën nr. 3191/1, datë 24.07.2023 është dërguar nga Banka e Shqipërisë informacioni mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 28 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nga të cilat 1 kërkesë nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, është paraqitur në zarf. Në lidhje me këtë ankand janë paraqitur 10 kërkesa jo-konkurruese në shumën 258.6 milion lekë dhe 18 kërkesa konkurruese në shumën 4,219.1 milion lekë, duke rezultuar në shumë totale të ofruar 4,477.7 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurruese dhe konkurruese. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 3%, niveli i yield cutoff është 4.2% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.708%. Me shkresën nr. 13020/1, datë 24.07.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 4,274.2 milion lekë dhe nivel yield-it të pranuar 3.88%. Pas ndryshimit në shumën e pranuar, Banka e Shqipërisë ka ri dërguar rezultatet e ankandit ku janë pranuar të

10-të kërkesat jo-konkurrese në shumën 258.6 milion lekë si dhe 16 kërkesa konkurrese në shumën 4,015.6 milion lekë. Të gjitha kërkesat janë alokuar me yied uniforme prej 3.88%.

- *Ankandi nr. 47, obligacion 3-vjeçar me shumë të shpallur 7,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 22.02.2023, ISIN AL000A3LEHC3.*

Me shkresën nr. 3192, datë 15.02.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin për zhvillimin e ankandit të obligacioneve 3-vjeçare, me shumë të shpallur 7,000 milion lekë, nga të cilat 750 milion lekë për llogarit të vetë MFE-së, me kupon indikativ 5%, të pagueshëm çdo gjashtëmujor në datat 24 Gusht dhe 24 Shkurt, ku kërkesat për këtë ankand do të behën nëpërmjet Zhvilluesve të Tregut. Pas realizimit të ankandit, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 732/1, datë 22.02.2023 ka dërguar informacion mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 56 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Në këtë ankand janë paraqitur 3 kërkesa jo-konkurrese në shumën 220 milion lekë dhe 53 kërkesa konkurrese në shumën 5,384.7 milion lekë, duke rezultuar në shumën totale të ofruar 5,604.7 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese dhe jo konkurrese. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 4.2%, niveli i yield cutoff është 6% dhe niveli mesatar konkurrues është 4.985%. Me shkresën nr. 3192/1, datë 22.02.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 6,348.9 milion lekë, me nivel yield-it të pranuar 5.45%, nga të cilat 750 milion për llogari vetjake të MFE. Pas ndryshimit në shumën e pranuar, Banka e Shqipërisë ka ri dërguar rezultatet e ankandit ku janë pranuar të 3 kërkesat jo-konkurrese në shumën 220 milion lekë, me nivel yield-i të alokuar 4.984% si dhe 51 kërkesa konkurrese në shumën 5,378.9 milion lekë, me nivel yieldi të alokuar ndërmjet 4.2% dhe 5.45%.

- *Ankandi nr. 47RFR10, obligacion 3-vjeçar me shumë të shpallur 2,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 13.12.2023, ISIN AL000A3LEHC3.*

Me shkresën nr. 22543, datë 13.12.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin për ri hapjen e ankandit të obligacioneve 3-vjeçare, me shumë të shpallur 2,000 milion lekë, me kupon indikativ 5%, të pagueshëm çdo gjashtëmujor në datat 24 Gusht dhe 24 Shkurt, ku kërkesat për këtë ankand do të behën nëpërmjet Zhvilluesve të Tregut. Pas realizimit të ankandit, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 5250/1, datë 18.12.2023 ka dërguar informacion mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 31 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Në këtë ankand janë paraqitur 3 kërkesa jo-konkurrese në shumën 300 milion lekë dhe 28 kërkesa konkurrese në shumën 2,761 milion lekë, duke rezultuar në shumën totale të ofruar 2,961 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese si dhe 24 kërkesa konkurrese në shumën 2,100 milion lekë. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 4.8%, niveli i yield cutoff është 5.17% dhe niveli mesatar konkurrues është 5.053%. Me shkresën nr. 22543/1, datë 18.12.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 2,300 milion lekë dhe nivel yield-it të pranuar 5.17%, duke devijuar +15% nga shuma e shpallur. Pas ndryshimit në shumën e pranuar, Banka e Shqipërisë ka ri dërguar rezultatet e ankandit ku janë pranuar të 3 kërkesat jo-konkurrese në shumën 200 milion lekë, me nivel yield 5.053% si dhe 24 kërkesa konkurrese në shumën 2,100 milion lekë, me nivel yieldi të alokuar ndërmjet 4.8% dhe 5.17%..

- *Ankandi nr. 47RFR5, obligacion 3-vjeçar me shumë të shpallur 2,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 26.07.2023, ISIN AL000A3LEHC3.*

Me shkresën nr. 13021, datë 14.07.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin për ri hapjen e ankandit të obligacioneve 3-vjeçare, me shumë të shpallur 2,000

milion lekë, me kupon indikativ 5%, të pagueshëm çdo gjashtëmuor në datat 24 Gusht dhe 24 Shkurt, ku kërkesat për këtë ankand do të behën nëpërmjet Zhvilluesve të Tregut. Pas realizimit të ankandit, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 3192/1, datë 06.07.2023 ka dërguar informacion mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 23 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Në këtë ankand janë paraqitur 2 kërkesa jo-konkurrese në shumën 150 milion lekë dhe 21 kërkesa konkurrese në shumën 2,629 milion lekë, duke rezultuar në shumën totale të ofruar 2,779 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese si dhe 17 kërkesa konkurrese në shumën 2,150 milion lekë. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 3.4%, niveli i yield cutoff është 4.56% dhe niveli mesatar konkurrese është 4.462%. Me shkresën nr. 13021/1, datë 26.07.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 2,300 milion lekë me nivel yield-it të pranuar 4.56%, duke devijuar +15% nga shuma e shpallur. Pas ndryshimit në shumën e pranuar, Banka e Shqipërisë ka ri dërguar rezultatet e ankandit ku janë pranuar të 2 kërkesat jo-konkurrese në shumën 150 milion lekë, me nivel yield-i të alokuar 4.462% si dhe 17 kërkesa konkurrese në shumën 2,150 milion lekë, me nivel yieldi të alokuar ndërmjet 3.49% dhe 4.56%.

- *Ankandi nr. 40, obligacion 5-vjeçar me shumë të shpallur 3,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 09.02.2023, ISIN AL000A3LDG84.*

Me shkresën nr. 2249, datë 02.02.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin për zhvillimin e ankandit të obligacioneve 5vjeçare, me shumë të shpallur 3,000 milion lekë, nga të cilat 750 milion lekë për llogarit të vetë MFE-së, me kupon indikativ 6%, të pagueshëm çdo gjashtëmuor në datat 13 Gusht dhe 13 Shkurt, ku kërkesat për këtë ankand do të behën nëpërmjet Zhvilluesve të Tregut. Pas realizimit të ankandit, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 539/1, datë 09.02.2023 ka dërguar informacion mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 61 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Në këtë ankand janë paraqitur 4 kërkesa jo-konkurrese në shumën 350 milion lekë dhe 57 kërkesa konkurrese në shumën 5,197.9 milion lekë, duke rezultuar në shumën totale të ofruar 5,547.9 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese si dhe 22 kërkesa jo konkurrese, në shumën 3,100 milion lekë. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 4.9%, niveli i yield cutoff është 5.62% dhe niveli mesatar konkurrese është 5.461%. Me shkresën nr. 2249/1, datë 09.02.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 3,450 milion lekë, me nivel yield-it të pranuar 5.62%, nga të cilat 750 milion për llogari vetjake të MFE, duke devijuar +15% nga shuma e shpallur. Pas ndryshimit në shumën e pranuar, Banka e Shqipërisë ka ri dërguar rezultatet e ankandit ku janë pranuar të 4 kërkesat jo-konkurrese në shumën 350 milion lekë, me nivel yield-i të alokuar 5.461% si dhe 22 kërkesa konkurrese në shumën 3,100 milion lekë, me nivel yieldi të alokuar ndërmjet 4.9% dhe 5.62%.

- *Ankandi nr. 40RFR9, obligacion 5-vjeçar me shumë të shpallur 3,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 20.11.2023, ISIN AL000A3LDG84.*

Me shkresën nr. 20859, datë 15.11.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin për ri hapjen e ankandit të obligacioneve 5-vjeçare, me shumë të shpallur 3,000 milion lekë, me kupon indikativ 6%, të pagueshëm çdo gjashtëmuor në datat 13 Gusht dhe 13 Shkurt, ku kërkesat për këtë ankand do të behën nëpërmjet Zhvilluesve të Tregut. Pas realizimit të ankandit, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 4903/1, datë 20.11.2023 ka dërguar informacion mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 28 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së

Financave. Në këtë ankand janë paraqitur 4 kërkesa jo-konkurrese në shumën 250 milion lekë dhe 24 kërkesa konkurrese në shumën 2,528.5 milion lekë, duke rezultuar në shumën totale të ofruar 2,778.5 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese si dhe 23 kërkesa konkurrese në shumën 2,428.5 milion lekë. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 4.85%, niveli i yield cutoff është 5.74% dhe niveli mesatar konkurrues është 5.426%. Me shkresën nr. 20859/1, datë 20.11.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 2,473.5 milion lekë me nivel yield-it të pranuar 5.62%. Pas ndryshimit në shumën e pranuar, Banka e Shqipërisë ka ri dërguar rezultatet e ankandit ku janë pranuar të 4 kërkesat jo-konkurrese, në shumën 250 milion lekë, me nivel yield-i të alokuar 5.402% si dhe 21 kërkesa konkurrese në shumën 2,150 milion lekë, me nivel yieldi të alokuar ndërmjet 4.85% dhe 5.62%.

- *Ankandi nr. 032RF, obligacion 7-vjeçar me shumë të shpallur 2,500 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 13.09.2023, ISIN AL000A3LLKQ2.*

Me shkresën nr. 15928, datë 07.09.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin për ri hapjen e ankandit të obligacioneve 7-vjeçare, me shumë të shpallur 2,500 milion lekë, me kupon indikativ 5.06%, të pagueshëm çdo gjashtëmuor në datat 14 Shkurt dhe 14 Gusht, ku do të lejohen të marrin pjesë vetëm kërkesat konkurrese. Pas realizimit të ankandit, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 3821/1, datë 13.09.2023 ka dërguar informacion mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 28 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nga të cilat 1 kërkesa nga S..... L..... është paraqitur në zarf. Në këtë ankand janë paraqitur 28 kërkesa konkurrese në shumën 2,085.8 milion lekë, të cilat janë kualifikuar të gjitha. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 4.5%, niveli i yield cutoff është 5.85% dhe niveli mesatar konkurrues është 5.358%. Me shkresën nr. 15928/1, datë 13.09.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 1,685.8 milion lekë me nivel yield-it të pranuar 5.55%. Pas ndryshimit në shumën e pranuar, Banka e Shqipërisë ka ri dërguar rezultatet e ankandit ku janë pranuar 26 kërkesa konkurrese, të cilat janë alokuar me yield uniform 5.55%.

- *Ankandi nr. 027RF, obligacion 10-vjeçar me shumë të shpallur 3,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 26.10.2023, ISIN AL000A3LKLX8.*

Me shkresën nr. 18982, datë 18.10.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin për ri hapjen e ankandit të obligacioneve 10-vjeçare, me shumë të shpallur 3,000 milion lekë, me kupon indikativ 6%, të pagueshëm çdo gjashtëmuor në datat 13 Janar dhe 13 Korrik, ku do të lejohen të marrin pjesë vetëm kërkesat konkurrese. Pas realizimit të ankandit, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 4474/1, datë 26.10.2023 ka dërguar informacion mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 37 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nga të cilat 1 kërkesë nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave është paraqitur në zarf. Në këtë ankand janë paraqitur 37 kërkesa konkurrese në shumën 2,821.4 milion lekë, të cilat janë kualifikuar të gjitha. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 5%, niveli i yield cutoff është 7% dhe niveli mesatar konkurrues është 6.269%. Me shkresën nr. 18982/1, datë 26.10.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 2,408.8 milion lekë me nivel yield-it të pranuar 6.44%. Pas ndryshimit në shumën e pranuar, Banka e Shqipërisë ka ri dërguar rezultatet e ankandit ku janë pranuar 32 kërkesa konkurrese, në shumën 2,408.8 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield uniform 6.44%.

- *Ankandi nr. 3, obligacion 15-vjeçar me shumë të shpallur 2,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 22.02.2023, ISIN AL000A3LDXP4.*

Me shkresën nr. 2978, datë 13.02.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin për zhvillimin e ankandit të obligacioneve 15vjeçare, me shumë të shpallur 2,000 milion lekë, me kupon indikativ 8%, të pagueshëm çdo gjashtëmuor në datat 22 Gusht dhe 22 Shkurt. Pas realizimit të ankandit, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 705/1, datë 20.02.2023 ka dërguar informacion mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 169 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nga të cilat kërkesë nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe 1 kërkesë nga S..... L..... U..... janë paraqitur në zarf. Në këtë ankand janë paraqitur 52 kërkesa jo-konkurruese në shumën 1,220.8 milion lekë dhe 117 kërkesa konkurruese në shumën 4,510.5 milion lekë, duke rezultuar në shumën totale të ofruar 5,731.3 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar 52 kërkesat jo-konkurruese në shumën 397.4 milion lekë si dhe 52 kërkesa jo konkurruese, në shumën 1,602.6 milion lekë. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 5.8%, niveli i yield cutoff është 6.48% dhe niveli mesatar konkurrues është 6.279%. Me shkresën nr. 2798/1, datë 20.02.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 2,300 milion lekë, me nivel yield-it të pranuar 6.8%, duke devijuar +15% nga shuma e shpallur. Pas ndryshimit në shumën e pranuar, Banka e Shqipërisë ka ri dërguar rezultatet e ankandit ku janë pranuar 52 kërkesat jo-konkurruese, në shumën 457.2 milion lekë, si dhe 52 kërkesa konkurruese në shumën 1,842.8 milion lekë. Yieldi i alokuar është uniform në nivelin e 6.8%.

- *Ankandi nr. 003RF2, obligacion 15-vjeçar me shumë të shpallur 1,500 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 18.09.2023, ISIN AL000A3LDXP4..*

Me shkresën nr. 16254, datë 13.09.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin për ri hapjen e ankandit të obligacioneve 15-vjeçare, me shumë të shpallur 1,500 milion lekë, me kupon indikativ 6.8%, të pagueshëm çdo gjashtëmuor në datat 22 Gusht dhe 22 Shkurt, ku do të lejohen të marrin pjesë vetëm kërkesat konkurruese. Pas realizimit të ankandit, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 3919/1, datë 18.09.2023 ka dërguar informacion mbi rezultatet e ankandit. Referuar procesverbalit të komisionit të ankandit janë pranuar si të vlefshme 26 kërkesa, pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nga të cilat 1 kërkesa nga S..... L.....G.....është paraqitur në zarf. Në këtë ankand janë paraqitur 26 kërkesa konkurruese në shumën 786.3 milion lekë, të cilat janë kualifikuar të gjitha. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 5.6%, niveli i yield cutoff është 7.8% dhe niveli mesatar konkurrues është 7.036%. Me shkresën nr. 16254/1, datë 18.09.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 581.3 milion lekë me nivel yield-it të pranuar 7.3%. Pas ndryshimit në shumën e pranuar, Banka e Shqipërisë ka ri dërguar rezultatet e ankandit ku janë pranuar 24 kërkesa konkurruese, në shumën 581.3 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield uniform 7.3%.

- *Ankandi nr. 1993, bono thesari me maturim 3-mujor, me shumë të shpallur 1,000 milion lekë me datë zhvillimi ankandi 07.03.2023, me ISIN AL000A3LELË3.*

Me shkresën nr. 3983, datë 28.02.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin mbi zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 3-mujor, me shumë të shpallur 1,000 milion lekë, duke ofruar për shitje 800 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 200 milion lekë për Bankën e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë me shkresës nr. 954/1, datë 07.03.2023 ka dërguar rezultatet e ankandit. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 14 kërkesa të cilat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë

dhe Ministrisë së Financave. Në total janë paraqitur 10 kërkesa jo-konkurrese, në shumën 274.39 milion lekë dhe 4 kërkesa konkurrese, në shumën 900 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 1,174.39 milion lekë. Janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese në shumën 274.39 milion lekë si dhe janë kualifikuar 3 kërkesa konkurrese, në shumën 725.61 milion lekë, për plotësimin e shumës së shpallur për emetim. Yield minimal i pranuar është në nivelin e 2.8%, niveli i yield cutoff është 2.82% dhe niveli mesatar konkurrues është 2.805%. Me shkresën nr. 3983/1, datë 07.03.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 1,000 milion lekë me nivel yield-it të pranuar 2.82%. Në përfundim janë pranuar 10 kërkesa konkurrese, në shumën 274.39 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield 2.805% si dhe 3 kërkesa konkurrese, në shumën 725.61 milion lekë, të cilat janë alokuar në nivel yieldi ndërmjet 2.8% dhe 2.82%.

- *Ankandi nr. 1986, bono thesari me maturim 6-mujor me shumë të shpallur 2,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 31.01.2023 me ISIN AL000A3LC8M7 ankandi nr.1987, bono thesari me maturim 12-mujor me shumë të shpallur 11,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 31.01.2023, me ISIN AL000A3LC8N5.*

Me shkresën nr. 1564, datë 25.01.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimi mbi zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 6-mujor me shumë të shpallur 2,000 milion lekë (ku janë ofruar për shitje 1,700 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 300 milion lekë për Bankën e Shqipërisë) si dhe informacion për zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 11,000 milion lekë (ku janë ofruar për shitje 7,505.12 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 3,494.88 milion lekë për Bankën e Shqipërisë). Rezultatet për të dy ankandeve janë dërguar nga Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 401/1, datë 31.01.2023. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 24 kërkesa për ankandin me afat maturimi 6-mujor dhe 361 kërkesa për ankandin me afat maturimi 12-mujor, nga të cilat 1 kërkesë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore është paraqitur në zarf. Të gjitha kërkesat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Në total për ankandin me afat maturimi 6-mujor janë paraqitur 11 kërkesa jo-konkurrese, në shumën 374.44 milion lekë dhe 13 kërkesa konkurrese në shumën 1,403 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 1,776.44 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit me afat maturimi 6-mujor janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese dhe konkurrese. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 3.95%, niveli i yield cutoff është 4.6%, niveli mesatar konkurrues është 4.373%. Në total për ankandin me afat maturimi 12-mujor janë paraqitur 329 kërkesa jo-konkurrese, në shumën 6,294.37 milion lekë dhe 32 kërkesa konkurrese, në shumën 10,713.97 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 17,008.34 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese si dhe janë kualifikuar 16 kërkesa konkurrese në shumën 4,705.63 milion lekë, për plotësimin e shumës së shpallur për emetim. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 4%, niveli i yield cutoff është 4.89% dhe niveli mesatar konkurrues është 4.827%. Në vijim me shkresën nr. 1564/1, datë 31.03.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve për ankandet, ku për ankandin me afat maturimi 6-mujor ka pranuar për t'u emetuar shumën 1,766.44 milion lekë, me yield të pranuar 4.6%, ndërsa për ankandin me afat maturimi 12-mujor ka pranuar për të emetuar shumën 12,650 milion lekë, me yield-i të pranuar 5%, duke devijuar +15% nga shuma e shpallur. Pas ndryshimit të shumës së pranuar, Banka e Shqipërisë ka ridërguar rezultatet e ankandeve. Në përfundim, për ankandin me afat maturimi 6 mujor janë pranuar 11 kërkesa jo konkurrese në shumën 373.44 milion lekë të cilat janë alokuar me yield 4.373% dhe 13 kërkesa konkurrese të cilat janë alokuar me nivel yieldi ndërmjet 3.95% dhe 4.58%. Ndërsa për ankandin me afat maturimi 12 mujor janë pranuar 329 kërkesa jo konkurrese në shumën 6,294.37 milion lekë të cilat janë alokuar me yield 4.859% dhe 28

kërkesa konkurruese në shumën 6,355.63 milion lekë, të cilat janë alokuar me nivel yieldi ndërmjet 4% dhe 5%

- *Ankandi nr. 1982, bono thesari me maturim 3-mujor me shumë të shpallur 1,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 04.01.2023 me ISIN AL000A3LGA3, ankandi nr. 1983, bono thesari me maturim 12-mujor me shumë të shpallur 12,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 04.01.2023, me ISIN AL000A3LCGB1.*

Me shkresën nr. 23457, datë 21.12.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimi mbi zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 3-mujor me shumë të shpallur 1,000 milion lekë (ku janë ofruar për shitje 752.58 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 247.42 milion leke për Bankën e Shqipërisë) si dhe informacion për zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 12,000 milion lekë (ku janë ofruar për shitje 10,550 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 1,450 milion lekë për Bankën e Shqipërisë). Rezultatet për të dy ankandeve janë dërguar nga Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 5528/1, datë 04.01.2023. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 13 kërkesa për ankandin me afat maturimi 3-mujor dhe 181 kërkesa për ankandin me afat maturimi 12-mujor, nga të cilat 1 kërkesë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe 1 kërkesë nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave janë paraqitur në zarf. Të gjitha kërkesat janë pranuar nga komisioni pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Në total për ankandin me afat maturimi 3-mujor janë paraqitur 6 kërkesa jo-konkurruese, në shumën 271.35 milion lekë dhe 7 kërkesa konkurruese në shumën 1,200 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 1,471.35 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit me afat maturimi 3-mujor janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurruese si dhe 5 kërkesa konkurruese, në shumën 728.64 Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 3%, niveli i yield cutoff është 3.1% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.031%. Në total për ankandin me afat maturimi 12-mujor janë paraqitur 147 kërkesa jo-konkurruese, në shumën 2,810.82 milion lekë dhe 34 kërkesa konkurruese, në shumën 13,640 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 16,451.22 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurruese si dhe janë kualifikuar 18 kërkesa konkurruese në shumën 9,189.18 milion lekë, për plotësimin e shumës së shpallur për emetimin. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 5.15%, niveli i yield cutoff është 5.4% dhe niveli mesatar konkurrues është 5.32%. Në vijim me shkresën nr. 23457/1, datë 04.01.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve për ankandet, ku për ankandin me afat maturimi 3-mujor ka pranuar për t'u emetuar shumën 999.99 milion lekë, me yield të pranuar 3.1%, ndërsa për ankandin me afat maturimi 12-mujor ka pranuar për të emetuar shumën 13,799.99 milion lekë, me yield-i të pranuar 5.45%, duke devijuar +14.99% nga shuma e shpallur. Pas ndryshimit të shumës së pranuar, Banka e Shqipërisë ka ridërguar rezultatet e ankandeve. Në përfundim, për ankandin me afat maturimi 3 mujor janë pranuar 6 kërkesa jo konkurruese në shumën 271.35 milion lekë të cilat janë alokuar me yield 3.031% dhe 5 kërkesa konkurruese, në shumën 728.64 milion lekë, të cilat janë alokuar me nivel yieldi ndërmjet 3% dhe 3.1%. Ndërsa për ankandin me afat maturimi 12 mujor janë pranuar 147 kërkesa jo konkurruese në shumën 2,810.82 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield 5.338% dhe 24 kërkesa konkurruese në shumën 10,989.17 milion lekë, të cilat janë alokuar me nivel yieldi ndërmjet 5.15% dhe 5.45%.

- *Ankandi nr. 2013, bono thesari me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 7,200 milion lekë me datë zhvillimi ankandi 29.08.2023, me ISIN AL000A3LL702.*

Me shkresën nr. 15123, datë 22.08.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin mbi zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 7,200 milion lekë, duke ofruar për shitje 5,000 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 2,200 milion lekë për Bankën e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë me shkresës nr.

3660/1, datë 29.08.2023 ka dërguar rezultatet e ankandit. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 12 kërkesa të cilat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nga të cilat 1 kërkesë nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është paraqitur në zarf. Në total janë paraqitur 154 kërkesa jo-konkurrese, në shumën 3,595.53 milion lekë dhe 17 kërkesa konkurrese, në shumën 6,381.99 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 9,977.52 milion lekë. Janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese si dhe janë kualifikuar 5 kërkesa konkurrese, në shumën 3,604.47 milion lekë, për plotësimin e shumës së shpallur për emetim. Yield minimal i pranuar është në nivelin e 3%, niveli i yield cutoff është 3.15% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.149%. Me shkresën nr. 15123/1, datë 29.08.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 7,200 milion lekë me nivel yield-it të pranuar 3.15%. Në përfundim janë pranuar 154 kërkesa konkurrese, në shumën 3,595.53 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield 3.149% si dhe 5 kërkesa konkurrese, në shumën 3,604.47 milion lekë, të cilat janë alokuar në nivel yieldi ndërmjet 3% dhe 3.15%.

- Ankandi nr. 2007, bono thesari me maturim 3-mujor me shumë të shpallur 1,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 04.07.2023 me ISIN AL000A3LKGH1, ankandi nr. 2008, bono thesari me maturim 12-mujor me shumë të shpallur 5,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 04.07.2023, me ISIN AL000A3LKGJ7.

Me shkresën nr. 11813, datë 27.06.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimi mbi zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 3-mujor me shumë të shpallur 1,000 milion lekë (ku janë ofruar për shitje 752.58 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 247.42 milion lekë për Bankën e Shqipërisë) si dhe informacion për zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 5,000 milion lekë (ku janë ofruar për shitje 4,500 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 500 milion lekë për Bankën e Shqipërisë). Rezultatet për të dy ankandet janë dërguar nga Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 2947/1, datë 04.07.2023. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 9 kërkesa për ankandin me afat maturimi 3-mujor dhe 12 kërkesa për ankandin me afat maturimi 12-mujor, nga të cilat 1 kërkesë nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave është paraqitur në zarf. Të gjitha kërkesat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Në total për ankandin me afat maturimi 3-mujor janë paraqitur 6 kërkesa jo-konkurrese, në shumën 281.33 milion lekë dhe 3 kërkesa konkurrese në shumën 500 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 781.33 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit me afat maturimi 3-mujor janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese dhe konkurrese. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 3.02%, niveli i yield cutoff është 3.07% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.056%. Në total për ankandin me afat maturimi 12-mujor janë paraqitur 69 kërkesa jo-konkurrese, në shumën 1,005.95 milion lekë dhe 20 kërkesa konkurrese, në shumën 13,640 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 7,050 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese si dhe janë kualifikuar 15 kërkesa konkurrese në shumën 3,994.05 milion lekë, për plotësimin e shumës së shpallur për emetim. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 3.02%, niveli i yield cutoff është 3.2% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.091%. Në vijim me shkresën nr. 11813/1, datë 04.01.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve për ankandet, ku për ankandin me afat maturimi 3-mujor ka vendosur anulimit e tij ndërsa për ankandin me afat maturimi 12-mujor ka pranuar për të emetuar shumën 5,000 milion lekë, me yield-i të pranuar 3.2%. Në përfundim, për ankandin me afat maturimi 12 mujor janë pranuar 69 kërkesa jo konkurrese në shumën 1,005.95 milion lekë të cilat janë alokuar me yield 3.091% dhe 15

kërkesa konkurruese, në shumën 3,994.05 milion lekë, të cilat janë alokuar me nivel yieldi ndërmjet 3.02% dhe 3.2%.

- *Ankandi nr. 2003, bono thesari me maturim 6-mujor me shumë të shpallur 1,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 30.05.2023 me ISIN AL000A3LHYL2,, ankandi nr. 2004, bono thesari me maturim 12-mujor me shumë të shpallur 7,500 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 30.05.2023, me ISIN AL000A3LHYM0.*

Me shkresën nr. 9482, datë 24.05.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimi mbi zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 6-mujor me shumë të shpallur 1,000 milion lekë, si dhe informacion për zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 7,500 milion lekë (ku janë ofruar për shitje 4,000 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 3,500 milion lekë për Bankën e Shqipërisë). Rezultatet për të dy ankandeve janë dërguar nga Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 2412/1, datë 30.05.2023. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 23 kërkesa për ankandin me afat maturimi 6-mujor dhe 193 kërkesa për ankandin me afat maturimi 12-mujor. Të gjitha kërkesat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Në total për ankandin me afat maturimi 6-mujor janë paraqitur 9 kërkesa jo-konkurruese, në shumën 47.19 milion lekë dhe 14 kërkesa konkurruese në shumën 2,350 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 2,397.19 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit me afat maturimi 6-mujor janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurruese si dhe 6 kërkesa konkurruese, në shumën 952.8 milion lekë. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 3.15%, niveli i yield cutoff është 3.2% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.184%. Në total për ankandin me afat maturimi 12-mujor janë paraqitur 171 kërkesa jo-konkurruese, në shumën 4,697.32 milion lekë dhe 22 kërkesa konkurruese, në shumën 5,672 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 10,369.32 milion lekë. Nga rezultatet e ankandit janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurruese si dhe janë kualifikuar 8 kërkesa konkurruese në shumën 2,802.67 milion lekë, për plotësimin e shumës së shpallur për emetim. Yield minimal i pranuar për këtë ankand është në nivelin e 3.4%, niveli i yield cutoff është 3.46% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.44%. Në vijim me shkresën nr. 9482/1, datë 30.05.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve për ankandet, ku për ankandin me afat maturimi 6-mujor ka pranuar për emetim shumën 999.99 milion lekë, me nivel yield 3.2%, ndërsa për ankandin me afat maturimi 12-mujor ka pranuar për të emetuar shumën 7,499.99 milion lekë, me yield-i të pranuar 3.46%. Në përfundim, për ankandin me afat maturimi 6 mujor janë pranuar 9 kërkesa jo konkurruese në shumën 47.19 milion lekë të cilat janë alokuar me yield 3.184% dhe 6 kërkesa konkurruese, në shumën 952.88 milion lekë, të cilat janë alokuar me nivel yieldi ndërmjet 3.15% dhe 3.2%. Ndërsa për ankandin me afat maturimi 12 mujor janë pranuar 171 kërkesa jo konkurruese në shumën 4,697.32 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield 3.44% dhe 8 kërkesa konkurruese në shumën 2,802.67 milion lekë, të cilat janë alokuar me nivel yieldi ndërmjet 3.4% dhe 3.46%

- *Ankandi nr. 2000, bono thesari me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 9,000 milion lekë me datë zhvillimi ankandi 02.05.2023, me ISIN AL000A3LGUR9.*

Me shkresën nr. 7629, datë 25.04.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin mbi zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 9,000 milion lekë, duke ofruar për shitje 4,500 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 4,500 milion lekë për Bankën e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë me shkresës nr. 1963/1, datë 02.05.2023 ka dërguar rezultatet e ankandit. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 215 kërkesa të cilat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nga të cilat 1 kërkesë nga Instituti i Sigurimit të Depozitave dhe 2 kërkesat nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, janë paraqitur në zarf. Në

total janë paraqitur 186 kërkesa jo-konkurrese, në shumën 5,855.79 milion lekë dhe 29 kërkesa konkurrese, në shumën 8,464.5 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 14,320.29 milion lekë. Janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese si dhe janë kualifikuar 15 kërkesa konkurrese, në shumën 3,144.2 milion lekë, për plotësimin e shumës së shpallur për emetim. Yield minimal i pranuar është në nivelin e 3.5%, niveli i yield cutoff është 3.78% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.745%. Me shkresën nr. 7629/1, datë 02.05.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 8,999.99 milion lekë me nivel yield-it të pranuar 3.78%. Në përfundim janë pranuar 186 kërkesa jo konkurrese, në shumën 5,855.79 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield 3.745% si dhe 15 kërkesa konkurrese, në shumën 3,144.2 milion lekë, të cilat janë alokuar në nivel yieldi ndërmjet 3.5% dhe 3.78%.

- *Ankandi nr. 2017, bono thesari me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 10,000 milion lekë me datë zhvillimi ankandi 17.10.2023, me ISIN AL000A3LPBH1.*

Me shkresën nr. 18317, datë 17.10.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin mbi zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 10,000 milion lekë, duke ofruar për shitje 7,082 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 2,918 milion lekë për Bankën e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë me shkresës nr. 4349/1, datë 17.10.2023 ka dërguar rezultatet e ankandit. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 630 kërkesa të cilat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nga të cilat 1 kërkesë Agjencia e Sigurimit të Depozitave është paraqitur në zarf. Në total janë paraqitur 610 kërkesa jo-konkurrese, në shumën 6,612.6 milion lekë dhe 20 kërkesa konkurrese, në shumën 6,822.5 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 13,435.1 milion lekë. Janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese në shumën 6,455.75 si dhe janë kualifikuar 9 kërkesa konkurrese, në shumën 3,544.25 milion lekë, për plotësimin e shumës së shpallur për emetim. Yield minimal i pranuar është në nivelin e 3%, niveli i yield cutoff është 3.15% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.107%. Me shkresën nr. 18317/1, datë 17.10.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumën 10,000 milion lekë me nivel yield-it të pranuar 3.15%. Në përfundim janë pranuar 610 kërkesa jo konkurrese, në shumën 6,455.75 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield 3.107% si dhe 9 kërkesa konkurrese, në shumën 3,544.2 milion lekë, të cilat janë alokuar në nivel yieldi ndërmjet 3% dhe 3.14%.

- *Ankandi nr. 2018, bono thesari me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 9,500 milion lekë me datë zhvillimi ankandi 31.10.2023, me ISIN AL000A3LPT69.*

Me shkresën nr. 19447, datë 25.10.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin mbi zhvillimin e ankandit të bonove të thesarit me maturim 12-mujor, me shumë të shpallur 9,500 milion lekë, duke ofruar për shitje 6,100 milion lekë për bankat e nivelit të dytë dhe 3,400 milion lekë për Bankën e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë me shkresës nr. 4584/1, datë 31.10.2023 ka dërguar rezultatet e ankandit. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej kërkesa 377 të cilat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nga të cilat 1 kërkesë Agjencia e Sigurimit të Depozitave është paraqitur në zarf. Në total janë paraqitur 355 kërkesa jo-konkurrese, në shumën 5,793.57 milion lekë dhe 22 kërkesa konkurrese, në shumën 5,907 milion lekë, duke rezultuar në një ofertë totale për blerjen e këtij instrumenti në shumën 11,700.57 milion lekë. Janë kualifikuar të gjitha kërkesat jo-konkurrese si dhe janë kualifikuar 13 kërkesa konkurrese, në shumën 3,706.43 milion lekë, për plotësimin e shumës së shpallur për emetim. Yield minimal i pranuar është në nivelin e 2.9%, niveli i yield cutoff është 3.13% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.103%. Me shkresën nr. 19447/1, datë 31.10.2023,

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për emetim shumë 9,500 milion lekë me nivel yield-it të pranuar 3.13%. Në përfundim janë pranuar 355 kërkesa jo konkurruese, në shumë 5,793.57 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield 3.103% si dhe 13 kërkesa konkurruese, në shumë 3,706.43 milion lekë, të cilat janë alokuar në nivel yieldi ndërmjet 2.98% dhe 3.13%.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2093/3, datë 27.11.2024 “Mbi qëndrimin e Bankës së Shqipërisë për Projektraportin e auditimit”, protokolluar në KLSH me nr. 655/9, datë 27.11.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit: *Në lidhje me rekomandimin 4.1 shprehemi se i përmbahemi shpjegimeve të dhëna në Akt-konstatimin nr. 3 datë 09.10.2024 (nr.prot.4119/1) për kërkesa të mbërritura nga ASD për menaxhimin e dy fondeve të ndryshme. Nuk ka asnjë kufizim rregullativ që pengon një subjekt të paraqesë shuma të ndryshme me të njëjtin yield. Për analogji, sqarojmë se bankat mund të paraqesin në ankand nëpërmjet llogarisë së individëve, respektivisht sipas llojit të ankandit më shumë se tre ose pesë shuma të ndryshme me të njëjtin yield, që teorikisht mund të jenë një individ ose shumë individë. Këto konsiderohen shuma të ndryshme jo kërkesa të ndryshme. Kjo paraqitje është më se e pranueshme pasi varet nga llogari me të cilën bëhen shlyerjet e veprimeve dhe nuk përbën asnjë shkelje për barazinë e subjekteve në ankand. Gjithashtu, përsërisim qëndrimin e mbajtur në lidhje me të njëjtin rekomandim në raportin e KLSH për vitin 2020-2021, dhe vitin 2022 ku është sqaruar se përcaktimi në Nenin 8, pika 3 i Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 31, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistri”, dhe Nenit 9, pika 3 e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të thesarit në formë regjistri”, kërkesë konkurruese unike nga një subjekt konsiderohet kërkesa (pavarësisht në sa shuma të ndryshme është ndarë) që ndryshon në yieldin e përcaktuar me 0.01% nga kërkesa tjetër. Qëllimi i përcaktimit të numrit të kërkesave në ankand në raport me përcaktimin e yieldit ka qenë shmangia e vendosjes së kërkesave të pakufizuara të subjekteve me shuma të ulta dhe çmime të ndryshme në eksplorim të përcaktimit të çmimit ekuilibër në ankand (price discover) Për sa më sipër sqaruar, kërkesat e ASD në të dy ankandet e cituara kanë qenë në përputhje me numrin maksimal të lejuar për pjesëmarrjen nga një subjekt.*

Në lidhje me rekomandimin 5.1, Banka e Shqipërisë e pranon këtë rekomandim dhe do të vlerësojë eficiencën e sportelit të Bonove për popullsinë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Grupi i auditimit pasi shqyrtoi observacionin, i qëndron konstatimit se “Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme” nuk është subjekt, por një Fond i cili administrohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Gjithashtu, fondi i krijuar nga Shoqëritë e Kursimit të Kreditit në ASD nuk ka personalitet juridik.

Mbi zbatimin e marrëveshjes me ministrinë Financave për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë si agjent fiskal për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, lidhur me kryerjen e veprimeve me para lidhur me llogaritë e Shtetit në Bankën e Shqipërisë.

Në zbatim të Drejtimit 4.3 të Programit të Auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë për periudhën 01.01.2023-31.12.2023:

- Marrëveshja Kuadër midis Ministrisë së Financave (MF) dhe Bankës së Shqipërisë (BSH) me nr. 251 Prot., datë 16.01.2015 në BSH dhe nr. 716/1 Prot., datë 20.01.2015 në MFE, e ndryshuar;
- Marrëveshja e “Menaxhimit të disa llogarive të Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë”;
- Rakordimet për të ardhurat nga bankat e nivelit të dytë;
- Shkresat e rakordimeve mujore të llogarisë kryesore të qeverisë nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës (DSPKF) për periudhën 01.01.2023;
- Shkresat e rakordimeve mujore të llogarisë kryesore të qeverisë nga Departamenti i Operacioneve Monetare (DOM) për periudhën 01.01.2023;

- Të dhëna mbi llogaritë speciale në Bankën e Shqipërisë në monedhë vendase dhe valutë të huaj;
- Të dhëna mbi veprimet e kryera nga Banka e Shqipërisë për transfertat në valutë; etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Mbi saktësinë e raportimeve të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë Qeverie”, me Bankën e Shqipërisë çdo muaj dhe në fund të vitit 2023

Referuar korrespondencave dhe shkresave dërguar mes Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përgjatë vitit 2023, për konfirmimin mbi të ardhurat, konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit (DPTH) në MFE inicion kërkesën për raportim nga Departamenti i Operacioneve Monetare (DOM) në BSH, ku ky i fundit i konfirmon përmbledhësen e të ardhurave të buxhetit të shtetit të raportuara nga bankat tregtare. Përgjatë periudhës objekt auditimi, MFE dhe BSH kanë rakorduar mbi të ardhurat e bankave të nivelit të dytë për secilin nga muajt, paraqitur si në tabelën nr. 1. Pra, shkëmbimi i informacionit është kryer çdo muaj për të ardhurat e bankave të nivelit të dytë sipas referimit të Aneksit nr. 2 të “Marrëveshjes Kuadër”, të datës 16.01.2015 mes BSH dhe Qeverisë Shqiptare, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ku është përcaktuar se “Banka e Shqipërisë duhet të dërgojë çdo muaj konfirmim mbi të ardhurat dhe shpenzimet totale të qeverisë.”

Tabela nr. 1: Rakordimi i të ardhurave të bankave të nivelit të dytë mes BSH dhe MFE

Në lekë

Periudha	Sipas BSH (A)	Sipas MFE (B)	Diferenca (A) - (B)
1 Janar - 31 Janar 2023	45,061,418,392.82	45,061,014,489.82	403,903.00
1 Janar - 28 Shkurt 2023	84,111,564,786.21	84,111,564,786.21	-
1 Janar - 31 Mars 2023	140,465,118,565.52	140,465,118,565.52	-
1 Janar - 30 Prill 2023	187,734,749,257.73	187,734,828,281.73	-79,024.00
1 Janar - 31 Maj 2023	236,134,448,662.38	236,134,505,512.38	-56,850.00
1 Janar - 30 Qershor 2023	284,921,564,137.47	284,921,620,987.47	-56,850.00
1 Janar - 31 Korrik 2023	334,334,837,659.49	334,333,879,579.49	958,080.00
1 Janar - 31 Gusht 2023	384,580,755,730.30	384,580,755,730.30	-
1 Janar - 30 Shtator 2023	433,374,918,851.30	433,374,918,851.30	-
1 Janar - 31 Tetor 2023	483,242,667,106.23	483,242,668,306.23	-1,200.00
1 Janar - 30 Nëntor 2023	536,933,874,443.59	536,933,878,043.59	-3,600.00
1 Janar - 31 Dhjetor 2023	591,329,439,570.28	591,329,440,770.28	-1,200.00

Burimi: Të dhënat nga Banka e Shqipërisë. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH

Nga analiza e të dhënave rezulton se gjatë muajve të vitit 2023 nuk janë paraqitur diferenca, përveç rasteve në vijim:

- Për raportimin Janar 2023, rezulton diferencë prej 403,930 lekë për T....B..... Kjo diferencë sipas BSH është subjekt i rakordimit mes B.... U..... dhe MFE pasi në sistemin AIPS për këtë periudhë mes B..... T.....dhe BSH është konfirmuar e njëjta shumë në vlerën 1,822,621,054.97 lekë. Kjo diferencë nuk është mbartur më në vijim gjatë muajve, duke rezultuar në muajt Shkurt dhe Mars 2023 pa diferenca mes BSH dhe MFE.
- Për raportimin Janar – Prill 2023, rezulton diferencë prej 79,024 lekë, specifikisht 56,850 lekë për B..... A..... dhe 22,174 lekë për B..... U.... Banka e Shqipërisë përmes shkresës nr. 2330/1 prot., datë 18.05.2023 ka sjellë në vëmendje sistemin e diferencës 22,174 lekë derdhur më pak në llogarinë e qeverisë në krahasim me raportimin në evidencën ditore nga B..... U..... më datë 10.05.2023, si dhe ka përcjellë në MFE për rakordim diferencën me O..... T..... B..... pasi hyrjet në sistemin e pagesave dhe raportimi në BSH i të ardhurave nuk kanë diferenca.

- Për raportimin Janar – Maj 2023 dhe Janar – Qershor 2023 rezulton diferencë prej 56,850 lekë për A..... B....., mbartur nga periudhat e mëparshme.
- Për raportimin Janar – Korrik 2023, rezulton diferencë prej 958,080 lekë për U.....B..... BSH përmes shkresës me nr. 3542/1 prot., datë 14.08.2023 ka njoftuar MFE se për diferencën në periudhën Janar – Qershor 2023, raportimi përmes evidencës së A.....B....., regjistrimet në evidencën e BSH dhe hyrjet në llogarinë kryesore të qeverisë nga kjo bankë, janë të rakorduara dhe pa diferenca. Ndaj, diferenca mbetet për t'u sqaruar nga MFE dhe A..... B.....
Sa i takon hyrjeve në llogarinë kryesore të MFE dhe regjistrimet dhe të ardhurave sipas raportimeve ditore në BSH nga U..... B..... janë të rakorduara në shumën 11,351,781,739.19 lekë. Gabimi nga ana e U..... B..... ka qenë në raportimin sipas evidencës së datës 31.07.2023 në totalin kumulativ 11,350,823,659.19 lekë, pra më pak në shumën 958,080 lekë. Pas komunikimeve, B..... U..... ka bërë sistemimet në evidenca dhe i ka dërguar drejt BSH duke mbyllur kështu diferencën.
- Për raportimin Janar – Tetor 2023, rezulton diferencë prej 1,200 lekë për A..... B..... . Kjo diferencë sipas BSH është subjekt i rakordimit mes B..... U..... dhe MFE pasi në sistemin AIPS për këtë periudhë mes B..... T..... dhe BSH është konfirmuar e njëjta shumë.
- Për raportimin Janar – Nëntor 2023, rezulton diferencë prej 3,600 lekë, specifikisht 1,200 për A..... B..... (mbartur nga periudha paraardhëse) dhe 2,400 lekë për U..... B..... Banka e Shqipërisë përmes shkresës nr. 5338/1 prot., datë 20.12.2023 njofton MFE se diferenca me A..... B..... dhe U..... B..... janë subjekt i rakordimit mes bankave të nivelit të dytë dhe MFE pasi në rakordimet me BSH në sistemin AIPS rezultojnë pa diferenca.
- Për raportimin Janar – Dhjetor 2023, rezulton diferencë prej 1,200 lekë për A..... B....., diferencë e cila vijon të mbetet e pasistemuar që në muajin Tetor 2023, për të cilën BSH nuk ka patur diferenca në sistemin AIPS.

Mbi rakordimin e zërit të të ardhurave totale të raportuara nga bankat dhe shpenzimet totale të iniciuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me zërin e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë qeverie”, zëri “Të ardhurat nga Bankat e Nivelit të Dytë”.

Lidhur me të ardhurat totale dhe shpenzimet totale, përmes korrespondencës mes DOM në BSH dhe DPTH në MFE, konstatohet se nga ana e DOM raportohet vetëm për shumën totale të të ardhurave dhe shpenzimet totale të iniciuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Përsa i përket periudhës 01.01.2023-31.12.2023 konstatohet një diferencë konstante prej afërsisht 165.46 mijë lekë që prej muajit Shkurt e deri në fund të vitit 2023, dhe një diferencë në shpenzime totale prej 1915,87 mijë lekë nga muaji Shkurt e deri në fund të vitit, e cila është rritur deri në vlerën 6,537.35 mijë lekë në fund të vitit. Kjo diferencë vjen si pasojë e reflektimit të zërit “Pagesë principali për garancinë sovranë” i cili është evidentuar si zë më vete në evidencën e MF në vlerë 6,537.35 mijë lekë, ndërsa në evidencën e BSH përfshihet në zërin III.1 Shpenzime sipas bankave. Gjithashtu, edhe zëri “Kthim Principali” në vlerë 165.46 mijë lekë është evidentuar si zë më vete, ndërsa në evidencën e BSH përfshihet në totalin e të ardhurave derdhur nga bankat e nivelit të dytë.

Tabela nr. 2: Përmbledhje e të ardhurave dhe shpenzimeve totale sipas BSH dhe MFE, 2023
Në 000/Lekë

Periudha	DOM		MFE		Diferenca	
	Të ardhura totale	Shpenzime totale	Të ardhura totale	Shpenzime totale	Të ardhura totale	Shpenzime totale
01.01-31.01.2023	49,016,418.90	49,119,312.10	49,016,418.90	49,119,312.10	0.00	0.00
01.01-28.02.2023	87,764,717.71	73,630,648.08	87,764,552.24	73,628,732.21	165.47	1,915.87
01.01-31.03.2023	135,660,736.13	108,103,963.70	135,660,570.67	108,102,047.83	165.46	1,915.87
01.01-30.04.2023	189,903,152.86	140,648,025.59	189,902,987.40	140,646,109.72	165.46	1,915.87
01.01-31.05.2023	240,046,954.77	172,036,225.92	240,046,789.31	172,033,181.26	165.46	3,044.66
01.01-30.06.2023	287,548,729.71	204,215,136.91	287,548,564.28	204,212,092.26	165.43	3,044.65
01.01-31.07.2023	337,312,392.15	233,390,516.73	337,312,226.69	233,387,472.08	165.46	3,044.65

01.01-31.08.2023	388,091,271.19	260,245,139.71	388,091,105.73	260,241,657.99	165.46	3,481.72
01.01-30.09.2023	436,089,928.06	285,283,515.27	436,089,762.60	285,280,033.55	165.46	3,481.72
01.01-31.10.2023	487,030,628.08	317,771,526.64	487,030,462.62	317,768,044.92	165.46	3,481.72
01.01-30.11.2023	534,120,674.40	364,493,350.60	534,120,508.94	364,486,813.25	165.46	6,537.35
01.01-31.12.2023	593,325,902.72	423,167,555.23	593,325,737.26	423,161,017.88	165.46	6,537.35

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Operacioneve Monetare, BSH. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Mbi saktësinë e konfirmimeve të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë Qeverie”, me Bankën e Shqipërisë për periudhën 1 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2023

Lëvizjet dhe gjendja e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë Qeverie” çdo muaj dhe në fund të vitit financiar, në mbështetje të Marrëveshjes Kuadër, është subjekt i konfirmimit mes Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë sipas korrespondencave. Çdo muaj të vitit 2023, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit pranë Ministrisë së Financave ka rakorduar me Departamentin e Operacioneve Monetare dhe Departamentin e Sistemit të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës pranë Bankës së Shqipërisë, në lidhje me “Gjendjen dhe lëvizjet e llogarisë së unifikuar të thesarit “Depozitë Qeverie” në lekë (ALL), në euro (EUR), në dollarë (USD) dhe SDR, të shoqëruara me evidencat mujore të tyre. Çdo evidencë mujore e transaksioneve të “Depozitës së Qeverisë në lekë dhe valutë”, ka bashkëngjitur datën e kryerjes së transaksionit, kursin e këmbimit dhe përshkrimin e zërave, në të cilat janë kontabilizuar transaksionet.

Nga shqyrtimi i të dhënave të vëna në dispozicion si dhe nga auditimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të kaluara në llogarinë “Depozitë e Qeverisë” nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nga Banka e Shqipërisë ka rezultuar se Departamenti i Operacioneve Monetare dërgon konfirmime mujore mbi të ardhurat totale dhe shpenzimet totale dhe gjithashtu dërgon konfirmime ditore në rrugë elektronike (përmes email) drejt Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në MFE.

Çdo shkresë mujore e DOM në Bankën e Shqipërisë konfirmon të ardhurat totale të raportuara nga Bankat e Nivelit të Dytë dhe shpenzimet totale të iniciuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. DOM nuk kryen raportim të gjendjes së llogarisë “Depozitë Qeverie” në përgjigje të shkresave nga MFE, pasi citon se “Evidenca e Buxhetit në ALL, EUR, USD, SDR dërgohet çdo ditë në rrugë elektronike pranë institucionit tuaj, bazuar në këtë marrëveshje”. Konfirmimi nga DOM çdo muaj dhe në fund të vitit bëhet për shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndërsa DSPKF konfirmon çdo muaj dhe në fund të vitit gjendjen e llogarisë dhe në valuta.

Për vitin 2023, rakordimi është bërë çdo muaj nga ana e DSPKF në BSH, në përgjigje të shkresave të nisura nga ana e MFE. Nga auditimi i korrespondencës për gjendjen e llogarisë së unifikuar të thesarit “Depozitë e qeverisë” në monedhë vendase dhe në valutë, ndërmjet dy institucioneve, rezultoi se gjendja e kësaj llogarie është e njëjtë.

Tabela nr. 3: Paraqitja e gjendjes në fund të muajit për llogarinë “Depozitë Qeverie” në valutë për vitin 2023 nga MFE dhe BSH

Në 000/monedhë

Periudha	DSKPF në BSH				DPTH në MFE			
	Llogaria kryesore e qeverisë				Llogaria kryesore e qeverisë			
	ALL	EUR	USD	SDR	ALL	EUR	USD	SDR
31.01.2023	20,169,120.28	215,109.12	389.51	6,706.11	20,169,120.28	215,109.12	389.51	6,706.11
28.02.2023	10,539,733.83	208,547.43	46,271.94	0.00	10,539,733.83	208,547.43	46,271.94	0.00
31.03.2023	17,073,094.88	217,486.90	31,048.74	0.00	17,073,094.88	217,486.90	31,048.74	0.00
30.04.2023	29,754,763.96	204,115.80	18,211.21	14,037.50	29,754,763.96	204,115.80	18,211.21	14,037.50
31.05.2023	31,369,998.34	191,665.55	9,983.40	6,004.04	31,369,998.34	191,665.55	9,983.40	6,004.04
30.06.2023	40,106,475.35	839,380.05	373.95	4,041.54	40,106,475.35	839,380.05	373.95	4,041.54
31.07.2023	32,350,449.07	799,258.50	210.49	1,629.04	32,350,449.07	799,258.50	210.49	1,629.04
31.08.2023	36,867,566.59	764,067.01	210.49	1,337.18	36,867,566.59	764,067.01	210.49	1,337.18
30.09.2023	39,801,152.36	781,477.47	79.11	1,337.18	39,801,152.36	781,477.47	79.11	1,337.18
31.10.2023	25,752,954.54	716,419.56	339.58	10,462.18	25,752,954.54	716,419.56	339.58	10,462.18
30.11.2023	12,663,540.29	614,382.89	605.55	2,620.32	12,663,540.29	614,382.89	605.55	2,620.32
31.12.2023	11,995,177.64	752,342.06	937.03	657.82	11,995,177.64	752,342.06	937.03	657.82

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MF. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Afate e Raportimit referuar Marrëveshjes Kuadër

Aneksi nr. 1 i Marrëveshjes Kuadër mes Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, datë 20.10.2015, përcakton detyrimin e BSH për të dërguar konfirmimin e informacionit mbi të ardhurat dhe shpenzimet totale, çdo muaj (përmes një shkrese) në afatin kohor prej 3 ditë pune pas mbërritjes së shkresës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Rezulton se për vitin 2023, korrespondencat janë shkëmbyer përmes shkresave të paraqitura në tabelën nr. 4 lidhur me konfirmimet mbi të ardhurat dhe shpenzimet.

Tabela nr. 4: Pasqyra e afateve të korrespondencave mes MFE dhe BSH për vitin 2023 për konfirmimet mbi të ardhurat dhe shpenzimet

Për gjendjen më datë	Shkresa e dërguar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë		Data e mbërritjes në BSH (A)	Shkresa e dërguar nga Banka e Shqipërisë (B)		Diferenca në ditë (B) – (A)
	Nr. Prot	Data		Data	Nr. Prot	
31.01.2023	3421	17/02/2023	22/02/2023	840/1	23/02/2023	1
28.02.2023	3421/3	17/03/2023	20/03/2023	1283/1	23/03/2023	3
31.03.2023	3421/5	14/04/2023	20/04/2023	1870/1	20/04/2023	0
30.04.2023	3421/8	17/05/2023	22/05/2023	3484/1	23/05/2023	1
31.05.2023	3421/11	16/06/2023	20/06/2023	2818/1	20/06/2023	0
30.06.2023	3421/14	17/07/2023	18/07/2023	4968/1	19/07/2023	1
31.07.2023	3421/16	16/08/2023	18/08/2023	5621/1	21/08/2023	3
31.08.2023	3421/19	18/09/2023	20/09/2023	4017/1	21/09/2023	1
30.09.2023	3421/22	17/10/2023	19/10/2023	4493/1	20/10/2023	1
31.10.2023	3421/25	17/11/2023	23/11/2023	5026/1	24/11/2023	1
30.11.2023	3421/28	18/12/2023	20/12/2023	5357/1	20/12/2023	0
31.12.2023	3421/31	25/01/2024	29/01/2024	486/1	29/01/2024	0

Burimi: Të dhënat nga Banka e Shqipërisë. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Sa i takon dërgimit të shkresave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë drejt Bankës së Shqipërisë, konstatohen diferenca më të vogla në kohë krahasimisht me vitin paraardhës në datat mes shkresës së dërguar nga MFE dhe mbërritjes së saj në BSH. Përgjithësisht, shkresat e MFE mbajnë datën rreth/pas javës së dytë të muajit pasardhës, ndërkohë që pas mbërritjes në BSH, kjo e fundit ka respektuar afatin prej 3 ditë pune në kthimin e përgjigjes mbi këto konfirmime.

Në Marrëveshjen Kuadër mes Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, lidhur për periodicitetin e raportimit nga ana e MFE-së përcaktohet vetëm periudha e raportimit mujor, pa caktuar një afat. Ndërkohë për Bankën e Shqipërisë përcaktohet afati prej 3 ditë pune pas mbërritjes së shkresës nga MFE.

Rakordimi dhe konfirmimi me zëra i të ardhurave, shpenzimeve dhe gjendjes së llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë” më 31.12.2023

Nga auditimi konstatohet se si Banka e Shqipërisë ashtu edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbajnë evidencat e tyre lidhur me zërat dhe nënzërat e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe gjendjes së Llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë”. Sa i takon vitit 2023, rezulton se për BSH të ardhurat ose hyrjet e depozitës i përkasin vlerës 709,657,094.44 mijë lekë, ku rreth 83% vijnë nga të ardhurat dhe 17% nga transfertat/investimet, ndërsa shpenzimet ose daljet e depozitës janë në total 616,951,209.09 mijë lekë.

Tabela nr. 5: Zërat e të ardhurave, shpenzimeve dhe gjendjes së llogarisë “Depozitë e Qeverisë”

Në 000/Lekë

Nr.	E M Ë R T I M I	Gjendja sipas MFE (A)	Gjendja sipas BSH (B)	Diferenca (B) - (A)
A+B	TË ARDHURAT, HYRJET E DEPOZITËS	278,752,570.07	709,657,094.44	-430,904,524.37
A	TOTALI TË ARDHURAVE	167,967,012.37	588,201,764.31	-420,234,751.94

(I+II+III)				
I	Të ardhura nga taksat	170,164,719.39	527,706,339.20	-357,541,619.81
1	Nga Tatimet	-	286,101,796.76	-286,101,796.76
2	Nga Doganat	-	241,604,542.44	-241,604,542.44
II	Të ardhura jo tatimore	-2,197,707.01	60,495,425.11	-62,693,132.13
1	Të ardhura jo tatimore sipas raportit të bankave	-	60,344,757.04	-60,344,757.04
2	Fitimi i derdhur nga Banka e Shqipërisë	-	-	-
3	Kontribute vullnetare	-	-	-
4	Dividendi nga Ndërmarrjet e përbashkëta	-	-	-
5	Të ardhura nga koncesionet	9,299.41	-	9,299.41
6	Të ardhura nga shitja e licen. telekomunikacionit	-	-	-
7	Te ardhura nga AAPSK	-	-	-
8	Te ardhura nga sekuestrimi Prokuroria e pergjithshme	-	-	-
9	Të ardhura të tjera	-22,611.17	150,668.07	-173,279.24
10	Transferuar ne mjete ne ruajtje per shpronësimet	-3,000,000.00	-	-3,000,000.00
	E hyre e pa përcaktuar, Disbursime Projekt me Financim (derdhje e perkohshme)	992,649.71	-	-
	E dale e pa përcaktuar, Disbursime Projekt me Financim (derdhje e perkohshme)	-177,044.97	-	-
III	Grand	-	-	-
B	FINANCIMI, INVESTIMI, TRANSFERTA	110,785,557.69	121,455,330.13	-10,669,772.43
(I+II+III)				
I	Financimi në total	61,512,121.31	61,942,298.36	-430,177.05
1	Financimi i brendshëm	19,870,412.45	20,818,328.15	-
-	Nëpërmjet bonove të thesarit	-20,936,663.69	-20,936,663.69	-
-	Nëpërmjet Obligacioneve	40,807,076.14	41,754,991.84	-947,915.70
2	nen/huaja	4,416,459.63	148,218.77	4,268,240.85
-	Principiali	3,833,180.28	-	3,833,180.28
-	Interesa	583,279.35	-	583,279.35
3	Financimi i jashtëm	37,085,732.09	40,898,903.63	-3,813,171.54
-	IBRD Loan No. 94860 - First Resilience and Green Development	11,443,551.42	-	11,443,551.42
-	Mbeshtetje buxhetore per Kontrates se Reformes Sektoriale BE per Perfshirjen Sociale	934,324.65	-	934,324.65
-	mbeshtetje buxhetore sektoriale per kontraten BE per Energjiine (grant)	7,876,799.64	-	7,876,799.64
-	Mbeshtetje Buxhetore Kredia AFD	7,771,750.00	-	7,771,750.00
-	Mbeshtetje Buxhetore Kontrata e Reformes Sektoriale te BE-se per Drejtesine	722,474.63	-	722,474.63
-	Mbeshtetje Buxhetore Economic Recovery	1,181,847.09	-	1,181,847.09
-	Mbeshtetje buxhetore per Kontrates se Reformes Sektoriale BE per Mireqeverisjen	1,842,984.65	-	1,842,984.65
-	Mbeshteje buxhetore Arabia Saudite Grant	5,312,000.00	-	5,312,000.00
4	Projekte me thesar të plotë	62,669.34	-	62,669.34
5	Total interesa Depozita	76,847.81	-	76,847.81
6	interesa të depozitës më afat	61,995.07	76,847.81	-14,852.74
7	Interesa nga depozita Garanci	14,852.74	-	14,852.74
II	Depozitë & KREDI	-500,000.00	3,768,240.85	-4,268,240.85
1	Depozitë për garanci	-500,000.00	-500,000.00	-
-	Maturim Depozitë	-	-78,500,000.00	78,500,000.00
-	Interesa depozite me afat	-	78,000,000.00	-78,000,000.00
2	Kredi	-	4,268,240.85	-4,268,240.85
III	Transferta e të ndryshme (1+2)	49,773,436.38	55,744,790.91	-5,971,354.52
1	Gjendja e mbartur nga viti 2021	49,773,436.38	49,773,436.38	-
2	Difereca cash e accruall	-	5,229,959.90	-5,229,959.90
3	transferta nga llogari të vecanta	-	741,394.62	-741,394.62
(I+II+III)	SHPENZIMET, DALJE TE DEPOZITËS	247,578,703.43	616,951,209.09	-369,372,505.66
I	Shpenzime të Përgjithshme	141,419,412.74	567,586,967.97	-426,167,555.23
1	Shpenzime sipas bankave të nivelit të dytë	-	423,167,555.23	-423,167,555.23
2	Transferta për ISSH-në	120,475,000.00	120,475,000.00	-
3	Transferta për ISKSH-në(FSDKSH)	18,880,000.00	18,880,000.00	-
4	Transferta për llogaritë e tjera speciale	2,064,412.74	5,064,412.74	-3,000,000.00
-	Transferta për kompesimin e pronave	2,064,412.74	-	2,064,412.74
-	Transfertë kapitale për Shpronësimet	-	-	-
II	Shpenzime për borxhin e brendshëm	29,030,327.55	29,030,327.55	-
1	Shpen. interesat e Bonove të Thesarit	-	7,497,072.92	-7,497,072.92
2	Shpenzime për interesat e Obligacioneve	-	21,533,254.63	-21,533,254.63
III	Shpenzime për borxhin e Jashtëm	71,798,555.51	18,150,592.46	53,647,963.06
1	Interesa të Borxhit të Jashtëm	53,237,892.76	18,150,592.46	35,087,300.31
2	Principiali i Borxhit të Jashtëm	18,273,045.97	-	18,273,045.97
3	komisioni i borxhit të jashtëm	287,616.78	-	287,616.78
III	Shpen.Kapitale	3,863,866.61	3,863,866.61	-
IV	Gabime, kthime nga bankat e nivelit të dytë	-1,680,545.49	-1,680,545.49	-
V	Huadhënie e KESH-it	-	-	-
VI	Transferim I shumes Kthyer nga Konvert projekti Aech Societe General	-	-	-

	Pagese Ministria e Bujqesise fondet (IBRD)	-	-	-
	Pagese komision Ministria e Bujqesise fondet (IBRD)	-	-	-
	Transferte e Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit	-	-	-
	Transferte per ISHP	422,557.30	-	422,557.30
	Pagese Kuotash per Banka CEB - MF	304,651.33	-	304,651.33
	Transferte per KQZ	415,777.73	-	415,777.73
	Pagese Ministria e Mbrojtjes ne usd	2,030,155.31	-	2,030,155.31
	Transfeta Ministria e Arsimit	158,619.11	-	158,619.11
	Huadhenie e ALBCONTROL	3,000,000.00	-	3,000,000.00
	Transferte per Turqine (ndihme) MEPJ	110,930.00	-	110,930.00
	Komision i transferes per Turqine (ndihme) MEPJ	2.74	-	2.74
	Pagese Kuotash per Banka IFC	121,173.08	-	121,173.08
	Pagesa interesi garancia sovrane	-	-	-
	Diferenca Kursi i kembimit konvertim USD transfert ministrise se Mbrojtjes diferenca date pagese date regjistrimi ne sistem ,	25,913.43	-	25,913.43
	Diferenca Kursi i kembimit konvertim Euro USD transfert MM	-30,849.32	-	-
	Diferenca Kursi i kembimit konvertim Euro USD transfert ISHP	-1,467.23	-	-
	Transferte e Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit	300,000.00	-	-
H-D	GJENDJA E LLOGARISË MË 31.12.2023	95,034,136.23	95,034,136.23	-
I	Gjendja në Lekë	11,995,177.64	11,995,177.64	-
II	Gjendja në valutë e konvertuar në lekë	83,038,958.59	83,038,958.59	-
1	Gjendja në Euro	78,153,292.77	82,674,550.05	-4,521,257.28
-	Interesa Spot Forëard (për euro)	283,964.40	-	-
	22.1 Fitim/humbje Konvertim projekti në Euro	6,043.94	-	-
	Diferenca Kursi i kembimit Blerje valute (konvertim nga lek në euro)/shitje valute (konvertim nga euro në leke)	87,500.00	-	-
	Rivleresim i EURO dhjetor 2023	4,143,748.94	-	-
2	Gjendja në dollar amerikan (USD)	88,024.44	236,141.03	-148,116.59
	Interesa Spot Forëard (për USD)	-	-	-
	22.2 Fitim/humbje Konvertim projekti në USD	866.80	-	-
	Rivleresim i USD dhjetor 2023	147,249.79	-	-
3	Gjendja në SDR	82,911.76	128,267.51	-45,355.75
-	Interesa Spot Forëard (për SDR)	-	-	-
	Rivleresim i SDR dhjetor 2023	44,330.06	-	-
	Diferenca kursi kembimi pas balances=0Sdr te llogarise ne SDR	1,025.69	-	-

Burimi: Tabela e konceptuar nga grupi i auditimit me të dhënat nga subjekti.

Referuar tabelës përmbledhëse për llogarinë “Depozitë e Qeverisë” nga Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë, gjendja në fund të vitit në datën 31.12.2023, e llogarisë “Depozitë e Qeverisë” është e njëjtë në monedhën vendase dhe në valutë të konvertuar në lekë, në vlerën 95,034,136.23 mijë lekë, edhe pse rezultojnë diferenca në zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve pasi MFE dhe BSH përdorin sisteme të ndryshme regjistrimi. Pavarësisht sistemit të ndryshëm të regjistrimit, gjendja e llogarisë “Depozitë e Qeverisë” rezulton e njëjtë.

Mbi veprimet e kryera për pagesat/transfertat në valutë nga llogaritë “Depozitë e Qeverisë” sipas valutave përkatëse

Lidhur me transfertat në valutë, Banka e Shqipërisë realizon kryerjen e transaksionit pas shkresës së mbërritur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për vlerat mbi 1 milionë EUR/USD. Bazuar në korrespondencat dhe të dhënat mbi këto pagesa, nga grupi i auditimit janë evidentuar 10 transfertat nga llogaria e unifikuar e thesarit në valuta dhe të konvertuara në shumën totale 3,864,145,152.84 lekë. Sipas muajve dhe periudhave rezultojnë transfertat në valutë si në vijim:

- Në muajin Shkurt, rezultojnë 1 transfertë në vlerën 1,217,940.17 USD me objekt “*Transfertë për vaksinë gripi*” me urdhërues Institutin e Shëndetit Publik.
- Në muajin Mars, rezultojnë 1 transfertë në vlerën 1,440,046.92 USD me objekt “*Transfertë për vaksinë kalendari*” me urdhërues Institutin e Shëndetit Publik.
- Në muajin Prill, rezultojnë 1 transfertë në vlerën 1,172,000.00 USD me objekt “*Rritje e përgjithshme e kapitalit të RSH në IFC*” me urdhërues Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

- Në muajin Maj, rezultojnë 2 transfertë, përkatësisht një transfertë në vlerën 1,000,000.00 EUR me objekt *“Ndihmë financiare humanitare për tërmetin në Turqi”* me urdhërues Përfaqësitë Diplomatike – Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe një transfertë në vlerën 4,042,957.32 USD me objekt *“Blerje pajisje elektronike të votimit dhe numërimit PEVN”* me urdhërues Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
- Në muajin Qershor, rezulton 1 transfertë në vlerën 1,417,900.51 EUR me objekt *“Pagesë kuote vjetore 2023 “Horizon Europa”* me urdhërues Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Në muajin Gusht, rezulton 1 transfertë në vlerën 1,417,190.32 USD, kryer nga Depozita e Qeverisë në EUR, me objekt *“Transfertë për vaksinë kalendari”* me urdhërues Institutin e Shëndetit Publik;
- Në muajin Tetor, rezulton 1 transfertë në vlerën 20,244,867.50 USD, kryer nga Depozita e Qeverisë në EUR, me objekt *“Shpenzime për rritjen e AAM - Përmirësim i sistemeve dhe pajisje të teknologjisë dhe informacionit, komunikimit dhe monitorimit (Dron)”* me urdhërues Forca Ajrore (Rep 3001) – Ministria e Mbrojtjes;
- Në muajin Nëntor, rezulton 1 transfertë në vlerën 2,885,447.73 EUR me objekt *“Mbështetje financiare projektit BERZH, viti 2023”* me urdhërues Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;
- Në muajin Dhjetor, rezulton 1 transfertë në vlerën 2,933,006.00 EUR me objekt *“Rritje e kapitalit të RSH në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB)”* me urdhërues Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Për transfertat në valutë në vlerat mbi 1 milion EUR/USD, Banka e Shqipërisë kryen transfertën pas mbërritjes së shkresës nga ana e MFE në të cilën përcaktohet shuma e transfertës dhe llogaria përmes së cilës do të kryhet transfertë. Rezulton se për dy prej transfertave të sipërcituara, edhe pse valuta ka qenë USD, duke qenë në mungesë të gjendjes së llogarisë Depozitë e Qeverisë në USD, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka kërkuar që transfertat të kryhet duke përdorur Depozitën e Qeverisë në EUR, e rrjedhimisht duke shkaktuar diferenca nga kursi i këmbimit për valutën e përdorur. Në konkluzion, evidentohet se transfertat e datës 22.08.2023 për Institutin e Shëndetit Publik dhe transfertat e datës 27.10.2023 për Ministrinë e Mbrojtjes, nuk janë kryer duke përdorur llogarinë “Depozitë e Qeverisë në USD”, pavarësisht se valuta e përcaktuar ka qenë USD. Transaksionet e kryera nga Banka e Shqipërisë kanë diferenca njëditore me Urdhër-Shpenzimet. Nga MFE është kërkuar që për të kryer këto dy pagesa të përdoret fondi në llogarinë “Depozitë e Qeverisë në Euro”.

Nga konvertimi i njëpasnjëshëm EUR në USD në ALL në përfundim të transaksioneve (iniciuar nga shkresat e MFE) sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit rezulton se në total ka një diferencë prej -8,559,581.55 lekë mes Urdhër-Shpenzimeve dhe transfertës në të cilën kanë ndikuar mënyra e kryerjes së konvertimit (nga EUR në USD në ALL) dhe kurset e këmbimit të përdorura nga BSH në konvertim në datat e kryerjes së konvertimit.

Auditimi i konfirmimit të llogarive speciale të qeverisë në Bankën e Shqipërisë, jashtë llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë qeverie”

Në referencë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Banka

e Shqipërisë ka të drejtë të veprojë si agjente fiskale për llogari të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, sipas kushteve dhe mënyrave të parashikuara në marrëveshje me Ministrinë e Financave. Gjithashtu Banka e Shqipërisë nëpërmjet sistemit bankar, kryen funksionet e arkës së buxhetit të shtetit. Ajo mund të pranojë depozita nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe kryen veprime pagesash deri në kufijtë e këtyre depozitave dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshje, mund të autorizojë një bankë sipas gjykimit të saj, ku të kalojnë këto depozita. Në Udhëzimin nr. 13, datë 13.12.2023 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2023”, kapitulli III “Marrëdhëniet e Ministrisë së

Financave me Bankën e Shqipërisë” në pikën 15 citohet se “Llogaria “Depozitë e qeverisë dhe të gjitha llogaritë speciale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Bankën e Shqipërisë, në datën e parë të punës në muajin Janar të vitit 2024, do të mbartin tepricën e këtyre llogarive në fund të vitit.”

Llogaritë speciale në BSH

Në Bankën e Shqipërisë janë të çelura për llogari të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, përveç Llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë qeverie” edhe disa llogari të tjera speciale të qeverisë, në monedhë vendase dhe në valutë.

Llogaritë speciale të qeverisë të çelura në BSH janë gjendje në fund të vitit sipas tabelës nr. 6, për të cilat BSH ka konfirmuar gjendjen e tyre përmes shkresës nr. 192/1 prot., datë 12.01.2024 dërguar drejt MFE.

Tabela nr. 6: Gjendja e llogarive speciale në BSH në 30.12.2023 për valutën ALL

Monedha	Emërtimi	Balanca më 31.12.2023
<i>Llogaritë e shpronësimeve (A)</i>		
ALL	Fond për dëshmshpërblimin e të përndjekurve politikë	-
ALL	Fondi i shpronësimeve	264,780,792.28
ALL	Fondi për mbështetjen dhe rindërtimin e Gërdecit	64,643,000.00
ALL	Fondi i shpronësimeve të ngrira për procedurë	44,796,904.96
ALL	Për administrimin e fondit special të kompensimit të pronave	6,860,295,237.56
ALL	Llogari solidariteti për dëmet nga tërmeti 2019	-
	Totali	7,234,515,934.80
<i>Llogari speciale të Qeverisë (B)</i>		
ALL	GRANT Japonez	113,352,388.00
ALL	GRANT Japonez - për Mbështetje Buxhetor	310,942,586.00
ALL	GRANT Proj. Modern Arkivave Shqiptare	0.50
ALL	Italian Albani Dept Sëap Agreem. II Managem Committ	537,215,627.53
ALL	Proj. Ins.Resu.Gjen.Kons.Agrobodiver.Z.Rurale Shqi	1,122,895.20
ALL	Projekti Fond. Kunderpart Shqip-Zvic.Sec.Energj	702,921,900.00
ALL	Strong Albanian Local Statistics II	11,000,000.00
ALL	SRD-2 UBT	3,000,000.00
	Totali	1,679,555,397.23
	TOTALI (A) + (B)	8,914,071,332.03

Burimi: Të dhënat nga Banka e Shqipërisë. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Ndërsa, sa i takon llogarive të çelura në monedhë të huaj si EUR, USD, CHF, GBP, JPY dhe SEK, Banka e Shqipërisë ka dërguar konfirmimin mbi gjendjen e tyre në 31.12.2023 përmes të njëjtës shkresë dërguar drejt MFE, në përgjigje të shkresës nr. 411 prot., datë 10.01.2024 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nga shqyrtimi i të dhënave grupi i auditimit ka konkluduar në tabelat e mëposhtme ku paraqitet gjendja e llogarive sipas valutave, vetëm për ato llogari të cilat kanë gjendje jo zero në fund të vitit 2023.

Lidhur me llogaritë special në valutë EUR, referuar konfirmimit të BSH rezulton se vlera totale tyre sipas llogarive të projekteve është 15,889,618.28 EUR, paraqitur në tabelën nr. 7 për të gjitha llogaritë me balancë jo zero.

Tabela nr. 7: Gjendja e llogarive speciale në BSH në 30.12.2023 për valutën EUR

Monedha	Emërtimi	Balanca më 31.12.2023
<i>Llogari speciale të Qeverisë</i>		
EUR	GRALB Experience Tourism G.E.T	13,608.91
EUR	Interreg Adrion AMOCEAB UBT	17,964.00
EUR	Uji i pastër në Gjakovë dhe Kukës	0.05
EUR	SO	21,169.91
EUR	Projekti SRD-UBT	14,517.33
EUR	Development of Master Program - MEP&M DPD	13,464.57

EUR	New Relity of the Heritage Sites	82,741.41
EUR	Development of Master Program - MEP&M DPD	24,484.00
EUR	Ndihmë KfW Zhvillimi i infrastrukturës	523.87
EUR	REACH-UART	227,096.60
EUR	REEBUG PLUS MIE	15,052.93
EUR	CLLD-CulTour	87,043.70
EUR	Projekti Kredi Mbështetja Zhvillim Biznesi Privat	4,036,171.10
EUR	Lidhja hekurudhore Durrës Prishtinë	979,900.00
EUR	Euro MED STC UT	4,200.00
EUR	KNOWHUB UV	304.94
EUR	Qev.Greke/Projekt Infrastrukture, Shqipëri e Jugut	71,894.36
EUR	FIRE PREP	25,913.05
EUR	SafeDigitAL-EU UT	20,996.70
EUR	Financ.Shtese Permir.Sist.Shendet	1,600,000.00
EUR	SMART-HC UT	20,996.70
EUR	EUWB UT	20,996.70
EUR	CASOEUAL UT	20,996.70
EUR	ROOT'S	22,891.51
EUR	GreenFIB UT	20,996.70
EUR	ADRILINK FSHZH	131,488.12
EUR	MinDEU UT	8,046.70
EUR	ADRISEISMIC BGJ	12,980.58
EUR	PPET-EI UT	20,996.70
EUR	Asistencë Teknike Balkanmed	592.50
EUR	BLUEWBC MIE	100.00
EUR	DEAL-EU UPT	20,996.70
EUR	Grant Komisione European "Kurrikulat e shkencës së sportit në RSH"	0.01
EUR	ADRINETBOOK	8,393.24
EUR	Programi i Zhvillimit të Mjedisit	294,023.96
EUR	Projekti DILMA	0.30
EUR	Strengthening External Audit Supervision for Concessions-PPP	57.38
EUR	i-Thea	1,667.29
EUR	HEI4FUTURE	51,060.00
EUR	Projekti i Rrugëve dytësore dhe vendore - CEB	29.10
EUR	SMARTIMONY	3,344.81
EUR	MAPCULT BP	51,421.75
EUR	New Opportunities in Kukës - NOK	1.10
EUR	Asistencë teknike për zbatimin e programit Shqipëri-Mal i Zi 2008	44,218.97
EUR	Asistencë teknike për zbatimin e programit Shqipëri-Maqedoni 08	221.70
EUR	Përmirësimi i infrastrukturës së QKF	0.23
EUR	Natural and cultural network for the prom.and.integ.of trans.res	1,482.71
EUR	ADRIFORT	26,841.76
EUR	ADRIATIC GOVERNANCE OPERATIONAL PLAN	625.46
EUR	Spredy projekti i përbashkët për vler. Mjed.me.qev.dinamike	15,034.92
EUR	A.Live art channel	21,415.16
EUR	Planifikimi i sektorit të ujit për negociatat me BE-në	443,536.29
EUR	EMOUNDERGROUNDS	612.60
EUR	Join EU SEE	1,038.00
EUR	Food Trails	7,798.20
EUR	IntegTeknoDigjitMetodMësimdhënie	4,800.00
EUR	Future Medicine Spitali Obstetrik Gjinek Koco Glozheni	58,138.12
EUR	Promot.Connect.Internet Boardband in Accursed Mount Bord. Area	56.46
EUR	ProSEED	113,000.00
EUR	Europe Adriatic Sea Way (EA-SEAWAY)	8,149.23
EUR	MAReC Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi	0.40
EUR	SMART4YOU2	10,582.43
EUR	Skemat e praktikës për punësimin e të rinjve në Shqipëri	1,326.41
EUR	Program i reformimit të QSUT - Faza II kredi	630,000.00
EUR	Program i reformimit të QSUT - Faza II grant	200,000.00
EUR	Përmirësimi i shërbimit shëndetësor HSIP	623,133.03
EUR	Projekt-H2020-VISSEM	3,794.25

EUR	EPALE National Support Services	128,896.21
EUR	Mbështetje për pagesën e detyrimeve offsetimeve për MIE	12,437.57
EUR	Asiste.Tek.për.zbat.e prog.Shqipëri-Kosovë alokimet 2014-2016	35,560.00
EUR	Asis.Tek.për prog.Interreg IPA CBC Greqi Shqipëri 2014-2020	86,591.92
EUR	Erasmus+Library NetWork Support Services	10,748.38
EUR	Blue NET	3,656.39
EUR	1FUTURE	218,284.60
EUR	ERASMUS+GRADUA	24,275.16
EUR	Nat.Coord.for the Imp. Of the European Agend.for Adult Learn.	52,868.74
EUR	AGROLABS	83,919.03
EUR	Smart WB UPT	16,993.38
EUR	Zbatimi i projektit PANORAMED 2017-2022	7,296.34
EUR	Asistencë Teknike për zbatimin e programit ADRION	2,873.25
EUR	Zbatimi i projektit EUSAIR facility point 2017-2023	45,126.09
EUR	THEMA	4,725.88
EUR	INTEC UPT	35,331.75
EUR	IoT - ECO UAMD	1.00
EUR	Business Registry Development	10,200.00
EUR	GATE	104,107.86
EUR	INNOTOURCLUST	39,648.48
EUR	EnerNetMob	11,250.00
EUR	ForWork - Fostering Opportunities for Refugee Workers	12,230.65
EUR	NETMETERING	13,192.89
EUR	BAS	64,204.45
EUR	BLU LAND AKZM	1,498.09
EUR	Rritja e biodiversitetit në lumin Drin, BIODRINI	58,373.64
EUR	AIRTHINGS	92,223.14
EUR	MoMaVET	11,497.68
EUR	Inter-Connect	26,902.03
EUR	SAGOV	4,589.33
EUR	Disaster do not know borders PSH	24,979.19
EUR	3CASME	74,996.74
EUR	CROSS BORDER OI UBT	79,050.00
EUR	BalkanROAD UBT	29,431.56
EUR	CIRCLE	6,407.47
EUR	EUSAIR 4 Youth BD	22.00
EUR	MultiAPPRO	13,815.02
EUR	ADRINET UBT	10,200.00
EUR	BALKANET UBT	49,352.70
EUR	PROSFORA	5,223.62
EUR	E-HORECA WANET KQV	21,688.38
EUR	TOURNEE-Bashkia Fier	140,625.75
EUR	MONET MK	83,340.11
EUR	4 PLUS B KOLONJË	25,661.42
EUR	Preserving Cultural Landscape of Albania and Montenegro KQSH	0.10
EUR	NET METERING B PUSTEC	27,467.68
EUR	WASTE REACT KQGJ	10,392.47
EUR	3 WATCH OUT KQLezhë	10,373.63
EUR	WELCOME MTM	32,957.33
EUR	REGLPORTS MTM	105,925.99
EUR	HISTEK-UD	62,497.80
EUR	3D IMP ACT IMK	31,175.24
EUR	HAMLET MK	213,904.88
EUR	Social Care Services in Mallakastra	0.10
EUR	3CASME QKB	10,185.74
EUR	PHAREM SRV	6,348.28
EUR	OPEN TOURISM BF	70,594.95
EUR	Plastic Busters Marine Protected Areas MTM	36,890.42
EUR	ERASMUS STEP UBT	18,953.18
EUR	CB Railway MIE	34,091.40
EUR	Promotion of alternative tourism ECO Routes	20.70

EUR	Algal forest restoration in the Mediterranean Sea	5,062.90
EUR	AKZM-LASPEH	17.52
EUR	TOURNEE	68,902.68
EUR	POLYPHONIA MK	7,071.80
EUR	ERASMUS+HarISA UBT	5,292.30
EUR	Monuments in Nature:A Creative Co-existence Mo.Na	49,488.36
EUR	TO BE READY ALB	3,137.08
EUR	Food4Health	364,851.52
EUR	HERMES UPT	0.70
EUR	ALMONIT	2,450,225.57
EUR	RE-SOURCE MTM	13,208.00
EUR	DUE MARI/358	36.04
EUR	SCOPE	7,685.79
EUR	SOLARIS	89,062.50
EUR	Erasmus + Vtech @ WBUUni	100.00
EUR	BLUE DEAL	1,200.00
EUR	TARGET	0.34
EUR	VjoSusDev	8,718.20
EUR	ERASMUS+GEOBIZ	5,576.42
EUR	AuthentiKK BK	27,841.75
EUR	G.A.M.E.S	0.96
EUR	E NATURA BB	20,570.61
EUR	SMENSWICT	129,557.42
	Totali	15,899,618.28

Burimi: Të dhënat nga Banka e Shqipërisë. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Sa i takon llogarive speciale të Qeverisë në USD, rezultojnë 8 llogari me gjendje jo zero, të cilat në total kanë patur gjendje 389,312.04 USD në datën 31.12.2023 sipas konfirmimit nga Banka e Shqipërisë.

Tabela nr. 8: Gjendja e llogarive speciale në BSH në 30.12.2023 për valutën USD

Monedha	Emërtimi	Balanca më 31.12.2023
<i>Llogari speciale të Qeverisë</i>		
USD	Loan - Zhvillimi Rural i Rretheve Verilind.	17,772.05
USD	Projekt Importeve Kritike (Bank. Botërore)	21,064.96
USD	Kredi - Projekti i Pyjeve, IDA	0.29
USD	Kredi Zhvill. Rural. Zonat Verilind.	778.30
USD	GRAND "Projekti Sekuestrimit të Karbonit" Qev Japoneze	2.00
USD	Grant Projekti për Administrimin e Integruar të Ujrave Ekosistemeve	54.00
USD	Projekti i Fondit global për AIDS, Tuberkuloz dhe Malarie - GFATM	293,040.44
USD	Qukës - Qafë Ploçë Seksionet 1 dhe 2	56,600.00
	Totali	389,312.04

Burimi: Të dhënat nga Banka e Shqipërisë. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Përsa u përket llogarive në valutat CHF, GBP, JPY dhe SEK, nga të dhënat rezulton se gjendja e tyre është zero në 31.12.2023.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2093/3, datë 27.11.2024 “Mbi qëndrimin e Bankës së Shqipërisë për Projekt raportin e auditimit”, protokolluar në KLSH me nr. 655/9, datë 27.11.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me rekomandimin 1. Parimet e ofrimit të instrumenteve të menaxhimit të likuiditetit nga BSH për MF janë: Ruajtja e normave të tregjeve në përputhje me orientimin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Shumat dhe afatet që janë përcaktuar në marrëveshje krijojnë kushtet dhe incentivat për një administrim sa më efektiv të zbatimit të politikës monetare dhe asaj fiskale në vend. Instrumentet e ofruara janë instrumente për menaxhimin afatshkurtër të likuiditetit dhe që të sigurojnë kushtet për një menaxhim aktiv të borxhit të shtetit. Shprehemi së instrumentet e depozitës në lekë dhe valutë, si dhe SËAP-e valutë/lekë dhe lekë/valutë, i shërbejnë më së miri këtij qëllimi. Në këtë kuadër

nuk jemi në dijeni të instrumenteve të tjera potenciale që t'i shërbejnë qëllimit të lartpërmendur. Në qoftë se ka propozime konkrete për instrumente shtesë jemi të hapur t'i diskutojmë. Parimi i pavarësisë së bankës qendrore nga shteti. Banka e Shqipërisë në marrëdhëniet e saj financiarë me shtetin udhëhiqet nga parimi i pavarësisë institucionale, parim që i siguron tagrin e nevojshëm për zbatimin e politikës monetare të saj. Ofrimi i instrumenteve me terma të privileguara përbën shkelje të parimit të pavarësisë.

Për sa i përket marrëdhënies financiare BSH me MOF duhet të kihet parasysh që çdo shpenzim i rritur i BSH përkthehet në ulje të derdhjes së fitimit që banka bën te MF e si rrjedhim në terma të përfitimit neto MOF mbetet në të njëjtin pozicion financiar.

Për sa i përket shfrytëzimit të mundësisë që i ofrohet MF për përdorimin e instrumenteve që BSH vë në dispozicion, mbetemi në qëndrimin e mbajtur në përgjigjen ndaj akt konstatimit nr. 2 (nr.4118/1, datë 09.10.24) që mirë-administrimi i likuiditetit të qeverisë është detyrë e Ministrisë së Financave dhe sa më shpejt ky likuiditet të kalojë në ekonomi aq më mirë është për GDP-në e vendit.

Qëndrimi i audituesve: Sa i takon instrumenteve të përdorura në menaxhimin e likuiditetit, rekomandimi i grupit të auditimit konsiston në marrjen e masave për nxitje të mundësive mbi investimin e likuiditeteve, pasi edhe në vetë mendimet e dhëna nga BSH është rekomanduar që MF të jetë më agresive në investime.

Grupi i auditimit sqaron se pavarësisht se mbetet përgjegjësi e Ministrisë së Financave mirëadministrimi dhe menaxhimi i likuiditetit dhe tepricave të tij në monedhën vendase dhe të huaj, në kuadër të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së përfaqësuesve të BSH në Komitetin e Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit, evidentohet rëndësia e bashkëpunimit lidhur me këto procese.

2.5 Mbi regjistrimin dhe evidentimin e borxhit të jashtëm publik të Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 26, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, citohet se: “*Banka e Shqipërisë, në marrëveshje me Ministrinë e Financave, regjistron dhe evidenton borxhin e jashtëm publik dhe privat të Republikës së Shqipërisë, nëse e sheh të nevojshëm ose të mundshëm*”.

Referuar marrëveshjes kudrës “Për ofrimin e shërbimeve financiare nga Banka e Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”, (protokolluar në BSH me nr. 251, datë 16.01.2015 dhe MF me nr. 716/1, datë 20.01.2015), e ndryshuar, nenin 3, shërbimet financiare që Banka kryen për Ministrinë e Financës janë:

- a) Organizon ankandet për titujt;
- b) Shlyen transaksioni që kryhen më këto tituj;
- c) Mban regjistrin e titujve;
- d) Hap dhe mbyll llogaritë, pasqyron veprimet me to si dhe jep informacion mbi këto llogari;
- e) Ofron instrumente për menaxhimin e likuiditetit të Ministrisë;
- f) Jep opinione për politikën fiskale, menaxhimin e borxhit dhe financimin nga burime të huaja;
- g) Jep opinione mbi kushtet e tregut valutor dhe për përshtatshmërinë e veprimeve të Ministrisë në këtë treg;
- h) Transferon fitimin neto.

Sa më sipër dhe referuar e-mailit të dërguar nga Banka e Shqipërisë në datë 27.06.2014, Banka e Shqipërisë **nuk ka marrë përsipër të evidentojë borxhin e jashtëm të Ministrisë së Financës**. I vetmi angazhim i Bankës së Shqipërisë në drejtim të borxhit të jashtëm, ka qenë evidentimi i borxhit të huaj të trashëguar para viteve 1990, procesi i cili është mbyllur.

2.6 Mbi kreditë ose huatë e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë, si dhe ristrukturimi i letrave me vlerë të Qeverisë.

Për vitin 2023, rezulton se Banka e Shqipërisë nuk dhënë kredi ose hua për Qeverinë Shqiptare.

Mbi ristrukturimin e letrave me vlerë

Ankandet “buyback” janë një proces ku institucioni blen sërish letrat e tij me vlerë nga tregu, çka ndikon në uljen e numrit të letrave me vlerë në qarkullim, duke rritur kështu vlerën e letrave me vlerë në treg që mbeten, me qëllim kryesor përmirësimin e treguesve financiarë të institucionit. Pra blerja mbrapsht e titujve të borxhit është një teknikë e njohur financiare që përdoret për të menaxhuar dhe zvogëluar barrën e borxhit të një qeverie. Mos marrja e masave përmes procesit të blerjes mbrapsht, sjell presion mbi financat publike për të rifinancuar këto borxhe në një afat të shkurtër, duke ndikuar si rrjedhojë në stabilitetin makroekonomik.

Banka e Shqipërisë, i ka rekomanduar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të planifikojë ankande buyback të emetimeve benchmarking në mënyrë që të ulë riskun e roll over në momentin e rinovimit.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke marrë në konsideratë vlerën e lartë të maturimeve të instrumenteve referencë obligacione 3-vjeçare dhe obligacione 5-vjeçare gjatë muajit Janar dhe Shkurt 2024, përkatësisht në vlerat 20.83 miliard lekë dhe 18.73 miliard lekë, për vitin 2023, ka planifikuar dhe zhvilluar 6 ankandet për blerje mbrapsht, nga të cilat 3 ankande për obligacione 3-vjeçare dhe 3 ankande për obligacione 5-vjeçare.

Tabela nr. 1: Ankandet buyback, 2023

Instrumenti	Nr. ankandesh	Bid cover >1	Bid cover <1	Shuma e Shpallur (Mld lekë)	Shuma e Kërkuar (Mld lekë)	Shuma e tërhequr mbrapsht nga MF (Mld lekë)
Obligacion referencë 3-vjeçar	3	0	3	6.00	0.77	0.67
Obligacion referencë 3-vjeçar	3	0	3	6.00	1.83	1.83

Burimi: Ministria e Financave

Referuar tabelës më sipër, rezultatet e ankandëve të zhvilluara janë detajuar sipas raportit të mbulimit (bid cover ratio), që është një tregues i kërkesës në treg në krahasim me ofertën e qeverisë. Raporti i mbulimit mbi 1 (Bid Cover >1) tregon se kërkesa për titujt është më e lartë se oferta, ndërsa një raport më pak se 1 (Bid Cover <1) tregon mungesë të kërkesës ose interesit për të blerë titujt e ofruar. Për ankandet e obligacioneve 3-vjeçare, raporti i mbulimit, rezulton më pak se 1 në të gjitha ankandet, ku nga 6 miliardë lekë të shpallura për blerje, vetëm 0.67 miliardë lekë u tërhoqën mbrapsht. Ndërsa për ankandet e obligacioneve 5-vjeçare, nga 6 miliardë lekë të shpallura, u tërhoqën mbrapsht 1.83 miliardë lekë, çka tregon për një kërkesë më të lartë për këto instrumente financiare krahasuar me obligacionet 3-vjeçare.

Konstatohet se ankandi me nr. BB18, obligacion 3 vjeçar (buyback), me shumë që blihet 2,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 07.11.2023, me ISIN AL0045NF3Y24, është anuluar nga ministria e Financave për shkak se në këtë ankand u paraqit vetëm një kërkesë, me vlerë 100 milion lekë.

Sipas Ministrisë së Financave, një nga faktorët kryesorë që ndikoi në mosplotësimin e ankandëve, lidhet kryesisht me kufizimet e bankave për pjesëmarrje bazuar në politikat e klasifikimit të portofolit të investimeve (“hold to maturity” dhe jo “available for sale”). Ky kufizim lidhet me politikat e klasifikimit të investimeve të portofolit të bankave, ku klasifikohen titujt që zotërojnë si “të mbajtura deri në maturim” (“hold to maturity”) dhe jo

"të disponueshme për shitje" ("available for sale"). Kjo politikë nënkupton se bankat nuk janë të prirura për të shitur ose për të kthyer mbrapsht titujt e blerë paraprakisht, pasi këto tituj janë pjesë e investimeve afatgjata të tyre dhe shiten vetëm në raste të veçanta. Si pasojë, ka sjellë pjesëmarrje të kufizuar dhe si rezultat qeveria nuk arriti të tërheqë sasinë e plotë të titujve që kishte planifikuar.

Këto kufizime përbëjnë një pengesë për politikën e borxhit publik, pasi kërkesa për të likuiduar titujt në tregun e brendshëm është më e ulët nga sa ishte parashikuar, si rrjedhojë shteti vihet përballë detyrimeve më të mëdha për rifinancim në vitin 2024.

Gjithashtu, mosarritja e plotë e objektivave të blerjes mbrapsht nënkupton që një pjesë e konsiderueshme e obligacioneve do të maturohet në vitin 2024, çka mund të sjellë një presion të shtuar mbi buxhetin e shtetit dhe mundësinë që qeveria të duhet të rifinancojë borxhin përmes emetimit të titujve të rinj në kushte më të vështira ose me interesa më të larta, në varësi të kushteve të tregut financiar në atë kohë. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e kufizuar e bankave dhe institucionet financiare në ankandet e blerjes mbrapsht mbart riskun mbi paqartësi lidhur me kapacitetin e tregut të brendshëm financiar për të mbështetur me efikasitet proceset e menaxhimit të borxhit publik në të ardhmen.

Mbi ankandet e zhvilluara buyback

- *Ankandi nr. BB12, obligacion 5 vjeçar (buyback), me shumë që blihet 2,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 05.06.2023, me ISIN AL000A3NF5Y24.*

Me shkresën nr. 9769, datë 29.05.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin mbi zhvillimin e ankandit (buyback) të obligacioneve referencë 5-vjeçare, me shumë që do blihet mbrapsht 2,000 milion lekë, në të cilin do të pranohen vetëm kërkesa konkurruese. Banka e Shqipërisë me shkresës nr. 2481/1, datë 05.06.2023 ka dërguar rezultatet e ankandit. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 2 kërkesa, të cilat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Në total janë paraqitur 2 kërkesa konkurruese, në shumën 900 milion lekë. Yield minimal i pranuar është në nivelin e 3.1%, niveli i yield cutoff është 3.07% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.073%. Me shkresën nr. 9769/1, datë 05.06.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për blerje 900 milion lekë, me nivel yield-it të pranuar 3.07%. Në përfundim janë pranuar 2 kërkesat konkurruese, në shumën 900 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield 3.07% dhe 3.1%.

- *Ankandi nr. BB13, obligacion 3 vjeçar (buyback), me shumë që blihet 2,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 07.06.2023, me ISIN AL0045NF3Y24.*

Me shkresën nr. 9946, datë 01.06.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin mbi zhvillimin e ankandit (buyback) të obligacioneve referencë 3-vjeçare, me shumë që do blihet mbrapsht 3,000 milion lekë, në të cilin do të pranohen vetëm kërkesa konkurruese. Banka e Shqipërisë me shkresës nr. 2525/1, datë 07.06.2023 ka dërguar rezultatet e ankandit. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 3 kërkesa, të cilat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Në total janë paraqitur 3 kërkesa konkurruese, në shumën 218.2 milion lekë. Yield minimal i pranuar është në nivelin e 3.05%, niveli i yield cutoff është 3% dhe niveli mesatar konkurrues është 3.014%. Me shkresën nr. 9946/1, datë 07.06.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për blerje 218.2 milion lekë, me nivel yield-it të pranuar 3%. Në përfundim janë pranuar 3 kërkesat konkurruese, në shumën 218.2 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield 3% dhe 3.050%.

- *Ankandi nr. BB14, obligacion 5 vjeçar (buyback), me shumë që blihet 2,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 18.09.2023, me ISIN AL0036NF5Y24.*

Me shkresën nr. 16255, datë 13.09.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin mbi zhvillimin e ankandit (buyback) të obligacioneve referencë 5-vjeçare, me shumë që do blihet mbrapsht 2,000 milion lekë, në të cilin do të pranohen vetëm kërkesa konkurruese. Banka e Shqipërisë me shkresës nr. 3920/1, datë 18.09.2023 ka dërguar rezultatet e ankandit. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit është administruar gjithsej 1 kërkesë, në vlerën 400 milion lekë, e cila është janë pranuar nga komision pasi ka rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Yield minimal i pranuar rezulton në nivelin 2.75%. Me shkresën nr. 16255/1, datë 18.09.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për blerje 400 milion lekë, me nivel yield-it të pranuar 2.75%.

- *Ankandi nr. BB16, obligacion 3 vjeçar (buyback), me shumë që blihet 2,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 27.09.2023, me ISIN AL0045NF3Y24.*

Me shkresën nr. 16762, datë 21.09.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin mbi zhvillimin e ankandit (buyback) të obligacioneve referencë 3-vjeçare, me shumë që do blihet mbrapsht 2,000 milion lekë, në të cilin do të pranohen vetëm kërkesa konkurruese. Banka e Shqipërisë me shkresës nr. 4037/1, datë 27.09.2023 ka dërguar rezultatet e ankandit. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 2 kërkesa, në shumën 450 milion lekë, të cilat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Yield minimal i pranuar është në nivelin e 2.78%, niveli i yield cutoff është 2.75% dhe niveli mesatar konkurrues është 2.763%. Me shkresën nr. 16762/1, datë 27.09.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për blerje 450 milion lekë, me nivel yield-it të pranuar 2.75%. Në përfundim janë pranuar 2 kërkesat konkurruese, në shumën 450 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield 2.75% dhe 2.78%.

- *Ankandi nr. BB17, obligacion 5 vjeçar (buyback), me shumë që blihet 2,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 25.10.2023, me ISIN AL0036NF5Y24.*

Me shkresën nr. 18983, datë 18.10.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin mbi zhvillimin e ankandit (buyback) të obligacioneve referencë 5-vjeçare, me shumë që do blihet mbrapsht 2,000 milion lekë, në të cilin do të pranohen vetëm kërkesa konkurruese. Banka e Shqipërisë me shkresës nr. 4492/1, datë 25.10.2023 ka dërguar rezultatet e ankandit. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit janë administruar gjithsej 2 kërkesa, në shumën 530 milion lekë, të cilat janë pranuar nga komision pasi kanë rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Yield minimal i pranuar është në nivelin e 2.71%, niveli i yield cutoff është 2.5% dhe niveli mesatar konkurrues është 2.54%. Me shkresën nr. 18983/1, datë 25.10.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar shpalljen e rezultateve të ankandit, ku ka pranuar për blerje 530 milion lekë, me nivel yield-it të pranuar 2.5%. Në përfundim janë pranuar 2 kërkesat konkurruese, në shumën 530 milion lekë, të cilat janë alokuar me yield 2.5% dhe 2.71%.

- *Ankandi nr. BB18, obligacion 3 vjeçar (buyback), me shumë që blihet 2,000 milion lekë, me datë zhvillimi ankandi 07.11.2023, me ISIN AL0045NF3Y24.*

Me shkresën nr. 19924, datë 01.11.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar njoftimin mbi zhvillimin e ankandit (buyback) të obligacioneve referencë 3-vjeçare, me shumë që do blihet mbrapsht 2,000 milion lekë, në të cilin do të pranohen vetëm kërkesa konkurruese. Banka e Shqipërisë me shkresës nr. 4498/1, datë 07.11.2023 ka dërguar

rezultatet e ankandit. Sipas procesverbalit të komisionit të ankandit është administruar gjithsej 1 kërkesë, në vlerën 100 milion lekë, e cila është pranuar nga komision pasi ka rezultuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Yield minimal i pranuar rezulton në nivelin 2.2%. Me shkresën nr. 19924/1, datë 07.11.2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka njoftuar anulimin e ankandit.

IV. REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i marrëdhënies mes Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në kuadër të menaxhimit të likuiditetit, konstatohet se këto dy institucione kanë nënshkruar marrëveshjen nr. 716/1, datë 20.01.2015 mbi instrumentet e ofruar nga Banka e Shqipërisë për menaxhimin e likuiditeteve të Ministrisë së Financave, në të cilën përcaktohen mënyrat dhe instrumentet për menaxhimin e tepricave të likuiditetit përgjatë periudhave. Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe marrëveshjen për ofrimin e shërbimeve financiare mes Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë, MFE vendos për investimin e mjeteve monetare në formën e depozitës dhe për këtë dërgon shkresë drejt BSH me qëllim investimin e këtyre tepricave. Më pas, BSH kryen investimin e tepricave në depozita. Gjithashtu, BSH është pjesëmarrëse në Komitetin e Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit, i cili ndërmer analiza ose veprime lidhur me mënyrën më të mirë të menaxhimit të likuiditetit. Në kuadër të menaxhimit të këtyre tepricave, përgjatë vitit 2023 janë kryer 7 vendosje në depozitë e tepricës së likuiditeteve, në vlerë totale 58 miliard lekë të cilat janë diskutuar në mbledhjet e KMBL për t'u depozituar si rezultat i tepricave në likuiditet në monedhën vendase.

Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2023 veçanërisht për mjetet monetare në valutë (si monedha EUR e cila paraqitet me teprica të konsiderueshme likuiditeti, sidomos pas marrjes së Eurobondit në muajin Qershor 2023) nuk është shfrytëzuar mundësia e investimit të tyre në depozitë nga ana e MFE për të përfituar të ardhura nga interesi, në të njëjtën kohë kur mbajtja e këtyre valutave shoqërohet me kosto mbajtje. Gjithashtu, konstatohet se përgjatë periudhës objekt auditimi kanë ekzistuar hapësirat dhe mundësitë për të investuar më shumë si në vlerë ashtu edhe në kohëzgjatje, me qëllim përfitimin maksimal nga kjo mënyrë menaxhimi e likuiditetit.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin (2.3), faqe 20-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, bazuar në marrëveshjen nr. 716/1, datë 20.01.2015, të marrë masa për krijimin e hapësirave me qëllim nxitjen e mundësive mbi investimin e likuiditeteve në monedhë vendase dhe valuta të huaja në vlerë dhe në kohëzgjatje, jo vetëm përmes investimeve në depozitë, por edhe përmes instrumenteve të tjerë për menaxhimin e likuiditetit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i bërë zërit të pasqyrës së pozicionit financiar “Rezerva për vlerën e drejtë (investime në tituj borxhi)”, rezultoi se për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2023, paraqitej me tepricë negative, konkretisht në shumën 2,396 milionë lekë. Në përputhje me kërkesat e germës b të nenit 64 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe bazuar në Marrëveshjen dypalëshe mes Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë Shqiptare “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës datë 20.01.2015”, të ndryshuar me

Marrëveshjen me nr. 24012, datë 29.12.2023, Ministria e Financave duhet të lëshojë tituj borxhi për të mbuluar balancën negative të rezervës së rivlerësimit brenda 4 muajve pas mbylljes së vitit financiar. Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 1679, prot., datë 15.04.2024 të Zv. Guvernatorit të Parë i ka bërë kërkesë Ministrisë së Financave për mbulimin e vlerës negative të llogarisë të kësaj llogarie. Sipas kësaj shkrese bëhet me dije se në përfundim të procesit të auditimit të pasqyrave financiare të Bankës për vitin 2023, llogaria “Rezerva e rivlerësimit të valutave” rezultoi me gjendje negative në 56,737,912,520.53 lekë. Ministria e Financave me shkresën nr. 5069/1 prot., datë 17.05.2024, ka kthyer përgjigje mbi njoftimin për vlerën negative të llogarisë “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave” më datë 31.12.2023 dhe mbi kompensimin e titujve shtetëror të emetuar nga Ministria e Financave, pra jo në përputhje me afatin duke qenë se ky veprim duhet të ishte bërë brenda muajit Prill 2024 dhe jo në muajin Maj 2024.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin (2.2), faqe 12-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë të marrë masa për të bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, në drejtim të koordinimit të veprimeve, për emetimin brenda afatit ligjor të përcaktuar, të letrave me vlerë, me qëllim shmangien e riskut për mos mbulimin në kohë të rezervave negative.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i rezervave, rezultoi se për vitin e mbyllur më 31.12.2023 zëri “Rezerva si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve” paraqitet në shumën 5,450 milionë lekë. Kjo rezervë është krijuar bazuar në Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të BSH nr. 19 dhe nr. 20, datë 15.03.2018, si rezultat i rishpërndarjes dhe shpërndarjes së rezervës së tranzicionit. Në lidhje me këtë rezervë Banka e Shqipërisë nuk disponon një manual apo udhëzim, specifik, që të përcaktojë mënyrën implementimit të këtyre standardeve, menaxhimit të tranzicionit drejt IRFS-ve si dhe krijimin dhe përdorimin e rezervës së krijuar për këtë qëllim.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin (2.7), faqe 18-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë të marrë masa për të hartuar një manual për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), me qëllim përcaktimin e qartë të procedurave të menaxhimit dhe përdorimit të rezervës si dhe rregullat për monitorimin dhe raportimin e përdorimit të saj.

Brenda 6 muajve

4. Gjetje nga auditimi: Për ankandin nr. 212, datë 06.04.2023, Agjencia e Sigurimit të Depozitave ka paraqitur 3 kërkesa konkurruese. Në kërkesën e parë ka kërkuar të marrë pjesë në ankand me shumën konkurruese 500 milion lekë dhe yield 4.1%, në kërkesën e dytë ka kërkuar të marrë pjesë me shumën konkurruese 500 milion lekë dhe nivel yield 4.2% ndërsa në kërkesën e tretë ka kërkuar të marrë pjesë me shumën konkurruese 750 milion lekë dhe nivel yieldi po 4.2% për “Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”. Nga komisioni i ankandit janë pranuar të tre kërkesat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Referuar pikës 2 dhe 3, neni 71, të ligjit nr. 133/2013 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në Banka, në Republikën e Shqipërisë”, Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nuk është subjekt më vetë, pasi nuk ka personalitet juridik dhe rrjedhimisht nuk është subjekt i ndryshëm nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, por një Fond që administrohet prej saj. Sa më sipër, pranimi i kërkesave konkurruese me të njëjtin nivel yield-i të kërkuar nga i njëjti subjekt është jo në përputhje me pikën 3, neni 8, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 31, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të thesarit në formë regjistri”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin (2.3), faqe 20-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Komisionet e ankandëve të marrin masa për të respektuar pjesëmarrjen e subjekteve konkurruese në ankandet e bonove të thesarit, obligacioneve në përputhje me

udhëzimin përkatës duke analizuar dhe pranuar ato kërkesa të cilat kanë të paktën 0.01% ndryshimi në nivelin e yield-it.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023, kërkesat jo konkurruese të individëve rezultojnë në vlerën 44,639 milion lekë, të cilat përbëjnë 38.85% të shumës së kërkesave jo konkurruese dhe 13.5% të shumës totale të kërkuar. Individët mund të marrin pjesë në ankandet e bonove të thesarit nëpërmjet bankave tregtare të licencuara nga autoritetet përkatëse për këtë shërbim ose nëpërmjet sporteleve të Bankës së Shqipërisë. Në vitin 2020, Banka e Shqipërisë njoftoi mbylljen e sporteleve të saj për investimin e individëve në bonot e thesarit, ndërsa, në fund të vitit 2022, Banka e Shqipërisë njoftoi shtyrjen e mbylljes së këtij shërbimi. Analiza e të dhënave tregon se portofoli i individëve në vitin 2023 është në të njëjtin nivel me vitin 2021 dhe numri i individëve që kanë marrë pjesë ka rënë ndjeshëm, nga 10,657 në 5,014.

Nisur nga fakti që ky shërbim ofrohet gjithashtu nga bankat e nivelit të dytë si dhe fakti që edhe kur ky shërbim ofrohet në sportelet e Bankës së Shqipërisë sërish individët duhet të paraqiten për hapje llogarish në bankat e nivelit të dytë, shtyrja e mbajtjes hapur të këtyre sporteleve nuk sjell vlerë të shtuar për individët dhe investimet e tyre, gjithashtu ul eficiencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve të BSH.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin (2.3), faqe 20-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë të vlerësojë dhe analizojë kosto/përfitimet e mbajtjes hapur së sporteleve të bonove të thesarit, me qëllim rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve dhe burimeve të Bankës së Shqipërisë.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 25/10 prot., datë 17.07.2023 ka kërkuar zbatimin e 10 masave organizative. Banka e Shqipërisë, me shkresën nr. 74/5 prot., datë 01.08.2023, ka paraqitur planin e veprimit, brenda afatit, por nuk ka dërguar informacion mbi zbatimin e rekomandimeve, jo në përputhje me nenin 30 pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve është konstatuar se nga 10 masa të lëna, janë pranuar 4 masa ose 40% e tyre dhe nuk janë pranuar 6 masa ose 60%. Në lidhje me zbatueshmërinë rezulton se 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht (rekomandimi 1.1, 6.1 dhe 7.1) dhe 1 rekomandime është në proces zbatimi (rekomandimi 8.1).

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin (2.1), faqe 9-12, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Banka e Shqipërisë të marrë masa për zbatimin e të gjitha rekomandimeve që kanë rezultuar të zbatuara pjesërisht, si dhe të përshpejtojë realizimin e rekomandimit në proces.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT